




---

# CONFERENCE PROCEEDINGS

---

**International Conference  
on Creative Writing  
and Critical  
Approaches  
to Literature**





# **CONFERENCE PROCEEDINGS**

## **International Conference on Creative Writing and Critical Approaches to Literature**

**SEEU-Tetovo**

**2015**

# **CONFERENCE PROCEEDINGS**

**International Conference on Creative Writing and Critical  
Approaches to Literature**

**International Conference on Creative Writing  
and Critical Approaches to Literature**

**CONFERENCE PROCEEDINGS**

**EDITORIAL BOARD:**

**Vlera Ejupi** (Republic of Macedonia)

**Meral Shehabi-Veseli** (Republic of Macedonia)

**Keti Miteva-Markovic** (Republic of Macedonia)

**Andrew Goodspeed** (USA)

**Teuta Salii** (Republic of Macedonia)

**Shpresa Mustafai** (Republic of Macedonia)

**Heather Henshaw** (UK)

**Jusuf Buxhovi** (Republic of Kosovo)

**Agron Tufa** (Republic of Albania)

**Benjamin Keatinge** (Ireland)

**Veronika Kareva** (Republic of Macedonia)

**Hava Mustafa** (Republic of Macedonia)

**Juan Jose Varela Tembra** (Spain)

**Isabel S. Carvalho** (Portugal)

**Yildiray Cevik** (Turkey)

**Danebeth Glomo** (Kingdom of Bahrain)

**Reviewed by:**

**Keti Miteva-Markovic**

**Meral Shehabi-Veseli**

**Benjamin Keatinge**

**Address:**

**SEEU - Tetovo  
Ilindenska n.335  
1200 Tetovo,  
Macedonia**

## **Acknowledgement**

*We would like to express our gratitude and appreciation to Prof. dr. Vlera Ejupi for her dedication and successful organization of the conference held on April 25<sup>th</sup> - 27<sup>th</sup> 2014.*

## CONTENTS

Arjan Th. Kallço - <i>Letërsia si bashkëudhëtare e pandarë me filozofinë</i> .....	9
Besim Muhadri - <i>Pal Hasi dhe Andrea Bogdani – Autorë të cituar të një letërsie të tretur</i> .....	15
Ermelinda Kashahu - <i>Konceptet estetike në veprat e shkrimtarit Koço Kosta</i> .....	20
Fatmire Vejseli - <i>Raporti i Reles me personazhet femra në dramën “Purgatori në Ingolshtat”</i> ....	25
Hamsi Behluli - <i>Udhëpërshkrimet letrare gjermane mbi shqiptarët 1910-30, reflektim i një realiteti shqiptarë në prizmin e autorëve të huaj</i> .....	29
Jehona Rushidi - <i>Drama “Israelitë e Filistinë” e Nolit si shembull i rishkrimit dhe transformimit tekstual</i> .....	33
Lindita Ahmeti - <i>Roli i numrave në strukturën hermetike të romanit “Gomari i artë” i shkrimtarit latin Apuleus</i> .....	37
Jehona Rushidi - <i>Intertekstualiteti në dramat e Çajupit dhe të hetuarit e tij në raport me tipin e lexuesit</i> .....	42
Luljeta Adili - <i>Asdreni oshenari i gjuhës dhe letërsisë shqipe</i> .....	46
Lumnije Thaçi - Halili - <i>Personazhi në romanin shqiptar në kohën e tranzicionit (Periudha e pas viteve ‘90)</i> .....	52
Luljeta Adili - <i>Fjalëformimi i fjalëve të përbëra në veprat e Asdrenit: “Reze dielli” dhe “Psalmë murgu”</i> .....	58
Meral Shehabi - Veseli - <i>Miti si intertekst në poezitë e Naim Frashërit</i> .....	63
Manjola Nasi - T. S. Elioti - <i>Një shembull modernist i konceptimit të poezisë</i> .....	69
Manjola Sulaj - <i>Pinoku shqiptar i Cuk Simonit</i> .....	74
Meral Shehabi - Veseli - <i>Polisemia e simboleve në funksion të intertekstit në poezitë e Naim Frashërit</i> .....	80
Olieta Polo - <i>Poezia në gazetën “Llaiko Vima” (1945-2012)</i> .....	88
Vjollca Rrapai- <i>Tematika e emigrimit në veprat e shkrimtarit italo - arbëresh Karmine Abates</i> ... 93	
Жета Рушиди - <i>Критички пристапи на “Хамлет” : Анализа низ призмата на генеологијата и психологијата</i> .....	98
Кети Митева-Марковиќ - <i>Ставовите на Рудолф Карнап за јазикот во контекст на лириката и филозофската литература</i> .....	105
Лилјана Силјановска - <i>Креативното пишување и критичкото мислење во медиумските изразни форми</i> .....	109

Кети Митева-Марковиќ - Семантичка и културолошка анализа на називите за мастило во словенските јазици.....	114
Милица Матоска - Анализа на идиолектот на главниот лик (Holden Caulfield) во романот на J.D. Salinger “Игра во ’Ржта” (The Catcher in the Rye) и начинот на кој е пренесен од англиски на македонски јазик.....	119
Митра Блажевска - За амалгамноста на текстот и митот/фантастичното во романите "Дива лига" и "Невестата на змејот" од академик Влада Урошевиќ.....	128
Argenita Salii - The spiritual and intellectual struggle of Jane Eyre to gain independence and equality in marriage and society: In Charlotte Bronte’s novel “Jane Eyre”.....	134
Bujar Hoxha- The Aesthetic Message and its Decoding Processes.....	140
Elena Spirovska- Creative writing in the context of using literary texts with learners of foreign language.....	146
Kalina Maleska- The Craft of Writing as Viewed by Contemporary Macedonian Authors.....	153
Rufat Osmani- Writing a book review in the EFL classroom: ways to enhance reading comprehension and writing skills.....	159
Vlera Ejupi - Some Aspects about love in the novel `Women in Love` by David Herbert Lawrence..	166
Yildiray Cevik - A Social Mediator on Two Stances”: Reading Elizabeth Gaskell’s North and South in Cultural Feminism.....	171

## **Kreativiteti dhe Kritika: një sintezë e përbashkët**

Në përmbledhjen e tij të famshme të eseve letrare me titullin "Pylli i shenjtë" (1920), poeti amerikan T.S. Eliot, argumenton fuqishëm për ndërvarësinë e krijimtarisë dhe kritikës, duke përmendur shembujt e shumtë të poetëve të mëdhenj të cilët ishin gjithashtu kritikë të mëdhenj (në mesin e tyre: S.T. Coleridge, Matthew Arnold dhe vetë Elioti), Elioti sugjeron se: "duke përjetuar një vepër arti" përfshihet "një përzierje e kritikës dhe reagimit krijues...të përbërë nga komenti dhe mendimi, si dhe e emocioneve të reja". Këto "emocione të reja" mund të rezultojnë në vepra të reja artistike dhe të kritikës apo lexuesi i zakonshëm, në një përgjigje të matur kritike (T.S. Eliot, "Kritiku i përkryer" nga "Pylli i shenjtë": Ese mbi Poezinë dhe Kritikën). Për Eliotin, në të gjithë jemi "artistë jo të plotë" me "shkallë të ndryshme të inteligjencës" dhe "ia bëjmë vehtes qejfin po të themi se kritika është për hir të krijimit" ose krijimi, për hir të kritikës"; por për Eliotin, "të dyja drejtimit të përbashkëta" dhe për këtë arsye, jo rrallë, kritikët dhe artistët janë njëjtësuar në një person.

Këto reflektime mua më duken si një pikënisje e mirë nga e cila duhen konsideruar këto ese të mbledhura këtu, nga konferenca e mbajtur në Universitetin e Evropës Juglindore, në Tetovë, më 25-26 prill të vitit 2014. Kjo konferencë mbledhi bashkëfolës nga e gjithë Maqedonia, Shqipëria, Kosova, vendeve tjera të rajonit dhe të Ballkanit, për të ndarë reflektime kritike dhe intuita krijuese në një gamë të tërë të temave kulturore, letrare dhe gjuhësore. Diversiteti i konferencës është reflektuar në sintezën e temave që konsiderohen në këto publikime dhe gjithashtu në gjuhën e publikimeve të botuara këtu në shqip, maqedonisht dhe anglisht. Disa nga pjesëmarrësit në konferencë janë artistë kreativë dhe me bagazh letrar, të cilët janë gjithashtu profesorë dhe kritikë. Libri i konferencës paraqet një përpyetje të përbashkët për të reflektuar mbi një varg temash letrare dhe gjuhësore të cilat janë me interes profesional dhe të përgjithshëm për të gjithë, puna e të cilëve angazhohet me dilema bashkëkohore kritike.

Një nga karakteristikat më të vlefshme në trashëgiminë e mendimtarëve të mëdhenj kreativë dhe kritikë si vetë T.S. Elioti është shkalla në të cilën vetë mendjemprehtësia e tyre kritike dhe krijuese është e ndarë në mes të shkrimtarëve të tjerë dhe kritikëve me dallim më të vogël në mënyrë që puna e kritikës dhe analizës duket si një përpyetje të përbashkët. Shumë prej bashkëkohësve të Eliot-it nxorren në dukje bujarinë e tij, veçanërisht ndaj shkrimtarëve dhe kritikëve të rinj me punën e të cilëve ai mund ose mund të mos ndjejë një ndjenjë të afinitetit. Është për të shpresuar se kjo frymë bashkëpunimit kritikues dhe përpyekjes së përbashkët është reflektuar edhe në këtë vëllim të eseve që është fryti i bashkëpunimit në mes të disa kolegëve në Universitetin e Evropës Juglindore nga Departamentet e gjuhës shqipe, angleze dhe Qendrës së gjuhëve. Puna e tyre redaksionale ka aktivizuar këtë përmbledhje kritike për të ardhur në ekzistencë për përfitim, udhëzim dhe gëzimin e të gjithë neve!

*Prof. Benjamin Keatinge, Dekan  
Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit  
Universiteti i Evropës Juglindore  
9 mars 2015*

### Креативност и критика: синтеза

Во својата позната збирка литературни есеи насловена, „Светата шума“ (1920), познатиот американски поет Т.С. Елиот се залага за меѓусебна поврзаност на креативноста и критицизмот. Наведувајќи бројни примери на големи поети кои исто така биле и добри критичари (меѓу кои С.Т. Колриџ, Метју Арнолд и самиот Елиот), тој тврди дека „доживувањето на едно уметничко дело“ вклучува „комплексна критичка и креативна реакција... која се состои од коментар и мислење, а исто така и нови емоции“. Овие „нови емоции“ можат да резултираат со нови уметнички дела кај креативната личност, а кај критиката или обичниот читател со измерен критички одговор (Т.С. Елиот, „Совршена критика“, од делото *Светата шума: есеи за поезијата и критицизмот*). За Елиот, ние сите сме „некомплетни уметници“ со „различни нивоа на интелигенција“ и „би било смешно да се каже дека критицизмот постои заради креацијата или дека креацијата постои заради критицизмот“: наместо ваквото гледање, „двете толкувања се комплементарни“ и токму поради оваа причина често, критичарот и уметникот се една иста личност.

Се чини дека ваквите размислувања се добра појдовна точка за да се разгледаат трудовите поместени во оваа збирка, а презентирани на конференцијата одржана на Универзитетот на Југоисточна Европа, Тетово, на 25 и 26 април, 2014. Оваа конференција собра на едно место учесници од цела Македонија, од Албанија и Косово, како и од други места на Балканот за да споделат критички размислувања и креативни интуиции на еден цел дијапазон на културни, литературни и лингвистички теми. Разноликоста на конференцијата се огледува во синтезата на темите кои се предмет на овие трудови и се напишани на албански, македонски и англиски јазик. Некои од учесниците на конференцијата и самите се реномирани креативни уметници, а во исто време и професори и критичари. Самата збирка претставува заеднички напор да се рефлектира врз сферата на литературни и лингвистички теми, кои се од професионален и општ интерес за секој чија работа опфаќа современи критички дилеми.

Една од највредните карактеристики на делото на големите креативни и критички мислители каков што е Т. С. Елиот е степенот до кој нивното сопствено критичко и креативно разбирање е споделено меѓу другите, не толку значајни, писатели и критичари така што изгледа како работата на критицизмот и анализата да е заеднички напор. Многу од современиците на Елиот ја истакнувале неговата великодушност, особено спрема младите писатели и критичари, без оглед на тоа какво мислење имал за нивните дела. Се надеваме дека духот на критичката соработка и заедничките напори се отсликани и во оваа збирка на научни трудови кои се плод на соработката меѓу неколку колеги на Универзитетот на Југоисточна Европа, од Катедрите за албански и англиски јазик и од Јазичниот центар. Нивната уредувачка работа, за наше добро, за наше изучување и за наше уживање, овозможи постоење на оваа критичка компилација!

Проф. Бенџамин Китинг, декан  
Факултет за јазици, култури и комуникации  
Универзитет на Југоисточна Европа

9 март 2015

### **Creativity and Criticism: A Synthesis**

In his famous collection of literary essays titled *The Sacred Wood* (1920), the American poet T.S. Eliot strongly argued for the interdependence of creativity and criticism. Citing numerous examples of great poets who were also great critics (among them: S.T. Coleridge, Matthew Arnold and Eliot himself), Eliot suggested that: “experiencing a work of art” involves “a mixed critical and creative reaction ... made up of comment and opinion, and also new emotions”. These “new emotions” can, in the creative person, result in new artistic works and in the critic or ordinary reader, in a measured critical response (T.S. Eliot, ‘The Perfect Critic’ from *The Sacred Wood: Essays on Poetry and Criticism*). For Eliot, we are all “incomplete artists” with “various degrees of intelligence” and “it is fatuous to say that criticism is for the sake of ‘creation’ or creation for the sake of criticism”; rather, for Eliot, “the two directions are complementary” and for this very reason, not infrequently, the critic and the artist are one and the same person.

These reflections seem to me to be a good starting point from which to consider the essays gathered here, based on a conference held at South East European University, Tetovo on 25-26 April 2014. That conference brought together speakers from all around Macedonia, from Albania and Kosovo and elsewhere in the Balkans region to share critical reflections and creative intuitions on a whole range of cultural, literary and linguistic topics. The diversity of the conference is reflected in the synthesis of topics considered in these papers and also in the languages of the papers published here in Albanian, Macedonian and English. Several of the conference participants are themselves creative artists of note and reputation who are also professors and critics. The book itself represents a shared endeavour to reflect on a range of literary and linguistic topics which are of professional and general interest to everyone whose work engages with contemporary critical dilemmas.

One of the most valuable features in the legacy of great creative and critical thinkers like T.S. Eliot is the extent to which their own critical and creative perspicacity is shared among other writers and critics of lesser distinction so that the work of criticism and analysis appears as a shared endeavour. Many of Eliot’s contemporaries noted his generosity, especially towards younger writers and critics with whose work he might or might not feel a sense of affinity. It is to be hoped that this spirit of critical co-operation and shared endeavour is reflected also in this volume of essays which is the fruit of collaboration between several colleagues at South East European University from the Departments of Albanian and English and the Language Centre. Their editorial work has enabled this critical compendium to come into existence for the benefit, instruction and enjoyment of us all!

*Prof Benjamin Keatinge, Dean  
Faculty of Languages, Cultures and Communication  
South East European University*

9 March 2015.

## Letërsia si bashkëudhëtare e pandarë me filozofinë

**Arjan Th. Kallço**

F.S.Noli,

Korçë, Shqipëri

a.kallco@hotmail.com

### I. Tri përcaktime të domosdoshme konceptuale

**Borges** : Letërsia në përcaktimin e saj nuk është gjë tjetër veç një ëndërr e udhëhequr.

**Galilei** : Filozofia është libri i madh që vazhdimisht qëndron i hapur para syve tanë.

**Autori** : Gjuha është ura e përbashkët epistemologjike lidhëse pa të cilën nuk do të kishim as njërën, as tjetrën.

Filozofia vdiq! Ejani t'ia bëjmë së bashku funeralin! Kjo do të ishte thirrja më e pakuptimtë e një grupi studiuesish sot në botë që mezi presin që t'i japin lamtumirën e fundit. A thua se e humbi natyrën dhe detyrën e vet? Filozofia nuk është sistem apo një mjet që ka skadencë përdorimi, por një shoqëri që ka nevojë gjithmonë për rinovim dhe material të ri për studim. Letërsia deri më sot nuk i ka dëgjuar këto thirrje, sepse nëse mendimi mund të pësojë black out, ndjenja ka vazhduar të jetojë bashkë me shpirtin edhe në rrethana të vështira. Kur mendojmë se jemi bashkëudhëtarë me dikë gjithmonë e shohim si një rast i mirë për ta njohur njëri-tjetrin, për të shkëmbyer mendime, për të diskutuar rreth problemeve dhe përvojave. Bashkëudhëtarët nuk janë veç kohësi e kaluar së bashku shpesh në rrethana të njëjta, në mjedise të njëjtë, në epoka të njëjta. Edhe pse natyra e kohësisë është e njëjtë për të dy, asnjëherë nuk ka shenjë barazimi, dikush është më përpara se bashkëudhëtarë, ose më pas. Këtu qëndron e gjithë filozofia e komunikimit të të kundërtëve, ose jo të barabartëve, edhe pse të barabartë në kohësi. Letërsia dhe filozofia janë dy drejtime që ecin njëkohësisht pranë, me dallime të dukshme, por ndonjëherë edhe pa të tilla, për më tepër të shkruara në brendësitë thelbësore të tyre. Pavarësisht dallimeve që në përcaktime, letërsia dhe filozofia janë veprimtaria me e lartë e mendjes së njeriut dhe që marrin jetë prej saj. Pa intelektualin njeriu nuk do të ishte në gjendje ta perceptonte botën e aq më pak ta pasqyroste atë. Por para se ta ndryshonte në të mirë të jetës së vet, duhej ta kuptonte dhe ta krijonte në mendje idenë e ndryshimit. Letërsia e pasqyron me art realitetin, jetën, ngjarjet, shpesh edhe duke e fantazuar apo duke e zburuar, ndërsa filozofia i ngre hipotezat dhe përpiket t'u japë përgjigje vetëm mbi bazën e arsyes. Pra të dyja janë produkte të mendjes, por njëra është rrjedhojë e shpirtit, tjetra e logjikës dhe e racionalitetit. Në këtë pikë ato kanë të përbashkët të njëjtin objekt – njeriun dhe gjithë botën e tij, individuale, kolektive, të brendshme, të jashtme, intime, ndërpersonale dhe shoqërinë ku jeton dhe vepron. Jashtë natyrës dhe shoqërisë njeriu nuk do të ishte ky që është sot, e për rrjedhojë, edhe produktet e mendjes dhe shpirtit të tij këto që janë sot. Në shoqëri raportet mes njerëzve nuk janë raporte virtuale, të komanduara nga ndonjë gjithëfuqi kozmike, por ngrihen mbi baza reale dhe janë të vërteta dhe të prekshme. Pa këto raporte ndërvepruese dhe të pashmangshme, shmangia do të sillte ndarjen, por individët në asnjë shoqëri nuk kanë qënë kurrë të ndarë, filozofia nuk do të mund të depërtonte thellë në realitetin e kohës, të bënte përsiatjet e veta dhe t'u jepte përgjigje pyetjeve që detyrimisht lidhen me qënien njerëzore. Nëse do t'i referohemi letërsisë dhe veprave të saj, do të konfirmimin gjithmonë se ato kanë dy të vërteta të pakundërshtueshme që u japin spunto veprave : kohën dhe hapësirën. Edhe personazhi më pak i dukshëm në një vepër lëviz në të dy raportet e mësipërme, d.m.th ka kohën e vet të shfaqjes që është kohë e matshme dhe e

përcaktueshme, por edhe hapësirën ku shfaqet dhe vepron, sado e vogël apo e madhe qoftë ajo, e përfillshme apo e papërfillshme. Nëse veprës letrare ia heqim kohën dhe hapësirën, ajo vepër nuk do të ekzistonte, nuk do të kishte ngjarje dhe nuk do të shkruhej kurrë. Njeriu është faktori themelor dhe si i tillë krijon në një kohë të përcaktuar deri në detajet më të himta, nëse duam dhe në një hapësirë që është e përshkueshme plotësisht dhe e vëzhgueshme realisht. Konceptet e kohës dhe hapësirës e morën kuptimin e tyre të vërtetë dhe shkencor atëherë, kur u përcaktuan nga racionaliteti i mendjes deri në abstragim dhe u shpjeguan nga shkenca. Rrugëtimi i njeriut nëpër labirintet e ekzistencës e preku ndriçimin e duhur përmes mendimit, pra të filozofisë. Jeta në tokë, kohëzgjatja e saj në kohë është faktor që nuk mund të mos merret në konsideratë, është tirani që e kufizon qënien njerëzore që nga lindja deri në vdekje, prandaj kufijtë e ekzistencës na japin të drejtën të themi se Njeriu është kohë. Në çdo hapësirë të tokës, edhe në skajet e panjohura prej secilit individ, por jo prej shkencës, ndoshta do të mbetet e pandryshuar edhe për shumë shekuj, e rrethuar nga ligjësi të rrepta ndërveprimi, ka një çast kohe të jetuar edhe pse shkurt, ndoshta disa sekonda, por përsëri është kohë e jetuar reale. Koha na lejon që hapësira të bëhet e përshkueshme kurdoherë, sepse është po ajo e miliona viteve më parë, sigurisht me zhvillimet dhe progresin e saj të pakundërshtueshëm, njeriu është transformuesi i saj më i madh, ndërsa koha e shkuar është e pakapshme, pasi e pajetuar, e ngërthyer në të vërtetë që tek ne vijnë jo gjithmonë të tilla, por relativisht të perceptueshme dhe të shpjgueshme.

## II E vërteta tek filozofia dhe letërsia

**Tabuki :** Filozofia duket se merret vetëm me të vërtetën, por ndoshta thotë vetëm fantazi, letërsia duket sikur merret vetëm me fantazinë, por thotë të vërtetën. Historikisht lidhja mes dy mbretërëshave të mendimit është e hershme dhe zakonisht i referohet më shumë traditës perëndimore. Shumë filozofë e bënë të vetën gjininë tregimtare ose narrative për të shprehur mendimet e veta, shpesh dhe filozofike, ku mund të përmendim epistolat (letrat), romanet filozofike, rrëfimet, teatrin filozofik. Filozofia, nëse i referohemi kohës kur lindi në Greqinë e lashtë, i ka bazat tek hetimi racional dhe kështu që priret drejt logjikës. Letërsia në përgjithësi dhe poezia në veçanti ka një bazë tjetër ku mbështetet, figurimi, pra figurat letrare të shumëllojshme që nga metafora, simboli, similitude, hiperbola, alegoria e deri tek metonimia. Nëse do i marrim në shqyrtim këto figura do të thoshim se ashtu si filozofia përdor arsyetimin logjik racional për të shkuar tek e vërteta, edhe letërsia i përdor ato për ta zbuluar këtë të vërtetë që duket sikur është e ndarë nga mjetet që përdoren për ta arritur. Por poezia si një gjini e shpejtë në pohimin e mendimeve është një vizion më i heshtur në krahasim me gjinitë e tjera. Një filozof e parapëlqen racionalitetin si armën e tij drejt së vërtetës, logjika e fortë dikton, ndërsa poeti ka të parën ndjenjën dhe irracionalitetin, ndjenja komandohet. Jo çdo filozof detyrimisht duhet të jetë poet i mirë, por nëse ndodh, ai mund të shprehë me shije edhe filozofinë e vet. Çdo poet i mirë, mund të jetë filozof i mirë, pasi di të gërshetojë të bukurën me logjikën. Benedetto Croce shkruan se tek filozofi ndodh e njëjta gjë si tek poeti. Nuk është ai që filozofon, por është zoti ose natyra [...] është ajo që mendon vetveten tek ai.

## III Njeriu në filozofitë e kohës

Një vështrim i shpejtë lidhur me konceptin e njeriut do të na fuste në një meditim sa të debatuar aq të kushtëzuar nga ngjarjet, rrymat, situatat, vendet. Mesjeta, si periudha më e errët e njërëzimit, kur gjithçka kishte vetëm sens unik dhe vlerë absolute, relativizmi si mendim do të rrezikonte ekzekutimin e pakundërshtueshëm përballë censurës dhe despotizmit fetar, dallohet për vështrimin e njeriut drejt hyjnisë, zotit – krijues dhe i vetmi që duhej ndjekur, sesa ndaj

vetvetes, njeriun forcë e madhe krijuese dhe ndërtuese, pra si krijesë qiellore. Rilindja ishte periudha më e guximshme dhe revolucionare që pasoi Mesjetën, në të cilën konceptet e errësirës u përmbysën me vizione drejt perspektivës natyrore dhe antropocentrike. Por do të duhej një periudhë tjetër edhe më e fuqishmë, Humanizmi që e shkëputi përfundimisht njeriun nga hyjnitë dhe e sheh atë si një qenie të natyrshme, që lëviz pa paragjykime ku jeton dhe vepron. Do të kalonte kohë dhe agimet e shkullit të ri, pra shekulli i XX, do të krijonin të tjera ide për njeriun, sepse kohët moderne kërkonin njeri të ri, modern. Njeriu i ri si koncept i pati fillesat në Itali, menjëherë pas Luftës së Parë botërore, ekzaltim i vlerave interveniste futuriste, si parim për çmplakjen e zakoneve të '800 në luftën ndaj borgjezisë.

Njeriu është objekti që lëviz si në filozofi, ashtu dhe në poezi. Njeriu është ai për të cilin flitet, me të cilin flitet, nga i cili nisemi për të reflektuar dhe kuptuar botën që e rrethon, për të shtyrë në humnerat e botës së tij të brendshme dhe ta detyrosh të arsyetojë mbi jetën. Po ai njeri është edhe në poezi, herë një femër së cilës i dedikohen vargjet më të bukura që dalin nga shpirti, herë mashkull nga i cili varen fatet e botës, të shoqërisë dhe të familjes. Poeti Franco Loi thotë se poezia e ka fuqinë ta drejtojë njeriun tek ndërgjegjia e tij më e vërtetë.

E kemi parë njeriun në të gjitha format e tij të ekzistencës në letërsi, sepse letërsia nuk mund të jetë jashtë jetës në një shoqëri, që nga njeriu primitiv e deri tek njeriu modern. Nuk ka faqe letërsie ku të mos jetë prania e tij në të gjitha epokat dhe kushtet ku ka jetuar. Poezia botërore është një arkiv i madh që, nëse e hap dhe e shfleton, do të mahnitësh me pafundësinë e njeriut, të shpirtit të tij, të ndjenjave, të imagjinatës, të gjithçkaje që ka krijuar. Në pamundësi që t'i referohesh një arkivi kaq të larmishëm dhe të pasur, kërkimet e mia ndalen tek letërsia italiane dhe pikërisht tek vargjet e poetëve italianë dedikuar qënies më të mahnitëshme dhe më të madhërishtme të jetës në kohë dhe rrethana të ndryshme.

#### **IV Njeriu tek POEZIA**

##### *a. Nëse ky është një njeri - Primo Levi*

Titulli i mësipërm është një libër që doli në dritë për të ndriçuar periudhën e hidhur dhe vuajtjet e autorit, si dhe të të gjithë bashkëvuajtësve në kampin shfarosës të Aushvicit, por edhe pas një përvoje tjetër, pozitive, jashtë telave famëkeqë, në një udhëtim lirie që ai bëri në të gjithë Europën. Historia e dhimbshme fillon me internimin e tij në kampin e përqëndrimit të Fosolit dhe përfundon fatmirësisht me lirin e tij pas mbërritjes së Ushtrisë ruse. Në faqet e para të librit autori ka shkruar një poezi hyrëse me titull "Dëgjo", ku i drejtohet hapur lexuesit që nuk është përballur me tragjeditë e jetës në lagerat e nazizmit. Do të ishte mëse e natyrshme që autori ta merrte rolin e një gjykatësi, të një vendimarrësi hakmarrës, por në zërin e tij përmes vargjeve nuk ka kurrëfarë agresiviteti dhe padurimi që të gjykojë dhe të urrejë shkaktarët e tragjedive. Dëgjo është thirrja tronditëse e një jete në kalvare, e izoluar nga bota, në pritje të fatit të zi në krematoriumet apo pushkatimet masive të pushtuesve.

Ju që jetoni të sigurt  
Në vartat tuaja të vakta  
Ju që e gjeni bukën  
Fytyra miqësore, ndërsa kthyni  
Në mbrëmje  
E mermi me mend se ky është një njeri  
Që punon në baltë  
Që nuk njeh paqe

Që lufton për gjysëm buke  
Që vdes nga një po ose një jo...

### **b. Njeriu i vetmuar, Cesare Pavese**

Fatin e bën njeriu me mendjen dhe fuqinë e vet, por ndodh që nga mospërputhja e aspiratave dhe e rrethanave ai të bjerë në trishtim e nëse një shoqëri e tërë bie në të njëjtat kushte, atëherë asnjë dritë shprese nuk do të mund ta shërojë dëshpërimin. Në udhëkryqet e kontradiktave tragjike të kohës, përsëri njeriu kërkon ta ndryshojë fatin e tij, por nëse është i vetëm, atëherë fantazmat e pamundësisë ia zënë udhën. Poeti Pavese ishte tepër i ndërgjegjshëm në rolin e vet, prandaj pati vetëdije aktive në përpjekjet për ta filluar dialogun dhe t'i shmangej izolimit që impononin kushtet, por mbeti vetëm dhe pa përkrahje dhe kur je i vetëm nuk mund të ndryshosh dot asgjë. Tek poezia e tij shfaqen në sfond dëshirat e një të burgosuri të cilat kishin kohë që ishin thurur në mendjen e tij : ëndërron të dalë, t'i provojë përsëri gëzimet e jetës, si dikur kur ndodhej jashtë atyre hekurave të mallkuar, por kur del prej tij, *njeriu i vetmuar* e kupton se e ka humbur përfundimisht jetën dhe gjithçka të shtrenjtë që ka kuptim dhe vlerë nuk i zotëron më, sepse ia kanë rrëmbyer. Asgjë nuk është më si më parë.

Njeriu i vetmuar - që qe në burg – rikthehet  
Në burg  
Sa herë që kafshon një copë bukë.  
Në burg ëndërronte lepuj që ia mbathin  
Në dheun dimëror. Në mjegullën e dimrit  
Njeriu jeton mes mureve të rrugëve, duke pirë  
Ujë të ftohtë dhe një copë bukë kafshon.  
Dikush beson se më pas rilind jeta  
Se frymëmarrja qetësohet, se dimri rikthehet  
Me erën e verës në lokalin e ngrohtë  
Me zjarrin, stallën dhe darkën...

### **c. Njeriu i kohës sonë, Salvatore Quasimodo**

Njeriu, edhe pse kanë kaluar mijëvjeçarë nga lindja e tij, është identik dhe në plan të parë duket i pandryshuar, i njëjti si dikur. Progresi është tepër i dukshëm, por natyra e tij vrasëtare mbetet po ajo : primitivët, prototipët e parë të humanoidëve vrisnin për nevojë, por edhe njeriu modern vret për nevojë, për interesa, për hakmarrje. Ka edhe një zë tjetër, tolerant, i arsyes, zëri i filozofëve dhe letrarëve që flisnin për ndërgjegje, vetëdije dhe përgjegjësi. Në një luftë ku mbizotërojnë intrigat dhe interesat, përse duhen vallë armët? Për të vrarë. Lufta është paqe! Tek poezia disa detaje të dukshme të një fushëbeteje si armët, ora, krahët e avionit kanë gjithë fuqinë dhe dhunën e armiqëve të paqes dhe lirisë. Kur autori e krahason njeriun me të shkuarin, i drejtohet historisë e cila nuk arriti ta ndryshonte njeriun. Jehona e saj dhe e ngjarjeve ndihet sipas fjalëve të poetit : ato nuk harrojnë, indinjohen, ulërijnë për dhimbjet dhe plagët e mara, kujtojnë kasapanat e përgjakshme të lufrave. Poeti në një retrospektivë rrënqethëse i referohet vrasjes së Abelit prej Kainit tek Bibla për të na vërtetuar se plojat e sotme kanë të njëjtin brutalitet, të njëjtat skena si më parë. Poetët tek poezia gjejnë të vetmin mjet për të afirmuar dinjitetin e njeriut të nëpërkëmbur dhe humanizmin që duhet ta karakterizojë.

Je ende njeriu i gurit dhe i llastiqeve  
 Njeriu i kohës sonë. Ishe në kabinën e motorrit  
 Me krahët e liga, me orët e vdekjes  
 Të pashë – brenda tankut të zjarrtë, në trekëmbësh  
 Në rrotën e torturës. Të pashë dje; ishe ti,  
 Me ndërgjegjen tënde të saktë të bindur ndaj shfarosjes  
 Pa dashurinë dhe pa Krisht. Përsëri vrave,  
 Si gjithmonë, siç vranë baballarët, siç i vranë  
 Kafshët që për herë të parë të panë...

#### *d. Poezia “Silvias”, Giacomo Leopardi*

Vitet ‘800 ende nuk e kishin çrrënjësuar të keqen e cila përsëri vazhdonte ta kushtëzonte njeriun, ta hidhte në lufta të reja që nuk mund të ishin vetëm me armë. Çdo shekull që bujtte ne jetë, kishte betejat e veta me të cilat nuk kishte asnjë mundësi të mos ndesheshe, sepse ishin natyra e brendshme e shoqërisë, ashtu si gjithmonë në përplasjet e mëdha mes së resë dhe së vjetrës. E përsëri pesimizmi, se bota do të mund të ndryshonte, shprehja më e gjallë përjetohet tek vargjet e romantikut Leopardi, që e shikon rrugëdaljen tek aleanca e të gjithëve pa përjashtim, sepse endemi të përhumur në të njëjtin fat. Njeriu duhet t’ia gjejnë ilaçin ngjarjeve makabre se vetëm kështu do ta shërojë vetveten nga natyra e vet. Tek arsyeja ai shikonte të vetmin mjet për të mbërritur tek e vërteta dhe solidariteti, pa të cilin nuk mund të arrihej fitorja. Por Leopardi shkante më tej, tek pesimizmi kozmik që natyrën e sheh si një njeri mëzore e cila e krijoi botën që njerëzit të vuajnë. Në filozofinë e tij lashtësia ngrihet e madhe dhe e lumtur, sepse njerëzimi jetoi sipas iluzioneve dhe besoi tek realiteti i kënaqësisë dhe lavdisë, ndërsa bota moderne është mediokre dhe e palumtur, jeton sipas arsyeve dhe është e ndërgjegjshme për palumturinë. Atëherë ku ta gjejmë shpëtimin – thoshte Leopardi? Rikthim, rikthim pa kushte ditëve të rinisë që mbetet gjithmonë moshë më e bukur, e shpërfillur nga problemet e mëdha të jetës. Një moshë e mbushur me ëndrra, ndjenja dhe shumë dashuri, e ndërthurrur kjo me dëshira të pafund për lavdi, por pse jo edhe me mirësinë e njerëzve dhe e natyrës. Leopardi e dinte mirë se ishin vetëm iluzione të ëmbla, pasi në vetëdijen e vet ishte i sigurt se bota është e kotë dhe asgjë tjetër nuk ofron përveç dhimbjes. Këto iluzione të gënjeshtrota në mendjen e autorit, në vargjet dhe filozofinë e tij, i kapërcejnë kornizat e individit dhe bëhen të gjithë njerëzve.

... Çfarë mendime të ëmbla,  
 Çfarë shpresash, çfarë zemrash, O Silvia ime!  
 Si na dukej atëherë  
 Jeta jonë dhe FATI!  
 Kur e kujtoj kaq shumë shpresë,  
 Një ndjenjë më shtyp  
 E hidhur dhe çngushëlluese  
 Që sërish më dhemb fatkeqësia ime.  
 Ah natyrë, natyrë  
 Përse nuk e mban më pas  
 Atë që premtove më parë? Përse kaq shumë  
 Fëmijët e tu i mashtron?...

## **Konkluzione**

Filozofia dhe Letërsia janë bashkëudhëtare të pandara nga njëra-tjetra dhe shpesh herë kufiri ndarës i tyre duket i pamundur. Është njeriu më pas, faktori që i jep jetë dhe kuptim ekzistencës sonë, ai që e bën të mundshëm këtë rrugëtim. Filozofi është përsihata e stisur e një analize të asaj që kemi qënë dhe jemi, Shkrimtari është kundrimi përmes ndjenjës i botës që ishte dhe është. Një filozof i mirë mund të shpalosë mendime dhe të bëjë interpretime me një gjuhë të pasur, mund të shkojë edhe më tej drejt një letërsie filozofike, ndërsa një shkrimtar i mirë përveç gjuhës dhe ndjenjës, do ta pasuronte mendimin e vet me meditime filozofike.

## **Bibliografia**

- H.G. Gadamer, *L'inizio della filosofia occidentale*, Guerini e Associati, Milano 1993.  
Ferroni G, *Filosofia e letteratura*, Enciclopedia multimediale delle scienze filosofiche, gennaio 1999  
Filosofia, *Enciclopedia italiana*, www.treccani.it, on line  
Letteratura, www.wikipedia.com, on line  
N. Abbagnano, *La saggezza della filosofia*, Rusconi, Milano 1987.  
Giacomo Leopardi, *Pensieri*, Successori le Monnier, Firenze 1898  
Rivista di letteratura, storia e filosofia diretta da B. Croce, *Rivista*, www.lacritica.it  
Vera Lúcia de Oliveira, *Intervista a Franco Loi*, Poesia&Poesia, 1990  
Poetët dhe poezitë e përkthyer, Internet, on line  
Levi P, *Se questo e' un uomo*, Einaudi, 1981  
Quasimodo S, *Uomo del mio tempo, Giorno dopo giorno, Tutte le poesie*, Mondadori, Oscar Grandi Classici, 1994  
Giacomo L, *Canti*, Milano, Mondadori, 1978, p. 273  
Pavese C, *Poesie*, Einaudi, 2005

## Pal Hasi dhe Andrea Bogdani autorë të cituar të një letërsie dhe trashëgimie të tretur

Besim Muhadri,  
MASHT, SIA  
Gjakovë, Kosovë  
besimmuhadri@yahoo.com

### Hyrje

Siç është e ditur, dokumentet e para të shkrimit të gjuhës shqipe i hasim që nga shekulli XV, përkatësisht që nga *Formula e pagëzimit* me autor Pal Engjëllin (1462), ndonëse gjurmë apo dëshmi të shkrimit të gjuhës shqipe datojnë edhe më herët, përkatësisht që nga viti 1332. Këtë e dëshmon edhe pohimi i murgut francez Brocardus Monacus (Guillelmus Adae), i cili në veprën e tij latinisht, *Directorium at pasagium facienda (libri I, pjesa 8)*, në mes tjerash thotë: “Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë alfabetin latin (litteram latinam) në përdorim dhe në tërë librat e tyre”. Kjo thënie e këtij murgu, që është dokument nga i cili përcakton kufirin e fillimeve të shkrimit të shqipes, me të cilin pajtohet edhe Dhimitër S. Shuteriqi, të cilin vit edhe e vë si kufi të fillimit të shkrimeve të shqipes në veprën e tij “Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850” (Shuteriqi, 1978, fq.27). Kjo është një dëshmi se në këtë gjuhë të lashtë të Evropës mbase edhe ishin shkruar libra edhe gjatë shekujve të mbushur plot errësirë harrese dhe mungesë dëshmie për shkrimin e saj dhe të botimit të librave në këtë gjuhë. Si pasojë e mungesës së dëshmimeve dhe të së vërtetës së fatit të gjuhës shqipe si dhe të lërimin të saj na vjen mjaft i vonuar edhe dokumentimi i shkrimit të librit të parë në këtë gjuhë, “Meshari” i Gjon Buzukut (1555).

Po ashtu, dëshmi të vonuara dhe të pasqaruara në masë të duhur na vijnë edhe në shekujt e mëvonshëm, qoftë për librat, qoftë edhe për autorë të caktuar, po ashtu të një kohe dhe periudhe të caktuar letrare dhe historike. Një fat të tillë do të ketë edhe Pal Hasi, njëri ndër autorët e parë të mundshëm të një libri, tashmë ineksistentë i mbetur vetëm si i cituar. Po ashtu një fat të tillë do ta përcjellë edhe të ungjin e Pjetër Bogdanit, Andrea Bogdanin, apo edhe ndonjë autorë tjetër shqiptarë, emrat dhe veprat e të cilëve, për shkak të rrethanave të ndryshme, mbetën në margjinat e kujtesës historike.

### Pal Hasi autor i dorëshkrimeve të tretura

Emri i Pal Hasit e përmend vetëm poeti i parë shqiptar dhe autori i disa librave të përkthyer për nevojat e klerit katolik të Shqipërisë së asaj kohe, Pjetër Budi, që shërbeu si prift në fund të shekullit XVI dhe në fillim të shekullit të XVII në kishat e Kosovës, Maqedonisë e të Shqipërisë veriore. Ai, cituar sipas Dhimitër S. Shuteriqit, në librin “Autorë dhe tekste”, të cilin citim e merr nga parathënia e librit të Budit “Doktrina e krishterë” (1618), ndër të tjera thotë: “Shkrova mbë gjuhu tanë ma parë do kapituj të Ditësë gjyqit, qi i gjeta shkruom Atit shumë ncë ndershmit e ncë devotshmit, frat Palit prej Hasi, të cijtë, ende me do të tjera nshtuome, disa herë tue i shkruom, kur tue pamë se ishnë për të madhe ndihmë e fruitë shpirtit t’atij populli, e aqë ma tepërë të disa priftëne, qi dëshirojinë me i pasunë, hina për gjithë ditë ka pak tue nshtuom, shkrova ende sa të tjera kafshë, sa mujta, ncë tjera gjuhush tue i nkthym mbë gjuhu tanë; e ndë e vonë, mbasi andej u dashë, erdhshë mbë Romë (...) Tue pamë se gjuha jonë asndonjë letërë e të

*mpsuom s'e ka, me të cijtë të mundëjë ndë ta me u ndihmuom feja e Krishtit, zuna fill, mund aqë sa munda, nktheva këtë shinte Doktrinë gjuhë çë lëtine mbë gjuhë t'arbëreshë(...)* (Shuteriqi, 1977, fq.64).

Kjo përmendje e emrit të Pal Hasi nga ana e Pjetër Budit, është e para dhe e vetmja që i bëhet nga një autor shqiptar apo kushdo tjetër në një kohë ndoshta jo shumë të largët kur ai kishte vdekur, sepse nuk do të hasim më asnjë gjurmë të ekzistimit të këtij personaliteti fetar dhe letrar të shekullit XVI. Megjithatë, qoftë edhe përmendja e emrit të Pal Hasi nga ana e Pjetër Budit është një dëshmi e mirë dhe argumentuese për ekzistimin e një personaliteti të nderuar siç ishte Pali prej Hasi, siç e cilëson Budi.

### **A u shkrua “Doktrina e krishterë” e Pjetër Budit mbi bazën e “Ditës së gjyqit” të Pal Hasi**

Sipas dëshmimeve që na i sjell Budi në “Të rekomanduomit”, përkatësisht në parathënien e “Doktrinës...”, Pal Hasi, apo Pali prej Hasi, siç i thotë ai, ishte autor i një libri të quajtur *Dita e gjyqit*, që doemos është një përkthim i shërbesave fetare nga gjuha latine në shqip. Dhe, po ashtu, sipas dëshmimeve të Budit, ai libër, ndonëse shumë i rëndësishëm, kishte shumë të meta, të cilat e shtynë atë që të ndërhyjë gjuhësisht e ndoshta edhe në aspekte të tjera, në mënyrë që të krijonte një libër krejtësisht tjetër, apo një kopje apo variant të zgjeruar të “Ditës së gjyqit” të shkruar apo të përkthyer nga Pali prej Hasi. “Shkrova mbë gjuhu tanë ma parë do kapituj të Ditës së gjyqit, qi i gjeta shkruom Atit shumë ncë ndershmit e ncë devotshmit, frat Palit prej Hasi, të cijtë, ende me do të tjera nshtuome...” Dhimitër S. Shuteriqi këtë thënie, apo informacion nga parathënia e Budit e “dëshifron” si një kopjim të kapitujve të “Ditës së gjyqit” nga ana e Budit (*Shuteriqi, f.65*). Fjalëe e Budit dëshmojnë qartë se “Doktrina e krishterë” është e shkruar mbi bazën e “Ditës së gjyqit” të Pal Hasi, apo, në mos jo tërësisht, ajo është shkruar mbi bazën e disa kapitujve të këtij libri të Palit, tashmë inekzistent.

Në gjuhën e studimeve letrare kësaj i thonë hipertekst. Kjo do të thotë, dhe këtë e pranon edhe vetë Budi, se “Doktrina e krishterë” është një libër i ndërtuar mbi hipertekstin e një libri tjetër, për të cilin ai na njofton vetë. Ne nuk e dimë saktësisht nëse ky libër i Budit është tërësisht i tij, apo vetëm një redaktim apo përpunim i një libri të mbetur në dorëshkrim nga Pal Hasi, i cili gjithashtu librin e tij, apo “kapitujt” e librit të tij, që i përmend Budi i kishte shkruar apo përkthyer po ashtu si një nevojë imediate për klerikët dhe komunitetin shqiptar që të gjitha shërbesat fetare i bënte në gjuhën latine, italiane dhe greke. Dhe ne, po ashtu, nuk e dimë nëse Pal Hasi vdiq i ri apo në moshë të shtyrë, ashtu sikurse që nuk e dimë as për vitin e vdekjes dhe të lindjes së tij.

### **Pjetër Budi përpunues i teksteve të Pal Hasi**

Nëse dihet Budi e nisi veprimtarinë e tij me shkrimin e librave në gjuhën shqipe duke marrë e duke i përpunuar disa kapituj të “Ditës së gjyqit” të Pal Hasi, megjithatë nuk dimë nëse këta kapituj të këtij libri, të shkruar apo të përkthyer nga Pal Hasi ishin dorëshkrim, apo libër nga i cili mori apo u shërbye Budi duke e përpunuar tekstin. Selman Riza thotë se: “... këta kapituj Budi i bëri objekt, jo të një kopjimi të thjeshtë, por përkundrazi të një ripërkijte stilistike apo më drejtë, të një ripërpunimi redaksional” (Riza, *Vehëtsia*, 119), duke e botuar atë si libër të veçantë, në të cilin botoi qindra vargje, ku vetë u bë poeti i parë shqiptar. Megjithatë, kjo të shpie kah

dëshmia dhe të forcon bindjen se tërë “Doktrina e krishterë” e Pjetër Budit është e ndërtuar nga brumi i gatshëm i gatuar nga Pal Hasi. Budi bëhet i sinqertë kur thotë se mori nga Pali i Hasit tekstin e të cilit e përmirësoi, e përpunoi, e plotësoi dhe së fundi e botoi duke e hedhur firmën e tij si autor. Në këtë rast, nëse për hartimin e librit të tij, të cilin e botoi më 1618 ka marrë nga kapitujt e “Ditës së gjyqit” të Pal Hasit, Budi është dashur që së paku në kopertinat e këtij libri (“Doktrina e krishterë”) të shkruante edhe emrin e “ncë ndershmit e ncë devotshmit, frat Palit prej Hasi”, në mënyrë që ai në këtë rast të ishte bashkautor. Por këtë s’e bëri dot, ndërsa Pal Hasin e la vetëm si autor të cituar, pas të cilit emër do të mbeten dilema, paqartësi, qoftë për kohën e të jetuarit të Pal Hasit, qoftë edhe për të shkruarit dhe të të lënit trashëgim diçka për letërsinë, kulturën dhe gjuhën tonë. Pasi që emri i Pal Hasit figuron vetëm në parathënien e librit të Budit, por jo edhe në kopertinë si bashkautor, apo autor i veçantë, atëherë ai mbeti vetëm një autor i cituar, ndonëse në këtë rast të gjitha rrugët të shpiejnë të konstatimi se ai është një autor origjinal ( vetëm te “Doktrina e krishterë” ), ndërsa Budi, siç thotë S. Hamiti te “Tematologjia”, “një përpunues i teksteve të Palit prej Hasit”(Hamiti, 2003. fq.60).

Se Budi ishte një përpunues dhe bashkautor me Palin, këtë e pohon edhe Rexhep Ismajli, duke cituar Selman Rizën (Riza, *Vehësia*, f. 119), i cili punën e këtij shkrimtari, kleriku dhe përkthyesi librash fetarë, e shihte jo vetëm si një kopjim të thjeshtë. Megjithatë, duke pasur parasysh tretjen, apo mbetjen e tij nën “hijen” e cituesit, i cili edhe mund të ketë marrë nga vepra e tij, sipas S. Hamitit (Hamiti, *Studime letrare*, 2003), Pal Hasi mbetet vetëm figurë e letërsisë së shkruar e të tretur, që jeton si farë në kujtesën popullore.

### **Dilema rreth kohës së të jetuarit dhe ajo e gjuhës dhe e alfabetit që përdori**

Ashtu siç ekziston dilema rreth autorësisë, ashtu ekziston edhe dilema e kohës kur jetoi, e gjuhës dhe e alfabetit më të cilat i shkroi apo i përktheu librat e tij Pal Hasi. Kur është në pyetje koha e të jetuarit, por edhe duke u bazuar në të dhënat që jep Budi në parathënien e librit të tij, Shuteriqi dhe studiues të tjerë të letërsisë shqipe, hamendësojnë se Pal Hasi duhet të ketë vdekur në fund të shekullit XVI, që do të thotë dikund rreth viteve 1590-1599, kohë kjo kur edhe Budi filloi shërbimin e tij kishtar në ato vende ku me siguri do të ketë shërbyer Pal Hasi. Por, nëse kemi një pohim për periudhën e vdekjes, ne nuk kemi informacione për datën e lindjes së këtij autori. “Pali ka qenë përshtatës apo përkthyes i një vepre me titull “Dita e gjyqit” dhe se ka jetuar në pjesën e dytë të shekullit XVI”, pohon Dhimitër S. Shuteriqi në librin e tij “Autorë dhe tekste”.(Shuteriqi, 1977, f.63.) Ndërkaq, kur flet për gjuhën e autorit dhe alfabetin me të cilin ai mund të ketë shkruar, Shuteriqi është i mendimit se ai duhet të ketë shkruar me alfabetin tonë të vjetër latin të Veriut, të njohur që nga Buzuku, konstatim që qëndron. Shuteriqi Pal Hasin e vendos midis Buzukut dhe Budit (Shuteriqi, 1977, f. 63).

Me këtë nënkuptohet se Pal Hasi, si një autor i panjohur, por gjithsesi interesant, mund të jetë edhe bashkëkohës i Gjon Buzukut, ndërsa vepra apo veprat e tij, të panjohura për historinë e letërsisë shqiptare, mund të jenë shkruar edhe para, njëkohësisht dhe pas “Mesharit”, ndërkaq “kapitujt” e “Ditës së gjyqit” të përmbledhur në ndonjë libër të kryer apo të pakryer mund të jenë të asaj kohe, Puna dhe veprimtaria e këtij autori, bashkë me emrin, po të mos e kishte cituar Budi, mund të ishin zhdukur tërësisht, sepse atë askush tjetër nuk e përmendi deri në atë kohë e as më vonë. Madje as Pjetër Bogdani, një shkrimtar tjetër i rëndësishëm i letërsisë së vjetër shqipe, i cili po ashtu vinte nga e njëjta krahinë nga e cila ishte Pal Hasi.

## Pal Hasi dhe Andrea Bogdani – autorë të cituar të një letërsie të tretur

E filluar nga Pali prej Hasit, *tradita hasjane e shkrimit të shqipes* nuk kishte të rreshtur. Dëshminë e vazhdimit të kësaj tradite na e forcon pohimi i Pjetër Bogdanit për një *Gramatikë latinisht-shqip* të të ungjit, Andrea Bogdani, e cila për fat të keq, para se të vinte në duart e lexuesve u zhduk pa gjurmë.

Për Andrea Bogdanin dijmë se ishte një klerik i përmendur i shekullit XVII dhe i ungji i Pjetër Bogdanit, arkipeshkv i Shkupit. Por, nëse Andrea ishte një personalitet shumë i nderuar dhe i përgatitur i kohës së tij, në shërbim të kishës dhe atdheut, ne nuk kemi ndonjë dokument që do të na dëshmonte sheshazi se ai ishte edhe një personalitet kaq i nderuar i kulturës dhe i gjuhësisë. Dëshminë se ai ishte një njeri i përkushtuar i lërimit të gjuhës shqipe, por edhe i njohjes së gjuhëve të tjera, na e ofron vetë Pjetër Bogdani në parathënien e “Cuneusit...”, ku thotë se i ungji i tij kishte shkruar “një gramatikë fort të godiçime latine-shqip”. Vepra në fjalë, e cila ishte gati për botim, nuk ishte botuar deri në atë kohë, mbase për shkak të moslejimit nga ana e propagandës Fide, apo edhe për ndonjë arsye tjetër, pengesa dhe vështirësi të cilat i kishte pasur edhe vetë Pjetri për botimin e librit të tij “Çeta e profetëve”. Sipas Pjetër Bogdanit, gramatika latinisht e shqip e Andrea Bogdanit, të cilën pas vdekjes së të ungjit e mbante ai vet, si një testament të rëndësishëm të punës së të ungjit në fushën e gjuhësisë shqiptare, i humbi rreth vitit 1684, kur edhe vdiq Andrea. Dëshminë për humbjen e gramatikës së të ungjit e mbështesin, apo e marrin si argument të ekzistimit të kësaj gramatike edhe studiuesit shqiptarë, Dhimitër S. Shuteriqi, Selman Riza, Jup Kastrati, I. Zamputi, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Rexhep Ismaili etj. Shuteriqi në shënimet që jep për këtë dëshmi në librin *Shkrimet shqipe të viteve 1332-1850*, është i bindur se Gramatika e Andrea Bogdanit për të cilën flet Pjetër Bogdani ishte shkruar për nevojat e mësimin të latinishtes prej klerit katolik shqiptar, ashtu siç ishin shkruar edhe disa tekste gramatikore para tij. “Pjetri thotë se i ungji e dinte mirë shqipen dhe e pati ndihmuar dhe nxitur për të shkruar veprën e tij “Cuneus...”. (Shuteriqi, 1978, fq.80).

Pra, shikuar nga ky prizëm, Andrea Bogdani, përpos që ka mbetur një personalitet shumë i nderuar i kohës, na del edhe një autor tekstesh të rëndësishme, siç ishte hartimi i një gramatike. Ai ishte njohës i mirë i shqipes dhe i latinishtes, prandaj, duke qenë një gjuhëtar i mirëfilltë, kishte arritur të shkruante një gramatikë shumë të qëlluar, apo siç shprehet poliglotti dhe prozatori i parë i shqipes, Pjetër Bogdani, “fort të godiçime”. Gramatika në fjalë, për shkak të rrethanave tragjike që e përcollën kombin shqiptar, e bashkë më të edhe kulturën, gjuhën dhe intelektualët shqiptarë, humbi, apo siç pohon P. Bogdani “u tret si kripa në ujë”, që do të thotë u zhduk. Kjo gramatikë, humbja e së cilës doemos se paraqet një humbje të pakompensueshme për gjuhësinë dhe për kulturën e gjithëmbarshme shqiptare, me siguri do të jetë tretur dikund maleve dhe shpellave kah u strehua dhe u fsheh Pjetër Bogdani në kohën e ekspeditave turke në pjesën e dytë të shekullit XVII. Atë mund ta ketë mbuluar pluhuri i kohërave, apo flakët e luftërave, por dëshmia e Bogdanit se i ungji i tij kishte shkruar një gramatikë fort të goditur, është për t’u besuar. Librin në fjalë nuk e kemi, ashtu sikurse nuk e kemi as librin “Dita e gjyqit” të Pal Hasit, por për të janë dëshmitë. Përderisa për Andrea Bogdanin flet një i afërm i tij, përkatësisht nipi, që u dëshmuua dhe ka mbetur një nga figurat më universale të kohës së tij, për të dytin, për Pal Hasin flet një personalitet tjetër, po ashtu i rëndësishëm i kohës, Pjetër Budi, një autor i cili letërsisë dhe gjuhës shqipe i la një dëshmi fundamentale dhe një visar shumë të çmuar.

Dhe nëse Pal Hasi, sipas dëshmimeve të Pjetër Budit është një autor që kishte përkthyer apo përshtatur pjesë nga libri i shenjtë, tjetri, pra Andrea Bogdani, është hartues i një gramatike

dygjuhëshe. Ata kishin të njëjtin qëllim: Të shkruanin apo të përkthenin tekste për nevojat e kishës dhe të klerikëve katolikë shqiptarë, të cilët kishin vështirësi në kuptimin e latinishtes, apo të italishtes, në të cilat gjuhë edhe predikoheshin ritet fetare në kishat shqiptare të asaj kohe. Dhe tendenca për hartimin e librave të veçantë, për nevojat e klerit katolik shqiptar, ishte një tendencë e një rëndësie të madhe, e cila shoqërohej me rreziqe të mëdha, madje edhe me jetë, siç i kushtoi Budit, por mbase edhe Pal Hasit dhe ndonjë autori tjetër.

### **Përfundim:**

Siç shihet Pal Hasin dhe Andrea Bogdanin i përcolli fati i keq i mosnjohjes së veprave dhe i fryteve të punës së tyre shumëvjeçare. Përveç kësaj, ata i përcolli edhe një fat tjetër i përbashkët: në mungesë të dëshmimeve, pra të ekzistimit edhe në mënyrë fizike të veprave për të cilat flasin Pjetër Budi e Pjetër Bogdani, ata i përcolli fati i mbetjes vetëm si autorë të cituar, apo siç do të thoshte studiuesi Sabri Hamiti, autorë të një letërsie dhe trashëgimie të tretur.

Megjithatë, veprat e Pal Hasit dhe të Andrea Bogdanit, qoftë edhe në këtë formë, arrijnë të komunikojnë në formën dhe mënyrën e tyre, duke përçuar tërë kompleksitetin e veçantisë dhe të rëndësisë së tyre kulturore letrare, gjuhësore të një kohe të caktuar, gjithësesi të rëndësishme, në shkallë kombëtare. Ata, padyshim janë dhe do të mbeten emra që nderojnë kulturën tonë të lashtë dhe dëshmojnë për një traditë tonën letrare dhe shkencore shumë më të hershme se sa ajo që na vijnë dëshmitë.

### **Referencat**

- Budi, P., 1986. *Poezi (1618-1621)*, Prishtinë: Redaksia e Botimeve “Rilindja”.
- Bogdani, P., 1989. *Çeta e Profetëve*, Prishtinë: Redaksia e Botimeve “Rilindja”.
- Hamiti, S., 2003. *Studime letrare*, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.
- Hamiti, S., 2005. *Tematologjia*, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.
- Ismajli, R., 1986. *Parathënie e librit “Poezi” të Pjetër Budit*, Prishtinë: Redaksia e Botimeve “Rilindja”.
- Rugova, I., 2005. *Vepra e Bogdanit*, Prishtinë: Shtëpia Botuese “Faik Konica”.
- Shuteriqi, S. Dh., 1977. *Autorë dhe tekste*, Tiranë: Shtëpia Botuese “N. Frashëri”.
- Shuteriqi, S. Dh., 1978. *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Prishtinë: Redaksia e Botimeve “Rilindja”.

## Konceptet estetike në veprat e shkrimtarit Koço Kosta

**Ermelinda Kashahu**

Universiteti Eqrem Cabej,

Gjirokastër, Shqipëri

[e.kashahu@gmail.com](mailto:e.kashahu@gmail.com)

### Hyrje

Rruga nëpër të cilën ka kaluar letërsia shqipe për të fituar përmasat e një letërsie kombëtare dhe individualitetin e plotë artistik, ka qenë e gjatë, e vështirë dhe e ndërlikuar. Ajo ndoqi fatin e popullit të saj për një kulturë kombëtare. Brezi i këtij shkrimtari e thellon më shumë dimensionin kreativ të kohës, botës së re që po ndërtohet, dimension ky që dëshmon nivelin e arritjes sonë. Në rrugën shekullore të zhvillimit tonë si komb, pati ngecje, zvarritje, çaste krizash sidomos në aspektin e ekzistencës, mbase këto rrethana kushtëzuan tiparet e karakterit të njeriut. Autori nëpërmjet retrospektivës, shtron mendime të ndryshme, që kanë të bëjnë me jetën, shoqërinë dhe realitetin në terësi. Potencion çështjen e funksionit të artit si vetëdije e thellë e një kohe dhe e një shoqërie. Të mos harrojmë se arti si përgjegjësi për efektin që duhet të ushtrojë në natyrën dhe edukimin e qënies njerëzore, një mënyrë të tillë të strukturimit të përmbajtjes së vizionit artistik, si faktor ndërmjetësues ndërmjet shumëllojshmërisë së përmbajtjeve të jetës, të historisë, të traditës dhe artit, manifestohet fuqishëm dhe në mënyrë të shkallëzuar në gjithë lëndën e kësaj vepre. E themi këtë, sepse shkrimtari në fjalë nuk është i çfarëdoshëm në botën shqiptare, por një figurë qëndrore me rrezatim të gjerë, me peshë specifike në ecurinë progresive të letrave tona dhe një pikë referimi në rrjedhën e drejtimit e kulturës sonë. Temperamenti egocentrik, sado ndërlkime që i sollti personalitetit të tij, nuk ia errësoi figurën shkrimtarit në historinë e letërsisë shqipe.<sup>1</sup> Është një individualitet i spikatur, mendimtar, krijues e njeri, që e begatoi universin letrar. Bota intelektuale e tij, është bota e kulturës njerëzore, e letërsisë dhe e psikologjisë së njeriut. Shkrimtari depërtoi në hapësirat e lirisë, me shpirtin kërkues, një sferë kjo, ku synimet e tij ishin të kushtëzuara nga rrethanat dhe kërkesat e kohës. Shikuar në përgjithësi, mund të thuhet se, Koço Kosta është shkrimtar i ideve dhe i gjykimit të thellë, shkrimtar i cili sintetizon në mënyrë harmonike urtësinë dhe mençurinë popullore me reflekset dhe gjykimet intelektuale, arrin drejtpeshimin midis fjalës dhe idesë, midis traditës dhe së resë, midis subjektives dhe objektives, lokale dhe universale.

Sfida e kësaj kumtese është sa dëshmuese dhe historike, aq estetike dhe etike. Fashikullimi i kësaj sfide është krejt i brishtë në fillimet e atyre viteve, thajse inekzistente, por të mirëpërcaktuar. Shkohet nga intimitja tek bota, nga qenia unike tek qenia shoqërore. Me inteligjencën shqiptare, me forcën dhe kurajon për të mos u shterur, për të mos u atrofizuar, hyn një qëndresë e një tipi tjetër që rreket të përjetësojë të njerëzishmen, të bukurën, shijen e së mirës dhe sensualen. Shkrimtari gjen çelësin e duhur për të mos e zbehur dritën e kësaj enigme. Tashmë përmes shkrimit tim ju ftoj bujarisht të përjetoni dhe shijoni estetikisht preciozitetin e shkrimtarit, të një jete unike.

Koncepti “art” është një abstraksion shkencor, që shënon anët më thelbësore, të përbashkëta, të dukurive shumë të ndryshme artistike. Dimë fare mirë se, detyra më e parë e historisë së letërsisë së një populli, është sigurisht të studiojë dhe të vendosë në kohën e vet jetën dhe veprën e shkrimtarëve që kanë krijuar këtë letërsi, të vështruar kronologjikisht e në lidhje të ngushtë me rrethanat historiko-shoqërore, rrethana këto që përcaktojnë brendinë e saj, një progres që vihet në akumulimin e pandërprerë të vlerave artistike, duke u shtuar nga njëri brez në brezin tjetër. Të mos harrojmë se masa që gëzojnë dhe përjetojnë sot vlerat artistike është më e madhe se kurrë, madje dhe niveli i shijeve të veprave letrare vjen duke u rritur, ndonëse brenda rrethave shoqërore kjo prirje përcillet. Ashtu si një progres i cili ka një karakter relativ e jo absolut, ashtu ndodh edhe me veprat. Por veprat e shkrimtarit në fjalë gëzojnë një respekt të veçantë.

Kumtesa i kushton vëmendje të veçantë shkrimtarit në fjalë, zërit të fuqishëm dhe të spikatur, autorit që rrahu shtigjet e panjohura të palëvruara gjer atëhere, vepra e të cilit mbart në mënyrën më të qartë, të përqëndruar e nga shumë anë tendencat më të dukshme dhe thelbësore të zhvillimit të letërsisë sonë. Përse e themi këtë ? Gjithmonë para shkrimtarëve ka qëndruar detyra të pasqyrojnë drejt në veprat e tyre proceset dhe prirjet themelore të letërsisë, të thellojnë karakterin kombëtar të letërsisë e krijimtarisë, të luftojnë çdo shfaqje të skematizmit. Ngarkesa emocionale e një veprë nuk fitohet si pasqyrimi mekanik i jetës, sepse dihet që një vepër të pasqyrohet në art duhet të krijojë për lexuesin vlerat e njohura estetike. Nëse një vepër nuk më shkakton gjithmonë emocione positive estetike, atëherë do mbizotëronte komikja në këtë vepër. E kënaqur estetikisht me veprën e K. Kostës, e vlerësoj shkrimtarin për majat e idealit pozitiv, gjë që më ka lejuar t’i afrohem sa më afër këtij ideali. Shkrimtarit nuk i mungon koncepti estetik për jetën por duke kaluar nga një epokë në tjetrën, ka arritur në përfundimin se, të njohësh gjuhët specifike të llojeve të ndryshme të artit është i domosdoshëm edukimi artistik që përcjell një vepër letrare për subjektin dhe objektin që krijon, duke kuptuar artin që është i aftë të kënaqet me bukurinë. Kjo është edukata estetike dhe e pandërprerë, ky është përjetimi artistik, ky është akti njohjes që nuk përmbledhet vetëm në përjetimin emocional të veprave të shkrimtarit.

Po të shohim me kujdes, vëmë re se për t’i arsyetuar pikëpamjet, botëkuptimet dhe veprat e tyre, jepet parahistoria e tyre në mënyrë retrospektive. Këto janë personazhe statike të cilët përkundrejt zhvillimit dhe veprimit të situatave, nuk pësojnë ndryshime në botën e tyre të brendshme. Personazhi i shkrimtarit tonë nuk përcakton aksionin dhe çdo tregim, nuk konstituon në përshkrimin e karaktereve. Shkenca e estetikës ka provuar se, vepra krijohet për t’u pëlqyer nga lexuesit dhe është e vërtetë që vepra e këtij shkrimtari përjetohet në sfondin e përvojës estetike të çdo lexuesi të përveçëm dhe ku bëhet më e kapshme nga çdo lexues, atëherë thjeshtëzohet dhe e pajis veprën me vlera estetike. Vetëm kështu, me këto ide, ashtu si idhtarët e “estetikës së veprës së hapur”, edhe Koço Kosta paraqitet si zëdhënës i kësaj shoqërie që krijon këtë art të madh.<sup>2</sup> Prerjet tematike nuk të japin dorë gjithmonë për të studiuar një periudhë apo dukuri letrare, të paktën në një letërsi relativisht të vogël si letërsia shqipe. Kur janë të ngjashme rrethanat letrare e jashtëletrare, kur procesi letrar zhvillohet në qarqe të vogla e shumë të vogla, tema bëhet modë e moda kalon shpejt. Në fakt, dhimbja është jo vetëm tabu por edhe kryetema e letërsisë pas realizmit socialist. Ashtu siç është e pafund dhe misteri intrigues e tërheqës në botën e njeriut, ashtu janë dhe trajektoret stilistike që funksionojnë në jetë të jetëve për zbulimin e tyre.

## Konceptet estetike

E madhërishmja dhe e bukura

E madhërishmja është gjithmonë identike, e barabartë me të bukurën. Ashtu si në krijimtarinë muzikore të Bethovenit që spikat fort shkrimja e së madhërishmes me të bukurën, kështu ndodh gati në çdo vepër të këtij shkrimtari. Qysh në leximet e para nuk është vështirë të konstatohet emocionet estetike që lindin nga fenomenet e së madhërishmes, të veprave të tij që më kujtojnë piramidat e lashta të Egjyptit. Veprën e këtij shkrimtari e shohim të personifikuar në mënyrën më të plotë, në shkallën më të lartë, të shoqëruar me kënaqësinë pozitive estetike. Romani është një mozaik letrar, terësia e të cilit e përbën librin, prozën e shkrimtarit si përfaqësuese të prozës së sotme shqipe. Bukuria e të rrëfyerit lë të nënkuptohet se letërsia ende nuk i ka shpenzuar energjitë, ende ka për të thënë për shpirtin e njeriut dhe ende ka mundësi ta magjepsë lexuesin.<sup>3</sup>

Përjetimi i sfondit romantik. Shembull. *Sofie Kondili mbulohet me trishtim*. “unë u rrita që të martohem e të flë me mashkull e jo me kac burrë”...unë dua burrë...lojta. Në këtë mankth kulmor kemi ndërthurjen e nevojës për mëmësi dhe nevojës për dashuri sublime. Realizimi vetëm në natën e fundit përfaqëson vetëm plotësimin momental, dhe kjo është një dramë e thellë njerëzore e cila shkon përtej një nate të bardhë perëndie. Shembull. Siç thamë në nr 4, 1986 në “Nëntori”, u botua pjesa e parë e novelës “Ata të dy dhe të tjerë”. Vepra ngjalli interes të veçantë. Pritej me kërkësi pjesa e dytë në nr 5. Po në vend të saj ndodhi një lëkundje sizmike e frikshme, që e kishte epiqendrën në pultin e komandës së diktaturës. Ata nuk donin t’ja dinin për shijet estetike, letrare dhe as për dinjitetin artistik.

Cilësia dhe sasia tek e madhërishmja

Estetët natyralistë e quanin diçka madhështore, tokësore dhe njerëzore, lidhjen e së madhërishmes me sasinë. Por lind pyetja: Sasia e veprave të shkrimtarit, a e bën të madhërishtëm shkrimtarin tonë? Ky është një koncept realist. E madhërishmja është fenomen i realitetit i cili gjithmonë shoqërohet me kënaqësi pozitive estetike, na ngjall një ndjenjë gëzimi, të afërt me atë ndjenjë që shkakton emocione estetike apo perceptim të së bukurës së veprave të shkrimtarit. Njohja dhe studimi i këtij individualiteti artistik kërkon doemos që të depërtohet në hapësirat e artit të tij, të hyet në laboratorin e punës së shkrimtarit, të zbulohen të fshehtat e mjeshtërisë së rrëfimit. Tiparet origjinale të artit të shkrimtarit, nuk mund të hetohen pa dalë i qartë vokacioni që përfaqëson në letërsinë tonë. Kujtojmë këtu “Nata e Sofie Kondilit”, një roman tipik me aluzione të forta, një roman plot tension, ku aluzionet mund të shkojnë deri te joshjet e lirisë së periudhës poskomuniste, por ja që ky roman u bë më pas zëri i jehonës së shoqërisë që jeton te ne. Polifonia e detajeve esenciale në harmoni me njëra-tjetrën, shkon deri në gjendjen e përbushjes së dëshirave dehëse dhe erotike. Bukuria e veprave të tij ka vlerë artistike e që shfaq atmosferën shpirtërore të personazheve në lidhje me tendencat estetike dhe artistike si klimë e asaj kohe. Por, në art, dihet se nuk është kurdoherë sasia që përcakton vlerën e një shkrimtari. Edhe pse bilanci sasior i krijimtarisë artistike është i kufizuar, në të vërtetë ai u mor me letërsi tërë jetën. U mor në kohë të ndryshme, pas intervalesh të gjata, aq sa veprat letrare të mirëfillta duken episodike, të vështuar në sfondin e veprimtarisë së gjithanshme. Burimi i parë ka të bëjë me “Itinerarin jetësor” të tij.

## Burimi i dytë ka të bëjë me leximin

Specifika e korelacionit midis shkrimtarit dhe jetës, kohës dhe vendeve në të cilën ai vepron, jo vetëm sugjeron përherë “lëndën jetësorë”, subjektet, por i materializon në vepër. E madhërisht shfaq format më kryesore të trupëzimit të veprave më të plota. Brenda marrëdhënieve estetike me fenomenet e madhërishtme të realitetit e të artit, veprat kanë një ndjenjë kënaqësie të fortë, të thellë, shoqëruar me emocionin specifik që shoqëron perceptimin e fenomeneve që përmban romani kolosal dhe i madh. *Tipikja në vepër*. Çdo fenomen i veprave të shkrimtarit shërben si përgjithësim artistik. Forca tipizuese shfaq individualizimin e figurave artistike<sup>4</sup> (“Dademadhja”, Tiranë, 1976. “Era e udhëve”, Tiranë, 1981.

*Karakterit akseologjik*. Njohja e realitetit të veprave është pasqyrim i ndjenjave dhe i mendimeve që shfaqin një qëndrim aktiv ndaj çdo emocioni dhe mendimi që shkakton realiteti i veprave. Ashtu si Floberi dhe Heminguej që kanë qenë përpjekur ta shprehin në mënyrë të tërthortë qëndrimin e tyre vlerësues ndaj jetës, ky element nuk i ka munguar asnjërës prej veprave të tij. Elementi vlerësues, njohës dhe pasqyruës, i hap rrugën artit të tij.

*E reja*. Parasëgjithash, më duhet të pranoj se, jo vetëm tek veprat e tij, por në të gjithë veprat në terësi, personalisht nuk mund të kundërshtojë asgjë nga ana estetike. Shkrimtar kërkuës, i pasionuar dhe i rafinuar në mendim, me energji lëvizëse të botës njerëzore, kërkon qëllimin e vetvetes, kërkon qelizën promotore të të gjithë veprës së tij. Mund të thuhet pa frikë se, është po ky, që i ka dhënë komunitetit njerëzor një roman të përmasave bashkëkohore.

*Dhimbja*. Duket sikur në vepër ka një dramatizëm mes personazheve, por jo. Ato thjesht shfaqin formën e ndjeshjeve jetësore të ashpra. Mbishtresat simbolike janë shenjë e stilit modern, e parashenjave si vijimësi emocionesh. Fjalori është i begatë. Frazja, si e përshkrimit ashtu dhe e rrëfimit, është e shkurtër dhe shpreh shumë kumtime. Një frazë e tillë shenjon shëmbëlltërinë e jetës, krijon gjerësinë e rrëfimit dhe të përshkrimit.

## Përfundime

Shkrimtari të fut në gjuhën e përditshmërisë dhe kjo është një pasuri e madhe letrare dhe gjuhësore, një shprehje e drejtpërdrejtë e pasurisë së mendimeve, të ndjenjave që janë ndryrë në të. Koha e rrëfyer jep hapësirën dhe mjedisin ku zhvillohen ngjarjet, krijon ngjyresën historike të atyre viteve. Tani mendimi dhe morali do të jenë të çpënguar nga paragjykimet kohore, tani arti i autorit është më universal dhe human, tani shkrimtari do të besojë se jeta ka si timon çlirimin nga paragjykimet, demokracinë dhe lëngun nga është ushqyer romani i tij. Ky është utopizmi i ndjenjave, kjo është bota qiellore nga ku mund të çlirohen njerëzit. Përfundimet tona do të na i plotësonte mendimi i studiueses gjermane Kete Hamburger, “Logjika e letërsisë”, ku thuhet se: “Nuk ka asnjë kriter ekzakt as logjik, as estetik, që do të mund të na sqaronte nëse mundemi ta identifikojmë subjektin rrëfyes. “Angazhimi i detyruar” i kohës së diktaturës, rreptësia e rregullave sunduese që nuk buronin aq nga një progres krijues i vendosur nga vetë shkrimtarët, po nga direktivat e “partisë shtet”, nuk mundi të shuante larminë e individualiteteve krijuese. Në “shtratin e Prokustit të rregullave të realizmit socialist, u shtrinë rehatshëm vetëm talentet e dobëta, talentet e forta u bënë qëndresë atyre rregullave dhe arritën të çarat e armaturës së

dukshme elemente të realizmit kritik që nuk pati kohë të zhvillohej krejtësisht dhe të arrinte pjekurinë në letërsinë shqiptare dhe madje elemente të modernizmit. Kjo bëri që të mbizotëronin të gjitha kategoritë: e dhimbshmja, e bukura, e madhërishtja etj.

## Shënime

Kosta,Koço. Refleksion: *Koço Kosta rrëfen vetveten: Diçka për vete dhe për romanin*: “Ata të dy dhe të tjerë” –refleksione, shkrimtari rrëfen vetveten në “Tema”. -Nr 1641,9 dhjetor, 2005,f.20-21.

Berisha.N.Anton. Veçanti ligjërimesh poetike.Fq.44  
Uçi, A. vëllimi 2,Esteka.)

Kosta,K. ( “Dademadhja”, Tiranë, 1976.

Kosta, K.“Era e udhëve”, Tiranë, 1981.

## Bibliografia

Myftiu, Mehmet. *Dashuria e burimeve të jetës* . “Drita”, f.6.

Kallulli. Adriatik. *Kërkime dhe gjetje të reja novatore*, “Nëntori”,nr 6.

Braho, Ibrahim. “Era e udhëve , një vëllim i bukur “Nëntori”, nr 7, fq 70-72.

Tomitore, T., “*Storia delle sinestesie*”,1997

Uçi, Alfred. *Labirintet e modernizimit*”, 1978

Dilaveri, Dilaver.1982. *Disa karakterizime të prozës së Koço Kostës*. f. 141.

Çela, Zija. *Jetë që vjen në art*. Vëllimi me tregime: “Era e udhëve”, Në: “Drita”, 8 gusht 1982, f.5-6 .

Bihiku, Koço. *Njerëzit e ditëve tona në prozën e sotme*, Studime filologjike, nr 2, 1984, f.8-9.

Aliu Ali. Koço Kosta.- Në “Jeta e re” , Prishtinë, nr 5, shtator-tetor 1978, f. 627-629 .

Kuçuku, Bashkim. *Me personazhet e një vëllimi* : Koço Kosta, Bisedë në mesnatë, Tiranë: “Naim Frashëri”,1971. Në “Nëntori”, nr 9, shtator 1972, f.12-18.

Kuçuku, Bashkim. *Vendin e parë njeriut të tokës*. (Koço Kosta,“Dademadhja”, Tiranë , “Naim Frashëri ”,1976). Në “Nëntori”, nr 8 , gusht 1977, f.144-154.

## Autsajderi si personazh qendror në raport me personazhet femra

**Fatmire Vejseli**

Universiteti i Evropës Juglindore

Tetovë, Maqedoni

[f.emurllai@seeu.edu.mk](mailto:f.emurllai@seeu.edu.mk)

### 1. Marrëdhënia në mes bartësit të vajzës dhe autsajderit

Në këtë dramë do të prezantoj personazhët femra, në fakt, raportin e tyre me të riun Rele. Analiza e personazhit të Olga Beroter, tregoi një formulim të mundshëm të tezës që kjo femër, përfaqësuese e gjeneratës së re është një figurë femërore paralele e Rele-ut.<sup>5</sup>

Por, hulumtimi më i detajuar tregoi se Olga për dallim nga Rele, nuk përshtatet në skemën e njëjtë të viktimave në mjedisin jetësor. Kështu që në fund edhe Olga bëhet qëllim i brutalitetit dhe mostolerancës së një grupi të rinjesh, Mariluize Flajser tregon për një mënyrë moderne të gjuetisë së shtrigave, por tregon edhe se në ambientin e ulët kristian, pothuajse asgjë nuk ka ndryshuar që nga koha e Grethenit të Gëte-s dhe Klara e Hebelit.<sup>6</sup>

Megjithatë, deri në fund të dramës, shkrimtarja e prezanton Olgën, si anëtare të grupit. Ajo nuk është radikalisht më ndryshe. Por Rele është radikalisht ndryshe<sup>7</sup>. Olgën mund ta shohim edhe si një tip shumë të njohur femre - një grua e re, e pamartuar dhe me fëmijë - në një shoqëri tradicionale. Rele iriton, askush nuk mund ta sjellë në vete. Ai është diçka krejtësisht ndryshe, dhe prandaj në të shumtën e rasteve është si një cjap viktimë në krahasim me Olgën.

Kjo është edhe thelbi i marrëdhënies së Olgës me Rele-un. Autorja bën eksperiment ku dy autsajderë tipikë dhe viktimë, Olga dhe Rele, do të kishin mundur disi të bien në ujdj, ndoshta edhe të jenë solidarë. Mirepo, kjo nuk bëhet.

Fjala vendimtare në lidhje me këtë bie që në pamjen e pestë:

Olga: Ju mendoni se Olga do të ndihmojë. Olga nuk ndihmon.

Rele: Tek ju kërkoj vendstrehim.

Olga: Kapeni.

Rele: Në ç'tokë jam unë?

Olga: Në tënden, ku të afërmit tënd nuk i lejohej asgjë tjetër, pos të pëlçasë.

---

<sup>5</sup> Sauer 1991, 38.

<sup>6</sup> Rühle 1972, 11 ff.

<sup>7</sup> Për temën për kreativitet social të Tjetrit absolut, gjithmonë thirrem në studimet e Mishel Fuko-së. Kuptimi i tij mbi Tjetrit absolut, mund lehtësisht të lidhet me kuptimin mbi diferencimin të Derida dhe Lakan, i pranuar nga shumë feministe

## **2. Amësia dhe autsjaderi**

Për Rele-un, portreti i nënës ka një ëndësi të veçantë, dhe kjo ishte objekt i analizës tonë të Rele-ut si dhe analiza e nënës së tij. Babi Beroter, në një mënyrë interesante, ndryshe nga të gjitha figurat e tjera në dramë, tregon empati, simpati dhe respekt ndaj Rele-ut. Këtu mund ta ngjirim tezën se kjo ka të bëjë me integrimin e amënores në personazhin e babait.

Në këtë mënyrë krijohet një imazh ideal i prindërve, kurse personazhë të vetëm baballarësh apo nënash, tek MLF mund të shihen vetëm në kuptimin negativ. Respektivisht në Purgatori në Ingolshat nuk ka baba negativ. Rolin e mjeshtrit Anton të cilin e hasim tek Hebeli, në dramën e MLF padyshim e merr nëna e burrit të ri Rele.

Ajo e paraqet shembjen e subjektit njerëzor që në formën primare të intersubjektivitetit, në komunikimin mes nënës dhe fëmijës. Shkrimtarja tregon se autsjaderizmi radikal dhe fatkeqësia jetësore e Rele-ut, u krijuan në atë kohë shembjeje nga fëmijëria e herëshme. Në jetën e mëtutjeshme të Rele-ut, i afërimi primar i njeriut, nëna, e dënon fëmijën, devijacionet e të cilit i shkakton vetë ajo.

Këtu qëndron edhe një nga bërthamat e analizës së intersubjektivitetit të MLF. Pikërisht ai personalitet, i cili fëmijës duhet t'i krijojë hapësirë jashtë procedurave destruktive të socializimit, bëhet ekzekutuese e normave destruktive. Me këtë, nëna e Rele-ut, e rënon atë që vetë e ka krijuar. MLF dëshiron ta paraqesë karakterin vetëshkatërrues të mjedisit jetësor dhe të socializimit të vazhdueshëm.

Edhe nga ky aspekt, gjithnjë e më shumë, vërtetohet teza se në konceptin e MLF, bëhet fjalë parasëgjithash për paraqitjen dhe analizën dramaturgjike të ndalimit, respektivisht shembjen e intersubjektivizimit.

## **3. Personazhët e tjerë femra dhe autsjaderi**

Klementina Beroter dhe Hermina Zajc e paraqesin fundin tjetër të shkallës. Ata i përkasin grupit të gjeneratës së re femërore e cila nuk ka ndonjë problem me integrimin në shoqërinë e ulët ekzistuese.

Prandaj Klementina Beroter gjendet në mes, midis së motrës Olgës dhe vajzës së fqinjëve, Hermina. Në fillim ajo është e prezantuar si vajzë e cila është e orientuar nga babai. Kjo do të thotë se ajo, ashtu sikur edhe babai Beroter, kanë marrëdhënie pozitive me Rele-un. Duket sikur ajo ndjen dashuri dhe sikur në një periudhë të caktuar dëshiron të luftojë për të.

Pak nga kjo simpati mbetet deri në fund. Në fakt, Klementina i përket grupit normativ të rinjëve i cili tubohet në tavanin e shtëpisë së Beoterëve, por ajo është prej atyre të pasulmuarave, më pak agresivët. Edhe në momentin kur edhe Olga kthehet kundër Rele-ut, ajo kyçet, por vetëm në mënyrë pasive, me neveritje:

Klementina: Por ai po bëhet tërësisht i gjelbër

[...]

Jo, ma hiqni. Të mos e shoh me sy.

[...]

Nuk mund më ta nuhas këtë njeri!

Klementina, megjithatë nuk ofron rezistencë eksplicite kundër mundimit të Rele-ut nga ana e moshatarëve të tij, por dalëngadalë u bashkangjitet atyre. Olga dhe Klementina kyçen në mënyrë emocionale primare, në gjueti të ndryshme moderne të shtrigave të gjeneratës së re. Atyre u mungon një nivel reflektiv i cili tmerrin dhe jotolerancën i lidh në një koncept ideologjik.

Në këtë pikëpamje, Olga dhe Klementina i përkasin botës së nënës së Rele-ut, e cila gjithashtu nuk ka pikëpamjet e veta dhe e favorizon papjekurinë specifike të gruas në krishterizmin, i cili kishte rënë në nivel mjaft të ulët.

Është më ndryshe me Hermina Zajc. Jo më kot, shkrimtarja i lejon kësaj gruaje të re, të paraqitet në mënyrë indirekte kur ajo e paraqet babain Beroter si ideal i vajzave të veta ( në pamjen e parë). Ajo është mishërim i një tipi femre, të cilës i përket e ardhmja e botës së MLF, i karakterizuar si fashizoide. Në lidhje me maltretimet e Rele-ut, nuk shfaq kurrfarë emocionesh, ashtu siç nuk kishte pasur asnjë raport emocional ndaj tij.

Për të, ai është objekt teknik, respektivisht një lloj miu eksperimental. Dhe atë, me qëllim që në mënyrë racionale dhe efektive të realizohet eksperimenti në lidhje me normat e shoqërisë në të cilën nuk guxon të jesh subjekt. Këtu MLF, e tregon atë tip të racionalitetit dhe efektivitetit me të cilin në historinë reale të Gjermanisë, ishte skicuar dhe realizuar perfeksioni i kampeve të përqëndrimit<sup>8</sup>. Ky tip gruaje, ka një mendje të ftohtë specifike që të kujton sjelljen e likuidatorëve të Kafka. Tek Hermina ka dhe një aspekt për atë se si duhet të duket marrëdhënia normative mes burrit dhe gruas në këtë botë të re të ftohtë të brutalitetit joemotiv. Kjo është paraqitur në “storien e fundit të dashurisë” në dramën PI, marrëdhënia mes Herminës dhe Peps- it.

Një nga aspektet më interesante është edhe ai, sipas të cilit MLF tregon se në këtë botë racionaliste e cila bazohet në materializmin e ri dhe naci – etosin, më nuk mund të formohen subjekte të pjekur individualisht. Zhduket dallimi mes burrit dhe gruas. Në rrafshin e brutalitetit joemocional sundon abstrakcioni i pastër i social-teknologjisë. Seksualiteti bëhet faktor i pastër funksional. Në fund Hermina mendon dhe flet sikurse Peps-i. Aq sa edhe *mashkulli dhe femra* mund të këmbehen.

Këtu ballafaqohemi me filozofinë specifike të konkretizimit, të cilën MLF e merr nga Breht-i, por në mënyrë shumë origjinale e përdor në një mjedis jetësor konkret, të atij të njerëzve të rinj real nga fillimi i shekullit XX.

---

<sup>8</sup> Kjo është shumë e përafërt me idetë e Adorno/Horkhajmer, 1991 në Dialektik der Aufklärung.

## **Përfundime**

Në këtë punim jemi përpjekur të përpunojmë kuptimin themelor dhe performancën aktuale mbi "intersubjektivitetin" tek Mariluize Flajser. Për këtë qëllim, ne kemi bërë një analizë individuale të protagonistëve më të rëndësishëm në dramën e hershme të MLF, por gjithmonë duke iu referuar sjelljes së tyre ndaj vetëvetes dhe ndaj të tjerëve. Nga kjo analizë, ne mund të shohim se tek MLF me të vërtetë ka veprim reciprok të subjektivitetit dhe intersubjektivitetit.

Mënyra se si funksionon kjo marrëdhënie midis identitetit/vetë-organizimit të një grupi nga njëra anë dhe sjelljes / sjelljen ndaj dikujt tjetër, nga ana tjetër, është mjaft e afërt me teorinë kritike të filozofisë dhe psikologjisë moderne, veçanërisht atë të Martin Buber-it, Erih From-it, Teodor Adorno-s, Maks Horkhajmer-it dhe Jyrgen Habermas-it.

Si këta mendimtarë, edhe MLF - por shumë më herët dhe më konkretisht - tregon se në një shoqëri ku nuk ka individë të matur, autonom, të vetëdijshëm dhe vetëpërcaktuar, individë të lirë, nuk mund të krijohet subjektivitet i vërtetë. Por aty ku nuk ka subjektivitet të vërtetë, intersubjektiviteti mund të ketë vetëm formë të deformuar

## **Bibliografia:**

**Fleisser**, Marieluise, 1972,: Gesammelte Werke. Bd. 1 – Bd. 3. Frankfurt am Main. Hg. von Rühle, Günther.

**Fleisser**, Marieluise, 1989,: Gesammelte Werke. Bd. 4. Frankfurt am Main. Hg. Von Rühle, Günther, 1989, in Zusammenarbeit mit Pfister, Eva.

**Sauer**, Jupp, 1991,:Etwas zwischen Männern und Frauen – Die Sehnsucht der Marieluise Fleisser, Köln

**Adorno**, Theodor und Horkheimer, Max 1991: Dialektik der Aufklärung. Frankfurt a.M.

## **Udhërrëfimet dhe udhëpërshkrimet gjermane e austriake mbi shqiptarët 1910 – 1930 Një tentativë mbi sqarimin dhe interpretimin e teksteve udhëpërshkruese mbi shqiptarët në fillim të shek.20.**

**Hamsi Behluli**

Universiteti i Evropës Juglindore

Tetovë, Maqedoni

[h.behluli@seeu.edu.mk](mailto:h.behluli@seeu.edu.mk)

Kur flitet për udhëtimet gjegjësisht udhëpërshkrimet (*Brenner, J. Peter: Die Erfahrung der Fremde. Frankfurt am Main 1989. S. 14-49*) dhe përshtypjet e autorëve të huaj në viset shqiptare nëpër kohë të ndryshme, menjëherë na kujtohen dy figura që kanë zënë vend të rëndësishëm në letërsinë shqipe. Ndër lexuesit shqiptarë veçanërisht shquhen vizitat dhe udhëtimet e Xhorxh Gordon Bajronit dhe zonjës Edit Durham.

Në Bibliotekën Shtetërore dhe Universitare të Hamburgut, gjatë reshersimit tim në temën e magistraturës, arrita të vërej literaturën gjermane që i dedikohej jetës, kulturës dhe karakteristikave të ndryshme mbi shqiptarët dhe vendin e tyre. Kontributi dhe angazhimi i drejtpërdrejtë i udhërrëfyesve dhe udhëpërshkruesve gjermanë dhe austriakë për shqiptarët, veçanërisht në dekadat e para të shekullit njëzet, në viset shqiptare në Ballkan, pa dyshim mund të radhitet në anën më progresive për sa i përket trajtimit, eksplorimit dhe qasjes mbi çështjen shqiptare. (*Wallisch, Friedrich, Der Adler des Skenderbegs. Albanische Briefe aus dem Frühjahr 1914. Wien 1914*)

Ky angazhim dhe përkushtim i tyre është një kontribut me vlerë të veçantë në favor të Shqipërisë dhe shqiptarëve kur merret parasysh gjendja e rëndë politike, sociale, kulturore dhe ekonomike e shqiptarëve në atë kohë. Një studim i këtyre publikimeve, veprave, titujve, në njëërën anë, kontributi dhe angazhimi i drejtpërdrejtë i tyre gjatë asaj kohe, në anën tjetër, si dhe influenca që patën, meritojnë të kenë një trajtim më të thellë shkencor kur dihet roli i tyre në zhvillimin e proceseve të rëndësishme ballkanike të kohës në të gjitha fushat.

Ky studim përbën një kompleks tematik sipas rrafshëve apo fushave me të cilat edhe janë marrë autorët në veprat dhe publikimet e tyre gjatë udhëtimeve nëpër viset shqiptare. Materialet e trajtimit në këtë fushë shkencore-letrare janë rrëfime dhe përshkrime udhëtimesh të ndryshme luftarake, ditarë, reportazhe letrare, memoare dhe letra të kohës në fjalë. Kjo temë ngërthen në vete shumë ngjarje historike, politike dhe kulturore. Përparësia e kësaj tematike është që nga veprat e autorëve të nxjerrë në dritë një imazh për shqiptarët.

Interpretimi i zhvillimit historik është një trajtim personal i autorit dhe nuk ka peshën e trajtimit të fushës studimore të historisë, për faktin se autorët kanë marrë faktet historike vetëm për të ndriçuar faktet e tjera kulturore, zakonore dhe arsimore mbi shqiptarët dhe se e njëjta u ka shërbyer atyre si një udhërrëfyes në qëllimet e veta. Edhe gazetaria e kohës i ka dhënë hapësirë të gjerë ndryshimeve ballkanike dhe ndryshimeve në Shqipëri, veçanërisht kohës së emërimit dhe qëndrimit të Princit Wied në Shqipëri, në fillim të dekadës së dytë të shekullit njëzet. Në këtë tematikë trajtohen vetëm veprat dhe titujt e kategorive e llojeve letrare të sipërpërmendura, si dhe

një qasje kërkimore të përkushtuar kanë veprat e autorëve, të cilët drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt e kanë përcjellë Princ Wied-in nëpër Shqipëri. Të gjitha tekstet që përbëjnë bazën studimore përbajnë në vete elemente letrare dhe situata e momente të ndryshme. (Wallisch, Friedrich, *Der Adler des Skenderbegs. Albanische Briefe aus dem Frühjahr 1914. Wien 1914*)

Ato i interpretojnë situatat edhe në formë letrare. Teksti, i cili në vete përmban kryesisht një trajtim letrar është proza apo reportazhi letrar “Udhëtimi nëpër Shqipëri” i autorit Karl Otten. (Otten, Karl: *Die Reise durch Albanien 1912. München (1913)*). Edhe pse në këtë vepër udhëtimi i Karl Otten-it është vetëm një rrugëtim rasti prej Veriut deri në Shqipërinë Qendrore për të kaluar më pas në Greqi, aty në çdo paragraf hasen elemente letrare për nga përmbajtja e udhërrëfimit. (Brenner, J. Peter.: S. 14-19)

Pra, është vepra e vetme në literaturën e e udhëpërshkrimeve mbi shqiptarët që në vete përmban kryekëput interpretim letrar, stilistik dhe figurativ gjatë udhëpërshkrimit dhe udhërrëfimit. Edhe pse shumica e titujve kanë një karakter subjektiv dhe nuk përbajnë të dhëna të detajuara lidhur me ndodhitë e kohës, ato prapëseprapë pjesërisht në shkrimet e tyre përshkruanë sipërfaqësisht grupe njerëzish, individë dhe objekte të tjera. Përshtypjet e tyre individuale autorët i kanë grumbulluar në shkrimet e veta në bazë të kontakteve me popuj dhe individë nëpër krahinat që i kanë vizituar nëpër viset shqiptare dhe ballkanike. Në tekstet e tyre një hapësirë të gjerë të përshkrimit dhe hulumtimit të popujve ballkanik i kushtohen shtresave më të ulëta të shoqërisë, njeriut të thjeshtë ballkanik, andaj edhe tentimi i përfytyrimit nga literatura e kujtimeve të kohëve të caktuara mbi popuj të caktuar paraqitet, për shumë shkaqe, si problematike.

Gjatë shkrimit të kujtimeve të përjetuara ata e humbin drejtpërdrejt efektin e interpretimit. Kujtime të tilla janë botuar më vonë nga koha e udhëtimeve dhe gjatë botimeve ata tematikisht kanë pësuar ndryshime, janë thjeshtëzuar, përgjithësuar ose janë plotësuar më tej. Disa nga tekstet janë publikuar menjëherë pas grumbullimit të kujtimeve, para se të mbarojnë ndodhitë, si në rastin e luftërave ballkanike. Disa publikime përbëhen nga kujtime që nuk janë botuar nga vetë autorët, por nga botuesit. Kjo dukuri mund të ketë ndikim edhe në ekuilibrin, drejtimin dhe karakterin e interpretimit të ngjarjeve të caktuara. Publikimet dhe botimet gjermane dhe austriake mbi Ballkanin dhe shqiptarët, nëse e marrim parasysh situatën e kohës së ngjarjeve të përshkruara në recensionet e ndryshme, hasen edhe kritika mbi formën e përshkrimit dhe të përfytyrimit të objekteve dhe të situatave të caktuara ballkanike. Një përshkrim, që haset shpesh në kritikë, është definimi i kufirit ballkanik, gjë që në asnjë aspekt nuk mund të merret si vërtetim shkencor. Pra, janë të rrallë autorët që posedojnë parainformata lidhur me Ballkanin në përgjithësi dhe me popujt ballkanik në veçanti. (*krahaso autoret Friedrich Wallisch, Karl Otten, Buschan, Georg*).

Një kompleks tjetër i natyrës së trajtimit të shqiptarëve është përvoja individuale e autorëve në situata të caktuara gjatë kontakteve të tyre me popullatën shqiptare. Edhe kufizimi kohor i kësaj teme ka për bazë ngjarjet e rëndësishme, tensionet luftarake dhe ndryshimet politike, sociale e kulturore në Ballkan në dekadën e dytë të shekullit njëzet. Përpos elementeve të trajtimit të drejtpërdrejtë të objekteve, bëjnë pjesë edhe vlerësimet, vet interpretimet dhe ballafaqimi me shqiptarët, por edhe me popujt e tjerë të Ballkanit. Këto janë pjesë të ndryshme dhe të veçanta tekstuale në përshkrimin dhe interpretimin e imazhit etnik ballkanik dhe të shqiptarëve pas grumbullimit të përshtypjeve në terren. Disa publikime merren me hulumtimin dhe krahasimin e pragjykimëve ndërshtypare. Këta këndvështrime dhe aspektet e tjera të përmendura më lart shërbejnë që, nëpërmjet këtyre publikimeve, të zbardhin ekzistencën sociale,

kulturore, politike të shqiptarëve, e cila deri në këtë kohë kishte ngelur në errësirën evropiane. (krahaso Friedrich Wallisch 1914 dhe Karl Otten 1913).

Në letërsinë e mëdha botërore gjinia letrare e udhëpërshkrimeve ka një histori dhe një zhvillim të madh. Në ditët e sotme udhërrëfimet dhe udhëpërshkrimet kanë një rol të rëndësishëm historik, pasi që në dekadat dhe shekujt e kaluar ka luajtur rolin e një mediumi të rëndësishëm në zbardhjen dhe fotografimin e objekteve të trajtimit. Krahas letërsisë franceze, italiane dhe angleze, edhe në letërsinë gjermane, kjo gjini letrare përmban në vete një histori të gjerë dhe një kontribut të çmueshëm në trajtimin dhe interpretimin e përshkrimeve të objekteve, popujve, luftërave dhe ndodhive të tjera. Teksti i udhëpërshkrimit ka pasur rolin vendimtar të një mediumi për shoqëritë e zhvilluara të kohës. Ky medium, gjegjësisht udhëpërshkrim apo udhërrëfim përbën burimin e informatave mbi një objekt, territor, popull apo një ngjarje të caktuar botërore. Në kuadër të këtij lloji letrare, një vend të rëndësishëm zënë edhe shkrimet gjermane mbi çështjen shqiptare nëpër shekuj. Udhëpërshkrimet, përkatësisht udhërrëfimet mbi shqiptarët, sidomos nga autorët gjermanofolës, por edhe nga autorët francezë dhe anglezë, janë pjesë përbërëse e një historie të theksuar. Janë autorët gjermanë dhe austriakë ata të cilët e mishëruan gjuhën dhe çështjen shqiptare, duke u nisur që nga koha e Skënderbeut, e veçanërisht nga koha e Ali Pashë Tepelenës. Përshkrimi, hulumtimi, rrëfimi dhe studimet e para të hershme dhe ato të shekullit XX, janë gjithashtu një kontribut i rëndësishëm i autorëve, studiuesve dhe udhëpërshkruesve gjermanë e austriakë në afirmimin e çështjes shqiptare, para së gjithash në kontekstin e autoktonisë së tyre, si: gjuha, prejardhja dhe doket e popullit shqiptar.

## **Përfundim**

Koha e trajtimit tematik nuk është kryesisht koha e titullit të punimit, por punimi në vete përmbledh edhe tekstet e autorëve gjermanofolës para shekullit XX. Mirëpo, përqendrimi më i theksuar i udhëpërshkrimeve gjermane dhe austriake mbi shqiptarët, si dhe mbi popujt ballkanikë dhe Gadishullin Ballkanik në përgjithësi, është në fillim të dekadës së parë të shekullit të njëzetë. Është kjo koha e rënies së Perandorisë Osmane dhe e rregullimit të ri politik, social e kulturor të Ballkanit. Në këtë kohë Shqipëria gjendet në një fazë të paqartë politike. Fuqitë e mëdha të kohës, më në fund, arrijnë ta krijojnë monarkinë shqiptare. Emërimi i princit gjerman Wied si princ i monarkisë së re shqiptare në Ballkan, shkaktoi një interesim tejet të gjerë të qarqeve të ndryshme gjermane dhe austriake mbi monarkinë e re shqiptare dhe në përgjithësi mbi popullin shqiptar. Pas këtij akti, Shqipëria dhe shqiptarët përbëjnë tematikën e trajtimit kryesor politik, kulturor, social në shtetet e Evropës Qendrore dhe Perëndimore. Si rezultat i këtij zhvillimi, në publikimet gjermane dhe austriake çështja shqiptare trajtohet në të gjitha spektret dhe fushat jetësore. Elementet shqiptare deri në këtë kohë janë të panjohura për botën perëndimore. Mirëpo, për një kohë të shkurtër, elementi shqiptar dhe ardhmëria e këtij populli në Ballkan bëhet njëra nga temat më aktuale të kohës, veçanërisht në Evropën Qendrore dhe Perëndimore. Për këtë arsye, në këto publikime hasim një interpretim të genies shqiptare në shumë fusha dhe në mënyrë thelbësore, si nga sasia, ashtu edhe nga përmbajtja cilësore.

## **Bibliografia**

Brenner, J. Peter: *Die Erfahrung der Fremde. Zur Entwicklung einer Wahrnehmungsform in der Geschichte des Reiseberichts*. In: Brenner, J. Peter (Hrsg): *Der Reisebericht. Die Entwicklung einer Gattung in der deutschen Literatur*. Frankfurt am Main 1989. S. 14-49.

Buschan, Georg: *Die Balkanvoelker: in Vergangenheit und Gegenwart*. Stuttgart 1909.

Otten, Karl: *Die Reise durch Albanien 1912*. München (1913)

Wallisch, Friedrich: *Der Atem des Balkans. Vom Leben und Sterben des Balkanmenschen*. Leipzig 1928.

Wallisch, Friedrich: *Der Adler des Skenderbegs. Albanische Briefe aus dem Frühjahr 1914*. Wien 1914.

Wallisch, Friedrich: *Neuland Albanien*. Stuttgart 1931.

## **Drama “Israelitë e filistinë” e Nolit si shembull i rishikimit dhe transformimit tekstual**

**Jehona Rushidi-Rexhepi**

Universiteti i Evropës Juglindore

Tetovë, Maqedoni

[j.rushidi@seeu.edu.mk](mailto:j.rushidi@seeu.edu.mk)

### **Hyrje**

Transformimet tekstuale, sipas teorisë së intertekstualitetit, lidhen me tekstet të cilat dalin të mbështetura mbi një tekst të mëparshëm. Si të tilla, këto dukuri kombinohen shpesh me mënyra tjera të komunikimeve intertekstuale. Gjithashtu, transformimet mund të paraqiten si direkte dhe indirekte, si simetrike apo të kundërta. Duke lexuar krijimtarinë letrare të Nolit, përmes përvojës dhe kujtesës së leximit, përveç tjerash, lehtë na ngjallen asociacione të tekstit biblik, por që shpesh ndërlidhen me historinë dhe kontekstin politik. Njëherit, dallohen lehtë disa preokupime të shkrimtarit: Krishti, Skënderbeu, Revolucioni i vitit 1924, Zogu, etj. Duke qarkulluar në vepra të ndryshme të Nolit, këto modele dialogëzimi bëhen shtytje të kërkimeve për modele të transormimeve tekstuale. Një prej shembujve që e lejon këtë lloj analize është drama “Israelitë e Filistinë”.

### **Drama “Israelitë e filistinë” si shembull i transformimit tekstual**

Ajo që e nxit lexuesin të kërkojë mundësinë e transformimit tekstual, para së gjithash është titulli. Megjithatë, në pashënie të saj, Fan Noli thekson që drama në të vërtetë është një skelet drame e cila nuk është mirë e përpunuar dhe i kahëzon lexuesit ta kërkojnë fijen e Ariadnës, gjegjësisht enigmën që duhet të zgjidhet. Sadoqë, pas kohës së botimit është pritur të lexohet një rishkrim i saj, teksti ka mbetur si i tillë. Drama është edhe vepra e parë letrare e Nolit, e botuar më 1907 në Boston, edhe pse drama është shkruar pesë vite më herët.

Përshtypja e parë gjatë leximit të dramës “Israelitë e Filistinë”, është se rolin e hipotekstit e luan materia biblike. Por, nëse mbështetemi në vetë “Autobiografinë” e Nolit si në çelës të bindjeve të tij, që ka të bëjë me motivet që e preokupojnë dhe mbizotërojnë shkrimet e tij, një instancë leximi të cilës nuk mund t’i hiket është edhe dëshprimi i tij nga vetë situatat e krijuara politike. Sigurisht, këtu duhet kërkuar edhe arsyen e vënies së elementeve biblike mbi kontekstin aktual politik, duke gjetur në situatat biblike ndofarë analogjie me atë që ai do ta sintetizojë, përveç në poezinë e tij të mëvonshme, edhe në këto tre akte. Tashmë është i qartë roli aktiv i lexuesit.

Me këto veprime, është e qartë se hipoteksti biblik i kësaj drame, së bashku me vet hipertekstin, e japin të qartë idenë se e vërteta ngadhënjën me forcën. Dhuna do të jetë elementi i cili do të shtrihet edhe në disa nga poezitë e tij. Ashtu siç theksohet në shumë studime të veprës së tij, është e qartë se drama e merr subjektin nga Dhjata e Vjetër, mirëpo: “ Noli i shmanget

temës së mosdurimit racist të martesës së izraelitëve me gra të huaja dhe fokusohet në interpretimin dytësor të saj, të atij njerëzor dhe moral, të tundimit dhe ligështimit para të ligave dhe kënaqësive të kësajbotshme edhe të njerëzve të drejtë, të mirë dhe të patundshëm, siç është Samsoni, i cili bie viktimë e lajkave dhe kënaqësive nga kjo botë.” (Spahiu, 2007:168).

### **Transformimet e personazhëve dhe dilema e studiuesve**

Në hipotekstin biblik thuhet se para se të lindet Samsoni nga ana e gruas së Manoah-ut, që është e shterpë, një nga engjëjt e Zotit parasheh që kjo grua do të lindë djalë, fuqia e të cilit do të jetë në flokët e tij dhe se ai do të çlirojë Izraelin nga Filistinët. Samsoni dashurohet në Dalilën dhe kjo zbulon sekretin e fuqisë së tij.

Noli e selekton këtë pjesë të tekstit biblik për ta thurur dramën e tij, në të cilën, edhe pse Samsoni biblik kryesisht karakterizohet si mjaft i fuqishëm, këtu paraqitet sipas një filozofie të caktuar. P.sh: “... Dua t’i mësoj Filistinët të kqyrin Perëndinë brënda në Natyrë dhe Përjetësinë në Dashuri. Po këto nuk përhapen me zjarr dhe me hekur, po vetëm kur njeriu është i lire t’i marrë vesh, a po jo.” (Noli 1968:25).

Nga kjo që u ilustrua deri këtu, mund të pohohet që hiperteksti del si një lloj i transformimit të materialit të parë biblik. Edhe pse, u hetuan ndryshimet mes tekstit të parë dhe të dytë, nuk do të mundemi ta klasifikojmë as si imitim, as si transformim të kundërt, meqë dallimet nuk janë të rrënjësishme.

Është për t’u theksuar se hiperteksti brumoset edhe me nuanca filozofike. Hapësirën më të madhe në dramë e zë raporti Samson-Dalilë. Gjithashtu, vërehet lehtë se Noli nga miti biblik e merr pjesën kryesore gjegjësisht, atë të shkuarjes së Samsonit te Filistinët. Përderisa u theksua se Samsoni i Nolit dallohet nga ai i mitit biblik, për Dalilën mud të thuhet se: “... *nuk e ndryshoi karakterin e Dalilës, e la ashtu siç ishte në legjendën biblike: grua e pabesë dhe e luhatshme...*” (Bihiku, 1998:117). Në dallimet mes Samsonit biblik dhe atij që e gjejmë në dramën e Nolit, ndalet edhe studiuesi Koço Bihiku (Bihiku 1998: 117), duke parë dallime që janë të aspektit të karakterit të njërit dhe tjetrit. Karakteri i parë është i lumtur kur hakmiret, i dyti i kushtohet idealit të vet. Nga ana tjetër, studiuesi Avni Spahiu (Spahiu 2007:169) e sheh Samsonin si një hero shqiptar që është i ndarë mes një dileme filozofike.

Këtu hapet një çështje tjetër që del si mjaft e natyrshme, ajo e filozofisë së Niçes dhe ndikimit mbi Nolin. Kjo diskutohet në mjaft studime që dijnë të dalin edhe si kontradiktore. Filozofia e shkrintarit është mjaft interesante. Lidhjet e tij me religjionin janë gjërësisht të njohura nga “Autobiografia”, mirëpo njëkohësisht ai e lexon edhe Niçen. Kështu, studiuesi Hilmi Agani e mohon ndikimin nga Niçeja duke i parë të dy si krjetësisht të kundërt, përkundrejt të cilit Ali Aliu (Aliu 2005) dhe Dhimitër Shuteriqi mbajnë anën e *mbinjeriut niçean* që realizohet nëpërmjet figurës së Samsonit.

Duke pasur parasysh se më sipër u theksua që Noli shpesh identifikohet me Krishtin, Napoleonin dhe Skënderbeun, sikur më i mbështetur del përfundimi se qëndrimet e Nolit janë më shumë të lidhura me bashkëkohësinë e tij, herë-herë janë qëndrime që përkojnë më shumë me ato biblike sesa me ato niçean. Prandaj, edhe mendimi i studiuesit Ali Xhiku (Xhiku 2004:288), sipas të cilit drama më tepër duket si filozofike-politike e cila e merr subjektin nga Dhjata e

Vjetër, duke gjetur njëkohësisht edhe përkime mes dramës së Nolit dhe dialogëve të dramave shekspiriane, është një nga konstatimet më lehtë të pranueshme.

Nëse për poezitë e Nolit thuhet që ndërlidhen në Revolucionin, për veprën “Israelitë e Filistinë” nuk mund të thuhet e njëjta. Kjo, pasi drama është e mëhershme dhe kështu mund të tërhiqet vetëm fija e çështjes së daljes nga situata e krijuar në Shqipëri. Gjithashtu, këtu mund të analizohen raportet me teatrin si shtytje për të shkruar kësi lloj teksti që i dedikohet skenës, me çka subjekti biblik është i njohur për masën.

Ashtu siç tashmë kanë vënë re edhe disa studiues të kësaj vepre, gjatë transformimit të këtij materiali nga Dhjata e Vjetër në material të ri, janë mpleksur edhe disa nuanca mitologjike të cilat vërehen posaçërsht në ndërtimin e figurës së heroit, pasi kësaj figure qendrore i përshkruhen veti të mbinatyrshme (Uçi, 1982: 308). Për këtë raport dhe atë që hap drama me kontekstin politik, nuk mund të thuhet që vërehet praktikë hipertekstuale, gjegjësisht transformim tekstual.

## **Përfundim**

Në pashënien e veprës “Israelitë e Filistinë” Noli na jep informacion se drama është në fakt një skelet drame dhe se duhet të angazhohemi në zgjidhjen e fijeve të saj. Andaj, është shumë e qartë se në këtë tekst letrar funksionon një lloj marrëveshjeje mes shkruarit dhe lexuesit. Për të mos qenë skajshmërisht i guximshëm, punimi u mbështet në konstatime të cilat lidheshin me emra të njohur të kritikës letrare, veçanërisht me ato studime që ndalen në këtë vepër. Kështu, derisa u vështrua materiali i transformuar dhe krahasimi mes ndryshimeve në të dyja planet, u pa që lirisht mund të flitet për një praktikë hipertekstuale, që rezultonte në transformim direkt, pa u ngritur në shkallë imitimi por edhe pa qenë purist. Megjithatë, për transformim direkt, hipertekst, vlen vetëm raporti mes dramës së Nolit me materialin biblik. Format dhe modelet tjera të komunikimeve që shpalos teksti i Nolit, janë modele të praktikave që hyjnë në kategoritë intertekstuale por që kërkojnë mbulesë me tipologji dhe klasifikime tjera. Meqë tema e punimit kufizohet në transformim tekstual, duket si e arsyeshme që trajtimi i raporteve tjera të ketë hapësirë të duhur të trajtimit në një analizë të veçantë.

## Referencat

- Bihiku, K., 1998, *Miti i Samsonit në dramën Israelitë e Filistinë te Fan S. Noli* në Studime filologjike 1-2, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Tiranë.
- Noli, Fan S., 1963, *Autobiografia*, Rilindja, Prishtinë.
- Noli, Fan S., 1963, *Sulm e lot*, Rilindja, Prishtinë.
- Noli, Fan. S., 1968, *Israelitë dhe Filistinë*, Rilindja, Prishtinë.
- Raifi, M., 1979, *Fan Noli dhe Migjeni*, Rilindja, Prishtinë.
- Rushidi-Rexhepi, J., 2008, *Interkulturaliteti në krijimtarinë letrare të Fan S. Nolit, A. Z. Çajupit dhe Etëhem Haxhiademit*, Tezë magjistrature, Fakulteti Blazhe Koneski, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi , Shkup.
- Spahiu, A., 2007, *Noli-Jeta në Amerikë*, Botimet Toena, Tiranë.
- Uçi, A., 1982, *Mitologjia Folklori Letërsia*, Naim Frashëri, Tiranë.
- Xhiku, A., 2004, *Letërsia shqipe si polifoni*, Dituria, Tiranë.
- Кулавова, К., 2003, *Теорија на интертекстуалноста*, Култура, Шкуп.

## Roli i numrave në strukturën hermetike të romanit “Gomari i artë”

### i shkrimtarit antik Apuleus

**Lindita Ahmeti**

Universitetit “Kiril i Metodij”,

Shkup, Maqedoni

[lindita73@hotmail.com](mailto:lindita73@hotmail.com)

Me titullin “Gomari i artë” njihet romani i shkrimtarit antik Apuleus, i shkruar në gjuhën latine, një vepër me vlera të veçanta letrare, që e tërheq edhe vëmendjen e lexuesit të ditëve tona. Para se të orvatemi ta trajtojmë temën e paraqitur në këtë konferencë, mendoj se duhet të themi disa fjalë për përmbajtjen e romanit me qëllim që të qartësohet pesha e kësaj trajtëse modeste. Romani “Gomari i artë”, do të kisha thënë, paraqet një varg ngjarjesh e përjetimesh nëpër të cilat kalon kryepersonazhi Lukiusi. Ky, duke mos u varur vesh paralajmërimeve e vërejtjeve që mos të jepet pas pamjes së jashtme, ndjenjës trupore dhe të kësobotshme, do të ndëshkohet rëndë. Fati do ta transformojë në gomar. Dhe, Lukiusi do të duhet të kalojë nëpër përvoja të çuditshme, të hidhura, që të kthehet në pamjen njerëzore. Kthimi “në rrugë të perëndisë”, përpjekjet për të dalë nga situata e rëndë, nuk janë të lehta. Në të vërtetë ky roman, pra udhëtimi i Lukiusit nga një tregim i çuditshëm në tjetrin, është një parabolë përmes së cilës autori me një urti e bukuri e jep mesazhin për korrektësinë e besimit të Izida, një perëndeshë e rëndësishme egjiptiane, e cila në kohën e autorit, shekulli i dytë i erës së re, ka filluar të depërtojë me të madhe në hapësirat e gjera të Perandorisë romake. Dhe, mesazhi është ky: Izida është e vërteta absolute, Izida është shpëtimi. Si duket depërtimi i saj paraqet një hyrje dhe parapërgatitje për përhapjen e pastajme të krishterimit në perandorinë e madhe romake.

Veptra “Gomari i artë” është një kombinim i paparë i rrefimit të lehtë e të bukur, i gërshetimit mjeshtror të rrefimeve të ndryshme, i aventurave të një njeriu të ri, i pikëpamjeve religjioze të autorit. Ka këtu edhe një kritikë të lehtë ndaj politeizmit grek e romak.

Romani në fjalë, në shikim të parë, është i kuptueshëm lehtë. Mirëpo lexuesi i kujdesshëm do të vërejë se kemi të bëjmë me një vepër me një shkallë të dukshme hermetike, ku me rol janë parabola, emrat, numrat etj. Do të orvatemi të themi ndonjë fjalë për rëndësinë e numrave në strukturën hermetike të këtij romani, i cili konsiderohet si një gur i rëndësishëm i letërsisë evropiane dhe i cili ka ushtruar ndikim të shumë emra të mëdhenj të letërsisë botërore.

Në “Gomarin e artë”, përveç tregimeve që lidhen me fatet e Lukiusit, rol mjaft të rëndësishëm për strukturën kanë edhe emrat e personazheve, por edhe numrat. Shpresoj se do t’ia dal ta zgjoj kërkshërinë tuaj me temën e propozuar. Le ta fillojmë me numrin e librave të kësaj vepre e të vazhdojmë, pastaj, me fshehtësitë tjera të numrave që kanë të bëjnë me romanin e Apuleusit. .

Romani ka njëmbëdhjetë libra (kapituj)! Pse? pyetet Sandra Mangoubi (2001)

Shumë komentatorë e shprehin çudinë e tyre me këtë numër, për shkak se njëmbëdhjeta, siç pohohet, nuk është ndonjë numër i rëndësishëm në traditën antike. Ajo nuk ka ndonjë simbolikë në letërsinë antike, vë në dukje Sandra Mangoubi (2001). Njëmbëdhjeta është shpjeguar vetëm

me dy-tre rreshta në “Fjalorin e vogël të simboleve tradicionale” (Mali rečnik tradicionalnih simbola) të Mario Lampičit (2000). Këtë numër nuk e gjejmë edhe në shkrimet e shumta për Pitagorën dhe kështu me të parën krijohet përshlytja se Apuleusi rastësisht e ka hartuar romanin me njëmbëdhjetë libra.

Nga ana tjetër ka njohës të kësaj vepre që mendojnë se pikërisht në librin e njëmbëdhjetë shpjegohet mistikja. Pra kemi dhjetë libra në të cilat, thekson Sandra Mangubi (2001) pasqyrohet bota trupore, bota ndiesore, përkatësisht tregohen imazhe dhe ngjarje që lidhen me Eros Pandemosin (“Erwj Pëndemoj”), kurse përballë tyre qëndron libri i njëmbëdhjetë i cili e shpjegon shpirtëroren, hyjnore përkatësisht Eros Uranosin (“Erwj OÛranËj”). Eros Pandemosi përballë Eros Uranosit!

Dhjetë librat e parë janë alegori nëpër të cilën Apuleusi dëshiron ta paraqesë të rrejshmen, të errëtën, me të cilën, sipas tij, është plot e përplot politeizmi. Në to autori jep një varg situatash tragjikomike, por ka edhe mjaft ironi, do të thotë Sandra Mangubi (2001) që shërbejnë të forcohet ajo e cila do të thuhet në librin e njëmbëdhjetë si një lloj përfundimi. Përveç kësaj në librin e njëmbëdhjetë fillon të duket tashmë shpirtërorja e cila po përgatitet të paraqitet, madje edhe të gufojë e të derdhet.

Por mbetet pyetja pa përgjigje që e shtrojnë shumë studiues të veprës së Apuleusit, ndër to edhe Steven Heleri (1983) i cili përmendet nga ana e Sandra Mangubit (2001): “Pse s’janë dhjetë libra”? Pse Apuleusi nuk e ka përmbyllur rrëfimin në librin e dhjetë, aq më shumë kur dihet se dhjeta është shumë e katër numrave themelorë ( $1+2+3+4=10$ ) dhe si e tillë dhjeta konsiderohet si numër i përkryer thekson Mario Lampiqi (2000). Këta katër numra dhe kombinimet e vargut nga një deri më katër, i përmbajnë në vete të gjitha domethëniet mistike: 1 do të ishte Izida, përkatësisht Zoti, 2 – kundërshtitë: tokë-qiell, përkatësisht njeriu-qiellorja; terri dhe drita; materialja dhe shpirtërorja; mashkullorja dhe femërorja. Numri tre është shumë e dy numrave të parë. Dhe numër i fatit. Sandra Mangubi (2000) thotë se e paraqet edhe shpirtin, kurse në disa tradita trajtohet edhe si numër i aventurës. Kjo nuk është e tëra (në librin e tretë ndodh transformimi i Lukiusit në gomar, por në numër çift – kaptina 24). Lukiusi duhet të shpëtojë te treshja, përkatësisht në ciklin e tretë, i cili në këtë rast është në librin e njëmbëdhjetë. Nëse shkojmë sipas asaj që e thamë paraprakisht në treshen fillon aventura e shpirtit të Lukiusit). Katra, thekson Sandra Mangoubi (2001) është si numër përmbyllës dhe është numër i shenjtë i Hermesit (Lampic, 2000). Kjo do të thotë se sjell rreziqe që mund të shpijnë drejt errësirës. (Për këtë arsye ata që besojnë në mistikë gjatë kohë i janë larguar këtij numri, si dhe të gjithë numrave të tjerë çift. Kështu për shembull – në kalendarin romak muajt kanë pasur 29 ose 31 ditë). Ndërsa pesa është numër i Afërditës/Venerës, numër i bashkimit, numër i dasmës, pra një cikël i ri, një fillim i ri. (Në këtë vepër, jo pa qëllim, është përfshirë edhe miti i bukur për Amarin (Erosin) e Psikën, i cili, mendoj unë, nuk lidhet aq shumë me përjetimet e kryepersonazhit, por ka funksion të rëndësishëm në “arkitekturën numerike”, si nevojë për realizimin e idesë religjioze dhe për hermetizmin e romanit dhe kjo është njëra ndër arsyet pse Lukiusi e përfshin këtë mit brenda librit). Në librin e pestë Psika do të takohet me Kupidonin “e padukshëm”. Këtu ata të dy fillojnë ta ndajnë shtratin.

Kjo është forca e numrave tek. Atëherë shtrohet pyetja: si do ta kishte përfunduar veprën Apuleusi me një numër çift, kur dihet se ai sjell rreziqe? Si do të nxirrej Lukiusi e si do të

shpëtonte në numrin çift? Si do të kishte mundur Izida t'ia shtrinte dorën Lukiusit fatkeq në një situatë të tillë, në rrethanat e numrit çift, Izida e cila identifikohet me numrin 1?

Dhjeta është numër çift. Përveç kësaj dhjeta paraqet shumë e dy cikleve: 1-5 dhe 6-10. Numri 2 (dy cikle) është numër çift. Pastaj numri 2 nuk është numër i aventurës. Treshja është Pitagora, sipas shpjegimit të Xhek Tresiderit (2001), treshen e konsideronte si numër të harmonisë. Pra autori ka dashur që fundi i librit të rumbullakohet me ciklin e tretë, i cili fillon me njëmbëdhjetën. Kështu kemi tri cikle dhe – në librin e njëmbëdhjetë rumbullakohet udha jetësore e Lukiusit, i cili kalon nëpër aventura, transformim që të arrijë te drita e Izidës.

Sandra Mangubi (2001) thekson se në literaturë mund të gjenden edhe përgjigje të tjera dhe me këtë rast e parafrazon Stiven Helerin (1983), i cili thotë se pas pitagorejasve, platonistët e kanë konsideruar numrin dhjetë si gardh, si rrethojë. Sipas tyre, njëmbëdhjeta ka pasur rol të serisë së re, e jo pesa e parë. Këta fillimin e serisë së re e kanë konsideruar si rilindje ose lindje të ndonjë gjëje krejtësisht të re. Në të dy rastet, pra edhe te pitagorejasit edhe te platonistët, njëmbëdhjeta paraqet një faqe të re. Kjo, thonë, është fshehtësia e numrit njëmbëdhjetë, përkatësisht e njëmbëdhjetë librave të romanit.

Pitagorejasit e kanë barazuar numrin dhjetë me botën, për shkak se ai i përmban elementet e të gjitha numrave të tjerë, njësoj siç i përmban bota të gjitha gjërat brenda vetes. Sipas Stiven Helerit (1983), te i cili thirret Sandra Mangubi (2001), struktura e “Gomarit të artë” është dhjetë plus një (10+1). Nga njëra anë është bota, kurse nga ana tjetër Zoti. Edhe te pitagorejasit numri një e simbolizon Zotin, i cili është unitet par excellence.

Pika interesante e kësaj teorie, thotë Sandra Mangubi (2001) është se ajo mbështetet në shumë argumente të nxjerra nga vetë vepra: ka tri raste të të përmbajturit (agjërime) nga dhjetë ditë, ndërsa përkushtimi, më mirë të thuhet shugurimi vendoset në ditën e njëmbëdhjetë. Le ta përmendim se jo rastësisht në rruzaret e myslimanëve ka 33 kokrra: tri herë nga 11. Nuk është i rastit edhe këtu numri njëmbëdhjetë, që do të ketë qenë i rëndësishëm në Lindjen e afërt që në kohë të lashta. Kemi edhe një ndërthurje të numrit njëmbëdhjetë në roman. Kështu, paraqitja e Izidës në librin e njëmbëdhjetë sjell njëmbëdhjetë emra të saj (XI, V) (Sandra Mangubi, 2001). Këta emra renditen në dhjetë plus një, kurse i njëmbëdhjeti është emri i vërtetë, përkatësisht Izida, Zoti. Në librin e njëmbëdhjetë ajo tashmë i ka atributet e hyjnive të tjera, të cilat përmenden në roman: Hyjnesha e Pesinuntit (Pecinuntia deum Mater – Nëna e perëndive te frigjiasit), Atena Kerkopejase (Cercopeia Minerva), Afërdita e Pafosit (Cyprias Paphia Venera), Diana Diktinase (Dictynna Diana), Prozerpina Stigiase (Stygia Prozerpina), Demetra Aktejase (Dea Cerera), Junona (Iuno), Belona (Bellona), Hekata (Hecata), Ramnusia (Rhamnusia) dhe në fund Izida (Isis). Në këtë libër, si libër i rilindjes, në hyrje të shkëlqimit të shpirtërores paraqitet sinkretizmi e mund të thuhet duket larg në horizont se si politeizmi me pikëpamjet e tij ndaj botës tërhiqet nga skena e historisë në llogari të sinkretizmit dhe monoteizmit.

Numrat i ke gjithandej në roman. Dhe, çdo gjë është e shifruar. T'i kthehemi librit të tretë kur Lukiusi transformohet në gomar. Ja se si i numëron vetë Lukiusi transformimet që i kanë ndodhur: 1. Qimet e mia u trashën, 2. Lëkura ime u vrazhdësua, 3. Gishtat e këmbëve dhe të duarve u bënë thundra, 4. Më doli një bisht i gjatë, 5. Fytyra m'u shfytyrua, 6. Goja m'u zgjat, 7. Birat e hundës m'u zgjeruan, 8. Buzët m'u lëvarën, 9. Veshët m'u rritën jashtë mase, 10. Organi për kënaqësi m'u rrit dhe, në fund – 11. Tashmë nuk mundja ta përqafoj Fotidën time, (përkatësisht tashmë nuk është njeri – vërejtja ime). Gjithsej janë 11 ndryshime trupore. Një numër i njëjtë ndryshimesh ndodhin edhe kur Lukius Gomarit transformohet në njeri (XI, 13). Në

këto raste është vështirë të komentohet njëmbëdhjeta. Supozojmë se në rastin e parë bëhet fjalë për një ndëshkim nga Izida, kurse në rastin tjetër shpëtimi i Lukiusit vjen përsëri nga Izida.

Në librin XI, përveç emrave të Izidës ka një renditje simbolike kur fillojnë të parakalojnë grupet e para në procesionin solemn. Kështu në XI, 8 Sandra Mangubi (2001) e vëren se përmenden njëmbëdhjetë pjesëmarrës: ushtari, gjahtari, gruaja, gladiatori, një person nga pushteti, filozofi, gjahtari i shpendëve, peshkatari, një arushë e zbukuruar si një zonjë e bukur, një majmun si Ganimesi, një gomar dhe një plak si Pegazi e Belerofonti. Duket qartë se bëhet fjalë për një ironi ose përqeshje drejtuar politeizmit.

Pasi kalon procesioni në fjalë në po atë libër paraqitet një procesion tjetër, i përbërë, po ashtu nga njëmbëdhjetë veta, por nuk bëhet fjalë tashmë për një ironi. Personazhi i fundit i përmendur është kleriku i cili e mban kurorën me trëndafila. Ai është i njëmbëdhjeti nga vargu i cili është shënuar me numër nga Apuleusi që ta tërheqë vëmendjen e lexuesit për rëndësinë që e ka numri njëmbëdhjetë. Ky klerik, i njëmbëdhjeti me radhë, e mban barin për shpëtimin e Lukiusit – trëndafilat aq shumë e aq gjatë të pritur.

Libri, kjo duhet të theksohet edhe një herë është i përbërë nga tri cikle: 1-5, 6-10 dhe 11. Duhet të shtohet edhe kjo: Lukiusi agjëron tri herë nga dhjetë ditë, plus dita e iniciacionit. Lukiusi përmes agjëritit duhet të pastrohet nga mëkatet e treshes, nga aventurat e shkaktuara nga kureshtja. Lukiusi në XI, I thotë se menjëherë është zgjuar dhe e ka larguar përgjumjen, është ngritur me gëzim dhe – duke dashur që menjëherë t'i lajë mëkatet e ka zhytur kokën në ujë shtatë herë (për shkak se filozofi i famshëm Pitagora e ka konsideruar këtë numër për të përshtatshëm në mënyrë të veçantë gjatë kryerjes së ritualeve fetare). Kështu në XI, 25, Lukiusi i drejtohet Izidës me shtatë lutje.

Në librin XI Lukiusi është tepër i rreptë, i tëri është dhënë pas Izidës së madhe, përplot është i mbushur me ngazëllim. Në terr paraqitet si diell rreptësia e Izidës. Me paraqitjen e saj mbarojnë aventurat dhe lojërat që janë karakteristike për të vdekshmit e zakonshëm, mbaron argëtimi dhe mbaron një epokë. Mbaron liria sipas masave të traditës së grekëve të lashtë e të romakëve.

## Bibliografija

Apuleii Madaurensis METAMORPHOSEON LIBRI xi; Cambridge, Massachusets, Harvard University Press; London, William Neimann, LTD/MCLVIII;

Апулеј, Лукиј, „*Златното магаре*“; превод од латински на јазик, предговор и белешки Весна Димовска – Јањатова, Култура, Скопје, 2003;

Bahtin, Mihail, *O romanu*; Nolit, Beograd, 1989;

Biderman, Hans: *Rečnik simbola*, PLATW, Beograd, 2004

Budimir, Milan - Flašar, Miron, *Pregled rimske književnosti*, Naučna knjiga, Beograd, 1991, četvrto izdanje;

Dhama, Todi, *Fjalor i Mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988;

Фрејзер, Џ. Џејмс, *Златна грана*, Алфа & Драганић, Семун, Београд, 1992;

Ђурић, Милош, *Историја хеленске књижевности*, друго прегледано и допуњено издање, Завод за учебнике и наставна средства Србије, Београд, 1971;

Harrison, S. J. – *Literary Topography in Apuleius Metamorphoses*; <http://users.ox.ac.uk/~sjh/documents/littopFIN.doc>;

Divković, Mirko, *Latinsko – hrvatski rječnik*; Naprijed, Zagreb, Zagreb, 1991, sedo izdanje, reprint;

Јован, Слободан А. – *Речник књижевних израза*, БИГЗ, Београд 1972;

Lampić, Mario, *Mali rečnik tradicionalnih simbola*, Libreto, Beograd, 2000;

Mangoubi, Sandra, *La structure litteraire des Metamorphosese d'Apulee. Etudes des jeux de miroirs*, FEC - *Folia Electronica Classica* (Louvain-la-Neuve) - Numéro 2 - juillet-décembre 2001 <[folia\\_electronica@fltr.ucl.ac.be](mailto:folia_electronica@fltr.ucl.ac.be)>

Senc, Stjepan, *Grčko-hrvatski rječnik*, Naprijed, Zagreb, reprint 1991, treće izdanje;

Шевалије, Жан-Гербран, Ален, *Речник на симболите*, Табернакул, Скопје, 2005;

Тресидер, Џек, *Речник на симболи*, Три, Скопје, 2001.

## Intertekstualiteti në dramat e Çajupit dhe të hetuarit e tij në raport me tipin e lexuesit

**Jehona Rushidi-Rexhepi**

Universiteti i Evropës Juglindore

Tetovë, Maqedoni

[j.rushidi@seeu.edu.mk](mailto:j.rushidi@seeu.edu.mk)

Hyrje

Tashmë është e qartë që tekstet letrare karakterizohen me shumëvalencën e tyre. Një përgjithësim i teorisë (teorive) së intertekstualitetit, tekstin do ta kishte shtruar si shumësi kuptimesh, si sipërfaqe kryqëzimesh, si tekst që thurret gjithmonë nga tekste tjera, si dhe idenë se çdo tekst është në një farë mënyre intertekst. Këto përfundime i sjellin: M. Bahtini, J. Kristeva, Zh. Zheneti, J.M. Lotman, etj. Këtyre përfundimeve u vishet edhe një çështje tjetër që kërkon përgjigje dhe ilustrim: çështja e lexuesit. D.m.th., teoria e intertekstualitetit tekstin e jep si material të shumështruar, polifonik, por zbërthimin e tij e sheh si të varur nga përciptimi i lexuesit. Rëndësia e lexuesit tashmë është e qartë. Prej kohës së postmodernizmit e këndeje, autori është i vetëdijshëm për rolin që ia jep atij. Megjithatë, ky studim synon të paraqesë dhe të analizojë edhe një çështje më shumë: Çfarë ndodh me rolin e lexuesit në krijimtaritë letrare që i paraprijnë postmodernies? Duke dashur që rezultatet të pasojnë shembujt aplikativë, krijimtaria dramaturgjike e Çajupit shihet, si një hapësirë e përshtatshme tekstuale për identifikimin e sinjaleve intertekstuale.

### Roli i lexuesit në krijimtarinë dramaturgjike të ajupit

Nëse kemi për qëllim rileximin e teksteve dramatike të Çajupit, duke i vështruar si rrjete marrëdhëniesh, atëherë nënkuptohet edhe nevoja e shpalosjes së rëndësisë së lexuesit. Kjo e fundit shpie në një konstatim që këtu duket i arsyeshëm. Konkretisht, kur Zherar Zheneti (Кулакова 2003:64) kërkon llojet e transtekstualitetit deklaron: "Vështirësia e hulumtimit është se sa më shumë kërkojmë, gjejmë vetëm atë që nuk jemi duke e kërkuar". Dramat e Çajupit përciptohen edhe si përbërëse të rëndësishme të pasqyrës së zhvillimit të dramës shqiptare të fillimit të shekullit XX. Materiali tekstual konkret, në të cilin do të mbështetemi, nënkupton veprat: "Katërbëdhjetë vjec dhëndërr", "Burr i dheut" dhe "Pas vdekjes".

Kur jemi te shpalosjet që i bën rileximi e që i përmendëm më sipër, të theksojmë se këtu nënkuptohen shqyrtimet e disa aspekteve të leximit, gjegjësisht lexuesve. Për të qenë më të qartë, lexuesin duhet parë në një farë mënyre edhe si shkruar. Më pas, e rëndësishme është të mirret parasysh se ai nuk mund të përmblidhet në një kategori të njëjtë dhe pikërisht ky dallim mes tipave të ndryshëm të lexuesve hap dilemën nëse në vetë procesin e të lexuarit mund të ketë sukses vetëm njëri prej llojeve të lexuesve. Këta dy tipa lexuesish do të kishte mundur thjesht të klasifikohen në lexues të përgatitur (të lexuar, të informuar) dhe në lexues të papërgatitur. Kësaj, t'i shtojmë se sipas teoricienit të njohur gjerman Ulrich Brojh (Кулакова 2003:141), nëse intertekstualitetin e kuptojmë në kuptimin e ngushtë të fjalës, ai është i pranishëm kur mes shkruarit dhe lexuesit ka një marrëveshje (të dy partnerëve) në vetë procesin e komunikimit.

Përshtypja nismëtare është që kërkesa për zbrërthimin e teksteve shpeshherë lidhet edhe me llojin e parë të lexuesit por edhe me të dytin. Kështu, i natyrshëm del konstatimi që tipi i parë do të mund t'i hetojë shenjat implicite dhe ky i dyti vetëm ato eksplicite. Atëherë, le të përpiqemi të përgjigjemi në pyetjen: Cilët janë shembujt që i ofrohen njërit dhe tjetrit?

### *Sinjalet intertekstuale në dramën “Burri i dheut”*

Tragjedia “Burri i dheut” e lehtëson analizën e raporteve intertekstuale, sidomos me anë të parathënies, që sipas Zhenetit luan rolin e paratekstut. Aty, lexuesi informohet për marrje nga Pier Korneji dhe automatikisht jepet një model fillestar i tragjedisë së klasicizmit që është i përpunuar në tekstin e ri letrar.

Në këtë dramë rimerret një temë historike, për të cilën autori pohon hapur se faktet historike janë shtrembëruar, me çka shënimi paratekstual i shkrimtarit mund të kategorizohet edhe si shkrim metatekstual. Aty theksohet që përmbajtja është e lidhur me disa ngjarje më të ngushta, Çajupi (1983:89) është i vetëdijshëm se sipas Aristotelit në tragjedi jepen ngjarje që duhet të kenë ndodhur, por pranon që ka bërë ndryshime të fakteve historike. Ai shton më tej, se djalin e Sulltan Muratit, i cili quhet Muhamet, do ta quajë Selim, ndërsa Muhamet e quan vëllain e Sulltan Muratit, sepse ky zëvendësim i dukej i domosdoshëm për thurjen e tragjedisë.

Thelbi i tragjedisë është problemi i identifikimit të drejtë të Skënderbeut. Ndryshimet që Çajupi i bën në drejtim të fakteve të shkuara historike, janë një transformim i materialit historik të bartur në tekst letrar, me çka faktet historike janë ndërthurur me fiksionin. Në krahasimin e dramës së Çajupit dhe dramën e klasicizmit, është interesante që te Çajupi ndryshojnë faktet e përmendura lidhur me rregullat e tragjedive të klasicizmit, sipas të cilave kërkoheshin ngjarje të vërteta. Shkrimtari u përmbahet tri njësisë të klasicizmit: të veprimt, të kohës dhe të vendit, të formuluar nga Aristoteli, megjithatë në klasicizëm respektimi i tyre kërkohet në mënyrë rigoroze.

Ajo që në rastin konkret nuk do ta dallonte lexuesi i painformuar, me çka sinjali intertekstual do të mbetej i pazbërthyer, është dallimi mes Skenderbeut historik dhe atij të dramës së Çajupit. Një nga studiuësit e njohur të veprës së tij, Mahmud Hysa (Çajupi 1983), ofron një dallim interesant të Sulltanit në këtë tragjedi dhe në veprat e tjera të tij. Ai thotë se në këtë tragjedi edhe dialogu i brendshëm edhe portreti njëdimensional i Sulltanit, jepen me një tjetër dimension më shumë, atë të mendimeve dhe sjelljeve të tij.

Pra, karakteri i Sulltanit emigron në shumë krijime të Çajupit, por mënyra se si realizohet është e ndryshme. Në skenën e parë të aktit të fundit, përshkrimi i Shqipërisë në njëfarë mënyre na kujton përshkrimet e Naim Frashërit, që mundëson ta kualifikojmë si një pikëtakim me përshkrimet romanteske të natyrës shqiptare, që del edhe si dialog me traditën.

Kryesisht, në këtë hapësirë tekstuale, Skënderbeu është projektuar si një figurë e madhe me të cilin synohet të ringjallet populli shqiptar dhe të ndryshohet pozita e tij. Andaj, ky Skënderbeu dallon nga ai i veprave të shkrimtarëve të famshëm të periudhës romantike, sepse atje nuk duket si luftëtar, pushtues, por prania e tij është shpirtërore, përderisa te kjo dramë e Çajupit ai përzgjidhet për të transmetuar mesazhe në mënyrë më efektive.

Titulli i tragjedisë bëhet më i qartë po të kemi parasysh se autori nuk aludon për kohën e Skënderbeut por për kohën e vet. Skënderbeu, katër ose pesë shekuj pas lindjes së tij, ende ekziston në vetëdijen shpirtërore të çdo shqiptari. Kjo më së miri mund të ilustruhet nga vargjet:

"Ç'mund te bëjë Skënder – Beu/ tani që doli nga dheu . " (Çajupi 1983).

Prania e letrës në tekstin e dramës, është një shembull i inkuadrimit të tekstit në tekst, pasi teksti i letres është teksti i një karakteri të dramës, përderisa drama është teksti i autorit, në këtë rast Çajupit. Ky është një shembull i mirë që mund të lidhet me pikëpamjet teorike të ofruara nga Jurij Mihajloviç Lotman, veçanërisht kur ai flet për këtë dukuri. Gjithashtu, letra lejon të shihet si një shembull i citatshmërisë, që do të mundet të kualifikohet si një citat i remë.

### *Intertekstualiteti në komeditë e Çajupit*

Te "Burr i dheut", krijohet thjesht një dialog me historinë dhe kontekstin politik, i cili është realizuar duke ndryshuar faktet historike. Në komedinë "Pas vdekjes", sërisht hetohet e aplikuar një metodë e ngjashme e hibridizimit të karaktereve të njohura dhe të reja ose të hasura te bashkëkohësit e shkrimtarit me të cilët ishte në polemikë të ashpër. Me këtë akt të inkuadrimit të personazhëve nga jeta reale, vepra letrare komunikon me realitetin e kohës së autorit, që rezulton me raportin e tekstit letrar dhe kontekstit.

Karakterit i Adham-utit, i cili nga bashkëkohës i Çajupit kthehet në një personazh letrar, duke u shfaqur edhe këtu, është më se e qartë se do të jetë gjithmonë një preokupim. Ai do të jetë një objektiv i vazhdueshëm i shkrimtarit. Përmes dialogut, zbulohet personaliteti i tij i vërtetë, dhe veprimtaria antishqiptare e pseudopatriotëve: "Përbuzja dhe urrejtja ndaj këtij njeriu që, dukej, ishte mjaft labil politikisht, do ta shtyjnë Çajupin që të kalojë çdo masë në zhvlerësimin e tij, të përdor në dyluftimin me të jo vetëm argument të natyrës parimore, por edhe argument të natyrës fare private, domethënë ta lëshojë frontin kryesor ..." (Qosja 2005:82).

Komunikimi me kontekstin kohor nuk ndërpritet këtu, ai realizohet në mënyrë të vazhdueshme, ndërsa elementet që e realizojnë këtë lloj komunikimi janë: "Rrufeja" (revista që përmendet) në Egjipt nga viti 1909 në redaktim të Jani Vruhos; "Bashkimi i Kombit" gazetë nga 1909-1910; "Liria", revistë e botuar në Selamik mes 1908-1909; Bashkimi, shoqëria shqiptare president i së cilës do të jetë Çajupi.

Përveç Dr. Adham - utit, që është në fakt Dr. Adamudi real, këtu përmenden edhe Naim Frashëri, Medi Frashëri, Haxhi Aliu i cili është deputet në parlamentin turk, Leonida Naçi, Dr Turtuli që jepet si Tru-Tuli, Kristo Luarasi etj. Përmes tyre, shtrohet çështja e alfabetit shqip, veprimet anti - shqiptare të kundërshtarëve të Çajupit, sjellja e tyre demagogjike, etj. Jo rastësisht, Çajupi veprimin e vë në Klubin e Selanikut. Ai, në pamfletin e botuar "Klubi i Selanikut" shkruan për punën destruktive që bën ky klub, përderisa më vonë pikërisht këtë mjedis do ta shohë si të përshtatshëm për veprimin e komedisë së tij.

Komedia ofron depërtim të fuqishëm të tonit realist dhe sarkazmës. Pra, Çajupi për tekstin e tij zgjedh mjaft mjete për të sulmuar, demaskon fëtyrat e rreme, ndërsa kur bëhet fjalë për krahasime, ai shprehjet e fuqishme i gjen më të qëlluara në folklorin shqiptar. Studiuesi Jani Thomai (Thomai 1992:161), duke folur rreth tekstit dhe gjuhës, shprehjet se Çajupi e njeh mirë frazeologjinë popullore por edhe mjeshhtërisht e përdor atë në veprat e tij.

Një raport të tillë, që tekstet dramaturgjike e vendosin me folklorin, shihet edhe në “*Katërbëdhjetë vjeç dhëndër*”. Këtu, raporti i tekstit letrar me besytinë popullore lidhet me besimet lidhur me trashëgimin e emrave vetiakë. Mark Tirta (Tirta 2004:198), në studimin “Mitologjia ndër shqiptarë” e jep këtë shembull: “Kur gruaja lehonë i thotë se vajzës që posa ka lindur ia ka vënë emrin Hënë, Tana skandalizohet sepse fëmija e saj (e Tanës) që ka pas lindur e vdekur 20 vjetë më parë quhej Hënë. Ky reagim ndodh nga besimi i saj, sipas të cilit bashkë me emrin i ka shkuar fëmija e saj e vdekur te një grua tjetër, gjë që për në prind me të tilla paragjykitime nuk mund të miratohej dhe as të pranohej”. Shkrimtari në veprat e tij në vargje, më shpesh përdor vargje tetërokëshe, diçka që e gjejmë në masë të madhe në folklor, ndërsa më pak vargje gjashtë, dhjetë dhe dymbëdhjetërokëshe.

Kështu, marrëdhëniet intertekstuale, në veprat e lartpërmendura, shihet që dalin si komunikime të natyrave të ndryshme, duke qenë të shënuara ose jo, në sistemet e jashtme apo të brendshme të komunikimit. Duke qenë kjo një krijimtari që vjen përpara postmodernies, jep shembullin e një komunikimi intertekstual të theksuar kryesisht në mënyrë eksplicite.

### **Përfundim**

Nga ky vështrim u pa që veprat dramaturgjike të Çajupit realizohen në vetëdijen e lexuesit si një dalje rrjeti ku u gjet folklori, historia, bashkëkohësia e Çajupit. E gjithë kjo manifestohej përmes: parateksteve, citateve të shifruara, aluzionit. Nëse pranojmë se është i nevojshëm roli i lexuesit të angazhuar, nuk duhet harruar që teksti i Çajupit nuk është i mbyllur dhe se leximi nuk vështirësohet në shkallë të lartë edhe për lexuesin tjetër. D.m.th vepra nuk është hermetike. Punimi ishte vetëm një orvatje e shkurtër për të theksuar rolin e lexuesit në gjetjen e nënshtresimeve, me çka duhet pasur parasysh se vepra e Çajupit jep mundësinë e hetimit të shumë më tepër shembujve të ekzistimit të intertek

### **Referencat**

Çajupi, 1983, *Vepra 3*, Rilindja, Prishtinë.

Çajupi, 1983, *Vepra 6*, Rilindja, Prishtinë.

Qosja, R., 2005, *Shkrimtarë dhe periudha*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

Rushidi-Rexhepi J., 2008, *Intertekstualiteti në krijimtarinë letrare të Fan S. Nolit, A. Z. Çajupit dhe Etëhem Haxhiademit*, Tezë magjistrature, Fakulteti Blazhe Koneski, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, Shkup.

Oraic –Tolic, D., 1990 *Teorija citatnosti*, Zagreb.

Tirta, M., 2004, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë.

Thomai, J., 1992, *Teksti dhe gjuha*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë.

Vellek, R., Uoren, O., *Teoria e leterisës*, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë.

Кулавова, К., 2003, *Теорија на интертекстуалноста*, Култура, Шкуп.

## Asdreni, oshënari i gjuhës dhe i letërsisë shqipe

**Luljeta Adili- Çeliku**

Universiteti i Evropës Juglindore

Tetovë, Maqedoni

[Ladili@seeu.edu.mk](mailto:Ladili@seeu.edu.mk)

Një nga personazhet më të rëndësishëm të letërsisë dhe gjuhës është Aleks Stavri Drenova. I lindur në Drenovë në vitin 1872, atëherë kur Shqipëria lëngonte jo vetëm në robëri kombëtare po edhe sociale, Asdreni ra herët në "rjetën" e dashurisë për botën shqiptare, ndoshta qysh në bankat e shkollës greke të fshatit aty ku shqipja ndalohej dhe mallkohej. Ne nuk dimë ç'drejtim do të merrte jeta e Asdrenit nëse ai nuk do të ishte në moshë akoma të re për në Bukuresht, aty ku tashmë kishin shkuar kaq shumë shqiptarë, mes të tjerëve edhe vëllezërit e tij. Ajo që dimë është se letërsia dhe bota shqipe do të kishte humbur një atdhetar të kulluar, një njeri dhe poet me ndjenja fine dhe një lëvrues tjetër të shqipes.

*"... Është theksuar veçmas kontributi që Asdreni si njeri dhe si krijues i ka dhënë krijimit të vetëdijes kombëtare përpara shpalljes së pavarësisë, e diç më pak kontributi që i ka dhënë formimit të vetëdijes shoqërore dhe politike të shqiptarëve pas shpalljes së pavarësisë."* ( Qosja. 2002 : 14)

Asdreni doli në skenë në gjysmë agun e letërsisë shqipe, atëherë kur sendet ravijëzoheshin po ende nuk dukeshin qartë, atëherë kur gjuha shqipe shkruhej dhe njëkohësisht pastrohej nga ndikimi që kishin lënë robërimi qindravjeçar otoman dhe gjithë ajo veprimtari antishqiptare e fqinjëve përreth. Ne nuk do ta teprojmë nëse themi se Asdreni është, ngjashëm me rilindësit tjerë, një nga themeluesit e gjuhës së re shqipe. Duke përdorur zhdërvjelltësinë që i ofronte njohja e gjuhëve tjera dhe gatishmëria për të thithur dhe për të mësuar gjithë ç' jepte letërsia dhe shkrimet e kohës, mund të themi se herë-herë të duket sikur gjuha e poezive të tij është kjo gjuha bashkëkohore që ne përdorim sot.

Koha dhe vendi ku jetoi gdhendën portretin e poetit dhe atdhetarit. Të jetuarit në Bukuresht, aty ku gjëllinte një nga kolonitë më përparimtare të asaj periudhe, ku jetonin personazhe nga më të çuditshmet dhe nga më bujaret, lanë gjurmë në formimin shpirtëror të Drenovasis thananik. Është ky Bukureshti i njerëzve si Nikolla Naço dhe i patriotëve tjerë që nuk kursenin paratë dhe kohën për të ndritur vetëdijen e kombit. Aktiviteti botues i shoqërive ishte si një fabrikë e madhe që nxirrte libra që shpërndaheshin pastaj nëpër qytetet dhe fshatrat e Shqipërisë. Nga tipografia e shoqërisë së Bukureshtit panë dritën kaq shumë vepra të rëndësishme të Rilindjes sonë: veprat e Naimit për mësonjëtorët shqip, poezitë e Naimit, shkrimet e Jani Vretos, veprat e Samiut. Këto dhe aktiviteti i dendur i atdhetarëve mërgimtarë të kolonisë së Bukureshtit, si dhe shija e hollë dhe etja e madhe për të mësuar shqip dhe për të vepruar shqip, bënë që Asdreni t'i futej valles së veprimtarisë kombëtare, dhe këtë ai do ta bëjë gjer në frymën e fundit. *"Në kryeqytetin e Rumanisë ishin të gjitha kushtet që edhe ai të sëmurej prej sëmundjes së gjuhës shqipe, si dhe shumë shqiptarë tjerë"* – thotë studiuesi më i gjithanshëm i jetës dhe i veprës së tij, prof. Rexhep Qosja` ( Qosja., 2002 : 52). Duhet të përmendet këtu se futja e Asdrenit në lëvizjen kombëtare që në fillim pati një motiv të përzier, kombëtar dhe social. Ky motiv do ta ndjekë atë gjithë jetën duke e bërë ndoshta një ndër

shkrimtarët e parë të rrymës së realizmit. Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe: kohërat dhe mësimet që mori, ndonëse gjithmonë të ndërprera, si dhe vendet ku fati e shtyri të kalojë, i vunë vulën jetimit nga Drenova të hapë si zemrën, ashtu edhe sytë: të parën për atdheun, të dytët për gjendjen sociale dhe varfërinë e kombit e vet. Ky dualizëm romantiko-shoqëror, nëse mund të thuhet një fjalë të këtillë, do ta bëjnë Asdrenin të ketë njëzën këmbë në Rilindje dhe tjetrën në periudhën pas saj.

*“ Megjithëse me një vonesë të dukshme, por historikisht të përligjur për shkaqe historike dhe shoqërore, letërsia shqipe në sajë të poezisë së Asdrenit i jeton në mënyrë pak a shumë, të qartë periudhat kryesore nëpër të cilat kalojnë letërsitë e popujve evropianë gjatë shekujve XIX dhe XX. ( Qosja., 2002 : 18)*

Nga biografët dhe studiuesit e tij përmendet se në vitin 1899 Asdreni u nis rrugës për në Shqipëri duke kaluar nga Stambolli. Ndonëse do ketë dashur të takohet me atdhetarët e shoqërisë së Stambollit, për të cilët kishte lexuar dhe librat e të cilëve i kishte radhosur e i kishte faqosur teksta punonte me atdhetarin gjaknxehtë Nikolla Naço, fati nuk e kishte të shkruar një takim me Naimin apo me Samiun. Ashtu kokëvarur do jetë kthyer në vendlindje për të parë dhe për të ndier edhe një herë lemerisjen e fshatarëve, shkretimin e shtëpive, ikjen varg e varg të mjeranëve nga shtëpitë e tyre duke lënë pas fëmijë, gra shamizeza, të cilat që tani mund të nisnin ta quanin veten vejusha.

Pas kthimit në Bukuresht, me andrallat e veprimtarit, duke shëtitur shoqëri dhe klub më klub, nën tymin dhe sharjet dhe zënkat e të mërguarve, Asdreni jetonte dita-ditës, me shumë pak para në xhep, derisa një ditë prej ditëve nisi bashkëpunimi me gazetën “Albania” të Faik Konicës që botohej në mes të Brukselit në të cilën nisi të botonte poezitë e tij të para.

Ndonëse në përmbledhjen e tij e parë me poezi “Reze djelli” shihet qartë stili dhe patetika e poezive të Rilindjes në përmbledhjet tjera tijat nisin të dominojnë motivet tjera, duke e nxjerrë Asdrenin jashtë hijes së romantizmit klasik. Dëshpërimi që përjetoj më pas në jetë, vetmia që e ndoqi pas gjithnjë i dhanë zërit të tij një notë pesimizmi; lënia pas dore e të gjitha qeverive pasrendëse e plakën atë më shumë sesa mosha e vet e vërtetë.

### **Fjalëformimi në poezitë e Asdrenit**

Gjuha e poezisë së Asdrenit është një burim i pasur i gjuhës shqipe, mu aty, te poezia e tij duket sikur ka nisur të bëhet ajo që do jetë më pas bashkimi i dy dialekteve të gjuhës shqipe. Natyrisht që këtë ngjizje ai e bën në vjersha të ndryshme duke shkruar herë në njërin dialekt e herë në tjetrin

Ne që u ndalëm dhe i analizuam fjalët e poezisë së tij jemi dëshmitarë për korrektësinë gramatikore dhe leksikore të atyre fjalëve. Në opusin gjuhësorë takuam fjalë të krijuara me ndajshesa, fjalë të përbëra e të përngjitura, mbiemra të emëruar e fjalë të nyjzuar. Asdrenit i kanë shkuar përdore të gjitha llojet e krijimeve leksikore, siç mund të shihet edhe me poshtë në hulumtim, si fjalët e prejardhura ashtu edhe të përbërat apo të përngjiturat, si nyjzimi ashtu kompozimi. Të gjitha krijimet e kanë bukurinë dhe vlerën e vet. Po të duhej t'i veçojmë se cilat lloj krijimesh janë më të bukurat këtë do ta kishim vështirë ta bënim, të paktën nuk mund t'i ndanim me një vij të drejtë. Bukuria e fjalëve shtrihet në të gjitha fushat, në të gjitha krijimet.

Në punim fjalët jo të parme me ndajstesa janë grupuar në fjalë me parashtesa dhe fjalë me prapashtesa.

### Parashtesimi

Parashtesat që hasen te poezitë e veprave të analizuara janë: ç-/sh-/zh-,z-/x-, pa-, stër-, për-, s-, p.sh. çkallmoj ( krh. ç + foljen ngallmoj); çkulloj ( krh. ç- + foljen kulloj), zbardhëlloj ( krh. z+bardh+ëlloj ); zbukuroj ( krh. z+ bukur-oj); përmend ( krh. për- + emrin mend); përball (krh. për - + emrin ballë); stërnip ( stër+ emri nip) , stërmadh ( stër + mbiemri i,e madh (e) ); padurim (krh. pa- + emri durim); pamëshirë (krh. pa- + emri mëshirë); smundje ( s + mund+ je= zgjerimi me prapashtesën –je i foljes mund).

*Ju pemë që zbardhëlloni*

*Me lulet q'u zbukurojnë* ( R.D., 1971: 164)

.....  
*Stërgjyshërit tanë të stërvjetër*

..... (P.M., 1971:19)

### Prapashtesimi

Numri i fjalëve më prapashtesim është më i madh krahasuar me parashtesimin. Prapashtesat që janë takuar te poezitë e veprave „*Rreze dielli*„ e „*Psallme murgu*„, janë: -im, -je, -i, -(ë)ri, -(ë)si, -shëm, -eshë, -(ë)s, -ar, -tar, -or, -ore, -tor, -an, -ak, -acak, -isht, -ishte, -të, -ë, -onjë. p.sh. vështrim ( krh. foljen vështroj+ -im); gëzim ( krh. foljen gëzoj+ -im); rrahje ( folja rrah/trahur + -je); pamje ( folja shoh/parë + -je); shitesë ( krh. foljen shtoj + -esë); vullnesë ( krh. vullnet + -së); njerëzi ( krh. emrin njerëz + -i); mjeshtëri ( krh. emrin mjeshtër + -i); trimëri ( krh. emrin trim + -ëri); robëri ( krh. emrin rob + -ëri); gjerësi ( krh. mbiemrin i/e gjerë + -si); thellësi ( krh. mbiemrin i/e thellë + -si); i/e perëndishëm ( krh. emrin perëndi + -shëm); i/e mendshëm ( krh. emrin mend + -shëm); ); hyjneshë ( krh. emrin hyjni + -eshë); blegtoreshë ( krh. emrin blegtor + -eshë); shëtites ( krh. foljen shëtis + -ës); këqyrës ( krh. foljen këqyr + -ës); parëverak ( krh. emrin parëverë/ pranverë + -ak); zemërak ( krh. emrin zemër + -ak), miqësor,e ( krh. emrin miqësi + -or); malësor,e ( krh. emrin malësi + -or); ); vjershëtor ( krh. emrin vjershë + -tor); tradhtor ( krh. emrin tradhti + -tor) ; luftar ( krh. emrin luftë + -ar); detar ( krh. emrin det + -ar); rrugëtar ( krh. emrin rrugë + -tar); meshtar ( krh. emrin meshë + -tar); pleqërishte ( krh. emri pleqëri+ -ishte); dhëndërishte (krh. emri dhëndër+ -ishte) , : i/e flaktë ( nga emri flakë ) , i/e paktë ( nga folja pak ); mburonjë ( krh. foljen mburoj + -onjë ) dhe shqiponjë ( krh emrin shqipe + -onjë ).

### Nyjëzimi

Tek Asdreni, te poezia e tij, hasen edhe fjalë që janë të nyjzuara Në këtë grup bëjnë pjesë fjalët që janë formuar me anë të nyjës së përparme, te cilat në gjuhën shqipe përbëjnë një

tip të veçantë. Të tillë janë mbiemrat, që janë formuar nga pjesoret e foljeve si p.sh. i/e zbathur ( krh. pjesoren e foljes z bath); i/e ngjeshur ( krh. pjesoren e foljes ngjesh); i/e marrë ( krh. pjesoren e foljes marr); i/e tërbuar ( krh. pjesoren e foljes tërboj); i/e pëlqyer ( krh. pjesoren e foljes pëlqej); i/e poshtëruar ( krh. pjesoren e foljes poshtëroj);

*Për ty dhe Krishti vojti-i kryqësuar*

.....  
*Ballsam t'u shtjerë shpitrave të munduar*

**Kompozimi**

Nuk ngelen pas kompozimi, përkundrazi , fjalët e përbëra te poezia e Asdrenit janë në numër shumë të madh. Të gjitha këto veçohen për nga bukuria dhe korrektësia e tyre gramatikore. Pasonjë shembujt të kësaj kategorie fjalësh, si: dorë + shkrim = dorëshkrim; atdhe = at + dhe; buzëqeshje = buzë + qeshje; fatrrëfenjës = fat + rrëfenjës; mirësjellje = mirë + sjellje; fillimvere = fillim + vere; shpirtthika = shpirt + thika; kryengritës = krye + ngritës; tingull-fjetur = tingull + i/e fjetur; sytrembur = sy + i/e trembur; ar + i/e qendisur = ar + qëndisur; syqjellor = sy + qjellor (e); fijedlirë = fiye + i/e dlirë; shtatkrenar(e) = shtatë + krenar(e); shpirtmizor(e) = shpirt + mizor(e) etj.

**Përngjitja**

Në sistemin e fjalëformimit si tip më vete bën pjesë edhe përngjitja. Fjalë të përngjitura quhen ato fjalë të cilat janë të formuar historikisht nga bashkimi i dy ose më shumë fjalëve gjatë përdorimit të tyre njëra pranë tjetrës ( Gramatika, 1995:75 ). Te Asdreni kemi hasur kësi lloj fjalës edhe atë në numër të madh, të cilat në fillim i kemi ndarë sipas kategorisë gramatikore e pastaj i kemi nëndarë së kuadër të grupit që u takojmë.

a) Ndajfoljet dominojnë në këtë lloj fjalësh, si: *të mënyrës* , si p.sh. sikundër, përmbys, mënjandë, porsì, *të kohës* : përgjithmonë, kurdoherë, askurrë, ngaherë, *të vendit*: përbrenda, përpara, përtej, ndërmjet, përdhe. Kemi takuar edhe lidhëza e përemra, si:

b) Lidhëza të përngjitura: megjithëqë, sadoqë, megjithë, domethënë, gjithashtu, përndaj, sakaq.

c)Përemra të përngjitur: secili; çdokush; kurrkush; askush; ndokush; tjetërkush; gjithkush; asnjëri; gjithçka, gjithçka

d) Pashirra të përngjitura: tungjatjeta; lamtumirë.

f)Emra të përngjitur: prendverë; tynzot etj.

**Konversioni**

Kur një fjalë për shkak të kushteve sintaksore kalon prej një pjesë të ligjëratës në një pjesë tjetër, kemi të bëjmë me konversion ( Gramatika, 1995: 77). Mënyra më e zakonshme e

konversionit është emërzimi, ose kalimi i mbiemrit në emër. Edhe tek Asdreni gjejmë kësi fjalës te konvertuara. Sa i përket llojshmërisë së emërzimit, kemi dy lloje: emërzime kontekstuale dhe të qëndrueshme. Emërzim kontekstual a gramatikor kemi atëherë kur një mbiemër funksionon si emër vetëm brenda një konteksti të caktuar. Këtë aftësi e kanë të gjithë mbiemrat e gjuhës shqipe. Emërzimi i tillë ndodh për arsye stilistike, dhe shumica e fjalëve të hasura në studim i takojnë këtij lloj emërzimi si, p.sh.: i/e ngjarë(a) nga mbiemri i/e ngjarë; i/e parë nga mbiemri i/e parë; i/e mjeri (a) nga mbiemri i/e mjerë; i/e folur (a) nga mbiemri i/e folur; i/e dukuri(a) nga mbiemri i/e dukur; i/e burgosuri (a) nga mbiemri i/e burgosur; i/e pikuari (a) nga mbiemri i/e pikuar; i/e varfëri (a) nga mbiemri i/e varfër; i/e gjori (a) nga mbiemri i/e gjorë etj.

*Të urët ishin për **begatinë** (R.D., 1971: 174)*

.....

*O kasolle që më rite*

*Ndë vogëli (R.D., 1971: 144)*

## **Përfundimi**

Asdreni do të ndërtojë mbi themelin e ngritur nga pararendësit e tij. Këtë do ta bëjë me dashurinë më të madhe të tij, dashuri kjo që nuk e zëvendësojë me asgjë. Dashuria për gjuhën dhe vendin e tij ngeli e para dhe e fundit për të.

Në veprën e parë të analizuar të tij, Rreze Dielli, gjuha e Asdrenit i ngjan shumë gjuhës së romantikëve, por përsëri ngelet në origjinalitetin e vet. Ngjajshmëritë i diktonin rrethanat në të cilat shkruauhej, gjendja në të cilën ishin lexuesit e tyre në atë kohë. Ishte një gjuhë paksa më e thjeshtë, një gjuhë e cila pastaj do të merrte përpjetën e saj. Këtë e shohim në veprën tjetër të analizuar, në Psallme Murgu. Këtu kemi të bëjmë më një gjuhë shumë të pasur e cila nuk të lë asgjë për të dëshiruar, me një gjuhë me krijime të forta gramatikore, pothuajse plotësisht letrare.

Te Asdreni, dominojnë krijimet prapashtesore dhe atë fjalët me prapashtesën –im dhe –je.. Krijimet me-i, -ëri, -ësi janë në numër të madh prapashtesa këta me të cilat gjejmë të krijuar emra abstrakt ashtu si në gjuhën e sotme shqipe. Siç shihen edhe në punim më lart te Asdreni janë të pranishme të gjitha llojet e mundshme të krijimeve që janë edhe sot e gjithë ditën të pranishme në gjuhën tone, si nryjëzimi, kompozimi, përngjitja, emërzimi.

Gjuha e Asdrenit është gjuhë e cila ka ndërtuar një mur të fortë në themëlet që i hodhën të bashkëdhjetarët.

Në historinë e letërsisë dhe të kulturës shqiptare Asdreni do mbetet gjithmonë jo vetëm si hartuesi i famshëm i himnit tonë kombëtar, por edhe shkrimtari vetëmohues që i dha letërsisë dhe gjuhës jo vetëm poezi dhe fjalë të reja, po që gjithë jetën e tij e vuri mu në altarin e kombit. Asdreni do mbetet ai poeti dhe atdhedashësi barkthatë dhe i nëpërkëmbur i kombit tonë, dhe ndërgjegjja e papastër e qeverive shqiptare pas pavarësisë.

**Referenca:**

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë., 1973. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë., 1973. *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*. Tiranë.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë., 2004. *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë., 1995. *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë., 1995. *Gramatika e gjuhës shqipe II*. Tiranë.

Asdreni., 1971. *Rreze djelli*. Prishtinë: Rilindja.

Asdreni., 1971. *Psallme murgu*. Prishtinë: Rilindja.

Çabej, E., 1977. *Studime gjuhësore III*, Prishtinë: Rilindja.

Kasneci, M., 2000. *Fjalëformimi në veprat e gjergj Fishtësh*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Qosja, R., 2002. *Asdreni, jeta dhe vepra*. Tiranë: Toena.

## **Personazhi në romanin shqiptar në kohën e tranzicionit (Periudha e pas viteve '90)**

**Lumnje Taçi-Halili**

Shtëpia botuese "URA",  
Prishtinë, Kosovë,  
[ana\\_drini@yahoo.com](mailto:ana_drini@yahoo.com)

### **Hyrje në krijimin e romanit shqiptar nga vitet '90 e këndej**

Periudha e krijimit të romanit në Letërsinë Shqipe gjatë viteve të '90 e këndej, deri në dekadën e parë të shekullit XXI, do të mund të karakterizohet si letërsi e çlirimit tematik, e atij artistik dhe e çlirimit estetik. Letërsia shqipe, në të dy krahët e saj, si në Shqipëri po ashtu edhe në Kosovë, për gati gjysmë shekulli, kishte fatin e keq që të ndërliqej ashpërsisht, qoftë me dogmat komuniste shtetërore, qoftë me censurën politike, e cila kufizonte dukshëm tematikën, duke shpërfaqur edhe rrudhjet tjera artistike. Për të mos thënë, të shumtën e drejtuar edhe me prirjet antiartistike, e antihumaniste.

Në Kosovë, letërsia shqipe pengohej nga politika sunduese antishqiptare serbe. Nëse flitet për letërsinë shqipe të pasviteve të '90, ndoshta do të ishte më e drejtë të flitet sot, në kuadrin e ndryshimeve politike që sollli liria e shprehjes dhe e botimeve. Nëse ky çlirim ndodhi si pasojë e rrethanave të reja që u krijuan me plasjen e rrathëve të ekzorcizmave në shtetet totalitare, nën të cilat jetuan shqiptarët, atëherë patjetër që edhe romani shqiptar i kësaj periudhe, do ta ketë ndërjerë këtë ndryshim të horizontit të receptivit, ku do të hiqen më në fund ndalesat mbi shkrimtarët e anatemuar, do të shtohet numri i shtëpive botuese dhe i firmave të reja të autorëve, do të botohen artikuj, recensione, monografi studimore e madje edhe libra të tërë historiko-letrarë, do të botohen një numër shumë më i madh i veprave letrare, do të bëhen përkthime të reja të veprave të letërsisë botërore, do të përhapet tregu i botimeve, do të formohen klube, shoqata e forma të reja organizimi dhe do të botohen revista të reja e faqe të reja për letërsi në shtypin ditor. Mbahen konferenca shkencore që i kushtohen letërsisë.

Përcaktimi kohor i çdo krijuesi shënon periodën kohore historike, e cila është shumë e rëndësishme dhe mjaft e veçantë për letërsinë shqipe.

### **Kategoria e personazhit dhe ndryshimet e tij në zhanret e fikcionit letrar**

Larmia e madhe e personazheve, ka shënuar gjithnjë një vijë ngjitëse dhe një lakore nga epoka letrare, nga një drejtim, rrymë, formacion stilistik, fenomen letrar a periudhë letrare në epokën në të cilën është krijuar, në drejtimin, rrymën, formacionin stilistik, fenomenin letrar a periudhën letrare tjetër. Në këtë kuadër, edhe personazhi letrar zë një vend shumë të rëndësishëm. Kategoria e personazhit, e cila ka një funksion përshkrues, duket e natyrshme në të gjitha zhanret e fikcionit letrar. Tek ne tashmë është krijuar tradita e përdorimit të termit fikcion letrar, sidomos tek kritikët dhe studiuesit e rinj të letërsisë, ndërkohë që një ndarje në dy grupe të mëdha përvijohet që në fillim të viteve '70: Letërsi imagjinatave /Letërsi diskursive nga R. Qosja, A. Aliu, S.Hamiti etj., ky term i atribuohet kryesisht prozës, letrarësisë. Arsyeja qëndron se, në dekadën e parë të shekullit që lamë pas, u desh që vëmendja të përqendrohej tek realiteti i drejtpërdrejtë letrar, si kriter i përafrimit me tekstet letrare, për t'u distancuar nga epoka që

përrjashtonte kriterin estetik.

Mirëpo, kjo kategori estetike (e personazhit), mund të jetë me funksion të përdorimit problematik, më pak përshkrues, d.m.th. interpretues, (apo mbi-interpretues), kur ajo (kategori), si e tillë, aplikohet për veprat e mëparshme që mbajnë shenjën e paradigmes së romanit "realist" të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shpesh e favorizuar nga teoricientë me konceptimin, ajo përcjell një seri të tërë të supozimeve, veçanërisht në aspektin e analizës psikologjike, krejtësisht të huaj për letërsinë antike dhe klasike. Sado që ka mjaft shkrime kritiko-letrare dhe studimore që merren me prozën shqipe të këtyre viteve, megjithatë, ndonjë studim i mirëfilltë me pretendime monografike, ende nuk është bërë, e aq më pak, ndonjë studim që do t'i kushtojë identifikimit të personazheve. Personazhi sikur na e thotë, duke na e bërë të ditur që secili person ka *karakter fiktiv* në një vepër letrare, në çdo kohë.

### **Karakterizimi i personazhit dhe identifikimi i tij në laboratorin e romancierit**

Kështu, duke e konsideruar karakterin si një krijesë nga bashkëpunimi i romancierit me logjikën e krijimit të universit, pra të universit krijues, tashmë, u vërejt se shkruarit e romaneve ndërtojnë personazhe të ndryshme nga përditshmëria reale e pafundshme dhe e mundimshme, kështu që krijohen modele të ligjësuara nga vetë jeta sot. Çfarëdo që të jetë forma e romanit, personazhi është pika thjerrëzuese apo motori i fikcionit, me anë të të cilit e masim shkallën e vërtetësisë dhe të autenticitetit. Karakterizimet e personazhit mund të jenë të qarta, eksplicite (bartësi i rrëfimit tregon shenjat e dallimeve të gjendjes civile, gjinisë apo të shtresës sociale). Shkrimtari pikturon portrete, bën analiza psikologjike që portretizojnë një karakter, por më shpesh nënkuptohet me konotacione që i referohen vetvetes, apo kombinimit narrativ të diskursit social dhe të marrëdhënieve shoqërore, të cilat në mënyrë të tërthortë plotësojnë njohuritë tona mbi personazhin. Romancieri në rolin e demiurgut, e përqendron vëmendjen në gjasat e botës që ai ka krijuar. Romancieri i jep personazhit një identitet, të cilin dëshiron ta bëjë të besueshëm dhe të rëndësishëm. Përshkrimi këtu është një mjet i privilegjuar i karakterizimit eksplicit, nga pozitat e gjithëditshme, për të zbuluar të kaluarën e një karakteri, për të zbuluar mendimet e tij, sintetikisht, e mandej për të organizuar një tablo të detajuar. Kurse nga aspekti fizik, personazhi paraqitet me një trup e me tiparet e veta karakteristike të zgjedhura, piktoreske, por edhe në aspektin e detajeve të veçanta që mund të sugjerojnë tipare. Nga aspekti moral, romancieri fokusohet në shprehjen e ndjenjave, është i interesuar të depërtojë në manifestimet e tyre, tek shfaqja e lotit, dukja e buzëqeshjes, apo në gjeste të rëndësishme. Personalitetin e personazhit mund ta vendosë diku tek një individ i veçantë, ose ta paraqesë si një hero, ai, mund ta bëjë atë në vend të kësaj një kopje të vetme a një specie sociale. Nga aspekti social, personazhi paraqet një mjedis, një veshje, një vend pune, paraqet gjuhën, ideologjinë, etnitetin etj.. Kështu, bëhet një tip dhe, së këndejmi, buron një tipologji e pasur e personazheve në romane.

### **Triumfi i letërsisë mbi anatemen e krijuar ndaj shkrimtarëve të ndaluar**

Pasi në dekadën e fundit të mijëvjeçarit që e lamë pas, plasën dallimet totalitare, pushtuese e ideologjike, ishte dhe është letërsia që triumfoi dhe do të triumfojë kurdoherë, me proceset e reja letrare, por vetëm së bashku me motrën e saj të përjetshme- demokracinë. Nuk

është për t'u habitur prandaj se, vepra letrare e shkrimtarëve të ndaluar: Martin Camaj, Kasëm Trebeshinës, Visar Zhitit, Bashkim Shehut, Adem Demaçit etj..., vjen në mesin tonë me kaq vonesë, kur kemi parasysh faktin se këta e kishin bartur në emrin e tyre personal shenjën emblematike të letërsisë për kohën që po jetonin, por edhe të kombit e të vendit të tyre.

Ndërsa kjo letërsi, na vjen triumfuese mbi anatemën aq të gjatë politike e pushtuese, që u ushtrua ndaj këtyre autorëve e ndaj veprës së tyre. Kështu që, patjetër që edhe romani e letërsia e tyre do të bartë ato rravime e shenja jetësore. Prandaj, janë dy hapësira, të cilat e karakterizojnë botën shpirtërore të shkrimtarëve (nëpër dy kohë të ndryshme), pa përjashtuar këtu edhe ekzistimin e kontekstit psikologjik, social dhe historik, brenda rrjedhës së zhvillimit të përgjithshëm të letërsisë.

Këta autorë, me të drejtë mund të cekim se ndoqën rrugën e gjatë e të vështirë të jetës shqiptare. Andaj, nuk na habit fakti sot, që tek romanet e Fatos Kongolit, Bashkim Shehut, Diana Çulit, Mehmet Krajës, Jusuf Buxhovit, Ismail Kadaresë, Zija Çelës, Murat Isakut, Ridvan Dibrës, Agron Tufës, Flutura Açkës, paraqitet herë tema e personazhit të këtij tranzicioni dramatik të shoqërisë shqiptare, herë lufta si pjesë përbërëse kryesore stilistike-tematike e autorëve nga Kosova, po ashtu edhe ajo e rezistencës nacionale me bërthamën e brendshme të individit, përballë shoqërisë shtypëse pushtuese, sikurse tek kveprat e Murat Isakut në Maqedoni.

Disa prej romaneve të kësaj kohe, karakterizohen nga një mënyrë e re e shkrimit, sado që u pritën pak me hezitim dhe moskuptim nga lexuesit, apo edhe nga studiuesit siç janë: romani *Rrathë* i Camajt, *Odin Mondvalsen* i Trebeshinës, *Ulku dhe Uilli* i Vath Koreshit, *Las varrezas* i Zija Çelës, romanet *I humburi*, *Kufoma* të Kongolit, apo *Piramida*, *Hija* të Kadaresë, *Muri i mjegullës*, duke vazhduar edhe me romane të tjerë, si ato të M. Krajës *Stina e ujkut*, *Triumfi i Gjergj Elez Alisë* të R. Dibrës apo *Dueli* i A. Tufës etj.. Megjithatë, këta autorë ndërtuan shijen e re të lexuesit, nxitën studimet letrare për fenomene e dukuri estetike e artistike dhe i sollën vlera të reja të romanit.

### **Personazhi i sotëm jo heroik, por që tregon historinë e një kohe**

Brenda kësaj vazhde të romaneve, edhe kategoria e personazhit është më tepër se karakter, apo thjeshtë, më tepër se një portretizim e karakterizim i tij, hera-herës, personazhi është më pak se një karakter si *tip* dhe *trajtë*, por ka shfaqje edhe për më shumë, sepse ky karakter paraqitet *si funksion* (i ekzistencës). Ndërkohë që romani modern tashmë i ka thyer kufijtë tradicionalë të formësimit të personazhit. Ky personazh, i zgjeron cilësitë e veçoritë e tij të karakterit, natyrën e tij psikologjike e enigmatike në përmasa të pakufishme. Ashtu sikundër që begatohet përvoja njerëzore në qenien e tij shoqërore, historike e shpirtërore, po ashtu edhe pasurohet, zgjerohet e thellohet edhe personazhi letrar, duke pushtuar hapësira gjithnjë e më të gjera të lirisë së shprehjes, formësimit e formimit, të veprimtarive të tij të pakufishme njerëzore e shoqërore dhe të manifestimeve të pasura psikologjike e shpirtërore. Ky personazh, duke u zgjeruar, e duke i mbajtur lidhjet me karakterin tradicional të letërsisë që nga Aristoteli e këndeje, nuk e ka humbur asnjëherë identitetin e tij, por e ka formësuar e forcuar këtë *identitet letrar e artistik*.

Personazhet e kësaj periudhe letrare, të romaneve, nuk janë historike, *ata* apo *ato* nuk janë heronj a heroina, por janë personazhe kulturorë në përgjithësi, ata janë nga shtresa të ndryshme, që nga intelektualit më i shquar e deri tek njeriu i rëndomtë, por që të gjithë tregojnë historinë e një kohe. Kohën që vazhdon ende me përmruesin dëftor të sotëm të tranzicionit. Personazhet e këtij romani shpesh rendin nëpër vende të ndryshme, herë në Itali e herë në

Shqipëri, siç ndodh tek romani i V. Zhitit *Në kohën e britmës*, apo tek romani i D.Çulit *Diell në mesnatë*, ata marrin guximin, kudo që janë të vet identifikohen. Ka raste, jo të rralla, kur etnonimi (sado i lehtë e thirrmo), është identifikues në këto romane.

### **Përmbyllje rreth tipologjisë së personazhit të sotëm si përbërës rrëfimi me një vizion humanitar përgjithësues**

Romani shqiptar i viteve të '90 e kënde, si me përmbajtjet, strukturat artistike a kompozicionale, si me llojllojshmërinë e personazheve të ndërliqshëm, si me strukturat komplekse të rrëfimit, në mënyrë të pandërprerë pushton hapësira të reja të rymimeve e të lëvizjeve komplekse të jetës, shoqërisë dhe historisë. Ndërkohë që interpretimi, zëbrthimi dhe studimi i tipologjisë së personazhit, bëhet me kërkesën për t'i parë marrëdhëniet e autorit me veprën dhe, së këndejmi, me rrjetin e pasur të tipologjisë së përbërësve të rrëfimit, autorit si bartës rrëfimi, rrëfimtari (narratorit) dhe personazhit. Nga ana tjetër, të gjitha këto situata jetësore, historike, shoqërore e të realitetit tranzicional, përpiqet t'i paraqesë si gjendje shpirtërore që ndryshojnë vazhdimisht, që shënojnë ngritje e pjekuri të vazhdueshme të vetëdijes historike e jetësore. Është personazhi i këtyre romaneve që gjithnjë e paraqet dhe synon ta shqiptojë të vërtetën për kuadrin e një vizioni të mundshëm, gjithmonë në planin e filozofisë së jetës, gjithashtu në planin personal, kësajsoj edhe në atë të subjektivitetit krijues, pothuajse edhe atëherë kur ndodhet ky personazh përballë një dhune të egër fizike e ideologjike.

Duke parë brenda kontekstit e zhvillimit të letërsisë shqipe si në Shqipëri, po ashtu edhe në Kosovë, problemi i dhunës edhe sot e asaj kohe, ka mbetur problem i historiografisë shqiptare, sepse niveli i shtrirjes së kësaj dhune, qoftë dhunë fizike, apo ideologjike, kap përmasa të mëdha duke u shtrirë sa andej kufijve e kënde, kudo ku gjenden shqiptarët. Dhuna ideologjike e ushtruar për gati katër dekada, në trevat shqipfolëse e shqipshkruese, lë padyshim kuptimin e interpretimit të letërsisë, si luftë që sakaqherë, përballet vlera me antivlerën në krijimtarinë ndërmjet kohërave. Tekqë kjo periudhë kohore, prej më se dyzet vjetësh, pas përmbysjes së diktaturave, bëri të mundur që të dalin në shesh shumë fakte, duke ndryshuar realitetin socio-politik.

Tani dolën edhe bartësit kryesorë të vlerave të reja dhe moderne letrare që po vinin pas këtyre përmbysjeve, të cilët bredhin drejt trendeve letrare botërore, duke e përshkallëzuar letërsinë shqipe përkrah tendencave moderne. Tekdo nga vitet '90, dominon gjithnjë e më shumë orientimi modern edhe i shkrimit shqip.

Përkundrejt vërshimit të këtij lumi të madh autorësh e veprash që lindën pareshtur në këtë kohë, ekziston një pasqyrë përzgjedhëse, që në të ardhmen e sotme duhen shqyrtuar disa nga autorët dhe veprat, të cilët lanë gjurmë si rrallëkush në letërsinë shqipe të kësaj kohe, për t'i parë kështu, sipas tyre, enigmat e fatit, përplasjet dramatike dhe qëndrimet bashkëkohore, ndaj po kësaj kohe- të sotme, kudo në thellësinë e qenies së heroit apo anti heroit. Më konkretisht, për ta parë relievimin dhe konfigurimin komentues të autorit për kohën, veprës, personazhit dhe rrëfimtari, e në veçanti, për të parë identifikimin e këtyre personazheve, ia vlen që sot letërsia bashkëkohore të marrë për studim thelbësor e shumëdimensional disa nga veprat e autorëve të poshtëshënuar, si: *I humburi*, *Si-do-re-la*, *Te porta e Shën Pjetrit*, të Fatos Kongolit, *Rrugët e ferrit*, *Ferri i çarë*, dhe *Në kohën e britmës të Visar Zhitit*, romani *Dueli i A. Tufës*, romani *Aksidenti i I. Kadaresë*, romanet e D. Çulit *Diell në mesnatë*, ...dhe *nata u nda në mes*, *Gruaja*

*në kafe*, për të vazhduar me romanet e M. Krajës, Z. Çelës, M. Isakut, R. Dibrës, F. Açkës, M. Mehmetit e të tjerë të shumtë.

Romani dhe personazhi i këtyre romaneve (të lartpërmendura ), ka çfarë t'i ofrojë studiuesit të letërsisë bashkëkohore, sepse dallohet mirëfilli për nga pasurimi i vazhdueshëm i cilësive jetësore dhe artistike. Në secilën gjendje që ndodhet personazhi i veprave të sipërcituara, edhe atëherë, kur ky personazh është meditues, vëzhgues, persiatës, veprues, lëvizës, ai gjithëherës është me botë të pasur shpirtërore, dashurues dhe përjetues situatash. I tillë qëndron edhe në momentet kur shfaq karakterin e tij heroik, shpirtin sakrifikues apo ndjenjën e lartë atdhetare, të dashurisë për jetën dhe për vlerat humane në përgjithësi.

## Bibliografia

- Aliu, A., 30. 09. 2006. *Proza shqiptare në dhjetëvjeçarin e fundit*, Koha Ditore, f. 30, Prishtinë.
- Dado, F., 2005, *Probleme metodologjike të letërsisë së sotme, Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare (Nga gjysma e dytë e shekullit XX- poezia, proza, drama)*: ASHAK, Tiranë.
- Dado, F., 2006. *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë.
- Elsie, R., 1997. *Historia e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë- Tiranë.
- Gajraku, F., 2008. *Utopia e narracionit*, AIKD, Prishtinë.
- Švacov, V., 1976. *Temelji dramaturgije*, Shkolska knjiga, Zagreb.
- Plasari, A., 1996. *Edhe njëherë për objektin e letërsisë*, Letërsia si e tillë. Akte të Konferencës shkencore, Toena, Tiranë.
- Prendi, A., 1996. *Dukuri të reja në letërsinë e viteve të fundit*, Letërsia si e tillë - Probleme të vlerësimit të trashëgimisë sonë letrare: Akte të Konferencës shkencore, Toena, Tiranë.
- Açka, F., 2004. *Kryqi i harresës*, Tiranë, Skanderbeg books.
- Açka, F., 2009. *Ku je?*, Tiranë, Skanderbeg books.
- Aliu, A., & Shabani, S., & Çapaliku, S., & Çobani, T., 2001. *Letërsia bashkëkohore shqiptare*, Tiranë-Tetovë, Alb-as.
- Aristoteli, 2006. *Poetika*, Tiranë, Çabej.
- Brahimi, R., 1971. *Kritika*, Prishtinë, Rilindja.
- Çuli, D., 2000, *Diell në mesnatë*, Tiranë, Toena.
- Çuli, D., 2008. *...dhe nata u nda në mes*, Tiranë, Toena.
- Çuli, D., 2009. *Gruaja në kafe*, Tiranë, Toena.
- Çela, Z., 2011. *Apokalipsi sipas Shën Tiranës*, Tiranë, Toena.
- Dibra, R., 1995. *Nudo*, Tiranë, MçM Çabej.
- Eko, U., 2007. *Për letërsinë*, Tiranë, Dituria.
- Isaku, M., 2006. *Rrengu, Fatprerët, Banesa në katin e tretë*, Tetovë, Klubi letrar 94.
- Kadare, I., 2010. *Aksidenti*, Tiranë, Onufri.
- Kongoli, F., 2005. *I humburi*, Prishtinë, Koha.
- Kongoli, F., 2005. *Te porta e Shën Pjetrit*, Tiranë, Toena.
- Kongoli, F., 2010. *Si-do-re-la*, Tiranë, Toena.
- Kraja, M., 2005. *Edhe të çmendurit fluturojnë*, Tiranë, Onufri.
- Kundera, M., 2002. *Arti i romanit*, Tiranë, Toena.
- Tufa, A., 2002. *Dueli*, Tiranë, Ora.
- Zhiti, V., 2002. *Ferri i çarë*, Tiranë, Omsca-1.

## Fjalëformimi i fjalëve të përbëra në veprat e Asdrenit “Reze dielli” dhe “Psallme murgu”

**Luljeta Adili- Çeliku**

Universiteti i Evropës Juglindore,

Tetovë, Maqedoni

[l.adili@seeu.edu.mk](mailto:l.adili@seeu.edu.mk)

Asdreni bëri shumë për gjuhën shqipe aq sa mund të bëjë vetëm një atdhedashës i vërtetë. Por kjo nuk iu kthye në të njëjtën masë. Gjuha e tij ngeli pas dore nga studiuesit e gjuhës shqipes, nuk iu dha pesha e merituar që të dalin në pah vlerat gjuhësore të veprës së tij. Prandaj, u pa e udhës që në këtë punim të studiohet gjuha e tij dhe të shërbejë si një nismë e mbarë për studime të më tutjeshme. Janë analizuar dy veprat e tij: “Reze dielli” dhe “Psallme murgu” dhe nga këto janë nxjerrë në pah formimin e i fjalëve të përbëra.

Ky lloj fjalësh, i mbledhur nga veprat e lartpërmendura, është shumë i madh. Fjalë e përbërë apo kompozitë e mirëfilltë në shqipen është bërë ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy a më shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalist të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta semantike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj. (*Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe* 1972 : 83). Njëra nga këto ( tema mbështetëse, që zakonisht është e dyta) e formëson gramatikisht gjithë kompozitën, ndërsa tema tjetër, ( ose, kur janë më shumë se një) është e asnjansuar nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore ( Gramatika, 1995: 70), p.sh.: te fjala *besëshkalës*, mbaresat trajtëformuese i shtohen fjalës së dytë dhe në bazë të kësaj mund të shohim se kjo fjalë gramatikisht është e gjinisë mashkullore, meqë të njëjtën gjini gramatikore ka pjesa e dytë e saj.

Kuptimi i fjalës së përbërë mund të jetë i barabartë me kuptimin e fjalëve prej nga rrjedh njësia e re e fituar, por mund edhe mos jete i njëjtë me kuptimin e fjalëve që e kanë formuar atë njësi të re leksikore. Si rezultat i lidhjeve të shumëllojshme, në të cilat hyjnë pjesët e kompozitës, del një njësi e re leksikore që shpreh një nocion të ri, si: *duarthatë, zëtrashë*, etj.

Kompozimi është mënyra më prodhimtare e fjalëve në gjuhën shqipe pas ndajshesimit. Kompozitat, duke pasur të paktën dy tema motivuese, zakonisht kanë një temë semantike më të madhe se fjalët e prejardhura dhe e paraqesin qartë e në mënyrë më të drejtpërdrejtë nocionin që shprehin, prandaj ato po marrin përhapje të gjerë, sidomos në terminologjinë tekniko-shkencore, ku kërkohet një shprehje sa më e përpiktë dhe njëkohësisht sa më ekonomike e koncepteve. Me anë të kompozimit zakonisht formohen emra e mbiemra dhe një numër i kufizuar foljesh e ndajfoljesh.

Në formimin e një kompozite marrin pjesë tema fjalësh emërtuese: emra, mbiemra, folje e ndajfolje, si dhe tema numërorësh e përemrash dhe në bazë të kësaj mund të bëhet një ndarje e kompozitave duke marrë si parim kategorinë leksiko-gramatikore të gjymtyrëve përbërëse të kompozitës. Kështu fjalët e përbëra mund të jenë të krijuara nga: dy gjymtyra emra, nga një emër dhe një mbiemër si dhe nga një numëror dhe një emër.

Gjymtyrët e kompozitave në gjuhën shqipe janë gjithnjë dy, kurse temat janë zakonisht dy, por mund të jenë edhe më shumë. Kur kemi më shumë se dy tema, dy prej tyre hyjnë në një gjymtyrë të përbërë, ndërsa lidhja që mbizotëron është ajo bashkërenditëse. Raporti midis kuptimeve të gjymtyrëve dhe kuptimit të fjalës kompozitë varet nga raporti sintaksor midis këtyre gjymtyrëve, që mund të jetë i bashkërenditjes ose i nënrenditjes.

Ndarja kryesore e kompozitave është ndarja sipas lidhjes ndërmjet gjymtyrëve. Sipas saj, kompozitat ndahen në përcaktore dhe këpujore (Thomai, 2005 : 156):

a) Kompozitat përcaktore përbëhen prej dy gjymtyrësh, nga të cilët njëra përcakton tjetrën, ose e para të dytën, si p.sh.: punëmbarë = punë + i/e mbarë; syzezë ( krh. emrin sy + zezë/zi); leshflorinjte = lesh + i/e florinjte; zemër-gur = zemër + gur;

b) Kompozitat këpujore janë fjalë të përbëra prej dy a më shumë gjymtyrësh me lidhje bashkërenditjeje ndërmjet tyre. Ato janë emra ,si p.sh.: dorë + shkrim = dorëshkrim; atdhe = at + dhe; buzëqeshje = buzë + qeshje etj. Fjalët kompozita me lidhje këpujore janë më të pakta në fondin e fjalëve të shqipes.

Për kompozitat e shqipes së pari ka shkruar Jokli ( sipas referimeve të Çabejit), ndërsa prej gjuhëtarëve shqiptarë do përmendim Cipun, Xhuvanin, Çabejin e Kostallarën.

Siç dihet, në gjuhësinë indoevropiane terminologjia e kompozitave ka depërtuar nga indishtja, sepse ajo është mjaft e pasur me to. Të shtojmë se pjesa e parë e kompozitës del e palakuar siç ndodh në mbarë shqipen. Prof. E. Çabej për mrekulli e kishte hetuar se topika e pjesëve të kompozitave të shqipes përkon me ato të gjuhëve të tjera indoevropiane, d.m.th. elementi përcaktues i saj është i dyti dhe jo i pari ( vetëm në rasta të rralla mund të ngjajë e kundërta. ( Zymbri, 215).

### ***Fjalët e përbëra tek Asdreni***

Numri i fjalëve të përbëra të gjetura në dy veprat e analizuar të Asdrenit është shumë më i madh. Të gjitha fjalët janë mbledhur me kujdes të veçantë dhe janë analizuar nga aspekti i formimit të tyre. Këto kompozita përbëhen prej dy fjalëve, që kur ndahen kanë kuptim të mëvetësishëm. Pikërisht kështu janë analizuar të gjitha këto krijime bazuar në të se çfarë kategorish gramatikore janë bashkuar për formimin e tyre. Janë takuar fjalë që janë krijuar nga: dy emra, nga një emër e një mbiemër, nga një emër e një ndajfolje dhe një emër e një numëror. Të gjitha janë të radhitura më poshtë.

### **Fjalë të përbëra- emër + emër**

dorë + shkrim = dorëshkrim; atdhe = at + dhe; buzëqeshje = buzë + qeshje; fatrrëfenjës = fat + rrëfenjës; mirësjellje = mirë + sjellje; fillimvere = fillim + vere; shpirtthika = shpirt + thika; kryengritës = krye + ngritës; jetëprurës(e) = jetë + prurës; zemërligësi = zemër + ligësi; sygjarpërush = sy + gjarpërush; dorëplotësi = dorë + plotësi; kryekëmbë = krye + këmbë; sylugat = sy + lugat; gojë-tagar = gjojë + tagar; gjëkafshë = gjë + kafshë; kryeverë = krye + verë;

dorëhekur = dorë + hekur; kryevepër = krye + vepër; bukëprurës = bukë + prurës; ujë-ergjendi = ujë + argjendi; symisherrë = sy + misherrë; vetëvrasje ( vetë+vrasje ) kukuvajkë ( kuku+vajkë );

### **Fjalë të përbëra- emër + mbiemër**

tingull-fjetur = tingull + i/e fjetur; sytrembur = sy + i/e trembur; ar + i/e qëndisur = ar + qëndisur; syqjellor = sy + qjellor (e); fije-dlirë = fije + i/e dlirë; shtatkrenar(e) = shtatë + krenar(e); shpirtmizor(e) = shpirt + mizor(e); fatlum = fat + i,e lum (ë); fatmizor(e) = fat + mizor (e); sykulluar = sy + i/e kulluar; lule-shtruar = lule + i/e shtruar; sygjallë = sy + i/ e gjallë; luleshkruar = lule + i/e shkruar; buzëqeshur = buzë + i/e qeshur; zemërpikur = zemër + i/ e pikur; zëhyjnor(e) = zë + hyjnor (e); faqeshkruar = faqe + i/e shkruar; shpirtkulluar = shpirt + i/e kulluar; buzëplasar = buzë + i/e plasur; këpucëgrisur = këpucë + i/e grisur; buzëtharë = buzë + i/e tharë; fytyrëngjyrosur = fytyrë + i/e ngjyrosur; faqe-enjtur = faqe + i/e ënjtur; faqebardhë = faqe + i/e bardhë; syveror(e) = sy + veror(e); gjì-kaltër = gjì + i/e kaltër; shpirthelmuar = shpirt + i/e helmuar; kryemadhështor(e) = krye + madhështor(e); mendje-shkretë = mendje + i/e shkretë; lundërthyer = lundër + i/e thyer; pamjeçelur = pamje + i/e çelur; shpinëthyer = shpinë + i/e thyer; fisbujar(e) = fis + bujar(e); fismallkuar = fis + i/e mallkuar; syvrenjtur = sy + i/e vrenjtur; buzëthyer = buzë + i/e thyer; sypërgjakur = sy + i/e përgjakur; symvrenjtur = sy + i/e mvrenjtur; jetëngratë = jetë + i/e ngratë; mendjeshkurtër = mendje + i/e shkurtër; kryenaltë = krye + i/e naltë; ngjyrëbukur = ngjyrë + i/e bukur; zemërmirë = zemër + i/e mirë; ditëshkurtër = ditë + i/e shkurtër; fatbardhë = fat + i/e bardhë; syshtrembër = sy + i/e shtrembër; fatkeq(e) = fat + i/e keq( e); zëheshtur= zë + i/e heshtur; gojëhapur = gojë + i/e hapur; gushëbardhë = gushë + i/e bardhë; zemërzi = zemër + i/e zi/zezë; zemërbardhë = zemër + i/e bardhë; kohëshpejtë = kohë + i/e shpejtë; këmbëdrejtë = këmbë + i/e drejtë; shpirtlig(ë) = shpirt + i/e lig (ë); kryelartë = krye + i/ e lartë; buzëqeshur = buzë + i/e qeshur; buzëkuqur = buzë + i/e kuqur; plakëkërrusur = plakë + i/e kërrusur; mjekër-mprehtë = mjekër + i/e mprehtë; zemërngushtë = zemër + i/e ngushtë; krahëhapur = krah +i/e hapur; vetullvrenjtur = vetull + i/e vrenjtur; ditëshkurtër = ditë + i/e shkurtër; ngjyrëverdhe = ngjyrë + i/ e verdhë; krahëshkruar = krah +i/e shkruar; lulekuqe = lule + i/e kuq(e); zemërhapur = zemër + i/ e hapur; zemërmirë = zemër + i/ e mirë; dyer-mçelur = dyer + i/e mçelur;

### **Fjalë të përbëra- emër + ndajfolje**

kryetatëpjetë = krye + tatëpjetë; hirplot = hir + plot; degëplot = degë + plot; magjiplot = magji + plot; dorëplot = dorë + plot; fuqiplot = fuqi + plot; dritëplot = dritë + plot;

### **Fjalë të përbëra- numëro+ emër**

dykrenor(e) = dy + krenor(e);

### **Fjalë të përbëra nga një temë pjesoreje dhe një temë emërore**

marrëveshje ( pjesorja marrë/marr+ veshje)

### **Fjalë të përbëra nga një temë pjesoreje dhe një teme ndajfoljore**

dashamir

### **Fjalë të përbëra nga një temë ndajfoljore dhe një mbiemër**

keqfat (e).

### **Fjalë të përbëra nga një ndajfolje dhe një emër prejfoljor**

mirërritje ( ndajfolja mirë + emri prejfoljor rritje ); mirëpritje ( ndajfolja mirë + emri prejfoljor rritje ).

### **Përfundim**

Krijimi i fjalëve të përbëra është një rrugë me të cilën pasurohet gjuha shqipe. Këtë e vuri re shumë herët Asdreni, i cili krijoi fjalë të këtij lloji që në fillimet e hershme të krijimit të tij. Fjalë të përbëra në sasi dhe cilësi të lartë kemi gjetur si te vepra *Rreze djelli*. ashtu edhe te vepra *Psallme murgu*. Ne që studiojmë gjuhën e tij, që kemi qëmtuar fjalët e përbëra të tij duke i analizuar ato sipas formimit të tyre, jemi dëshmuar të zhdërvjelltësisë dhe korrektësisë së tij gjuhësore, njohjes së thellë të ligjeve të shqipes dhe krijimin e fjalëve të reja duke u mbështetur në gjedhet ekzistuese të cilat megjithatë nuk e penguan atë të shkëlqejë me përzgjedhjen e duhur dhe përfitimin stilistik të vargjeve tij.

Asdreni do të ngelet ai shkrimtari i cili i solli shqipes numër të madh fjalësh të përbëra të cilat dhe sot e gjithë ditën përdoren. Ai e kishte gjetur më në fund minierën nga ku do të nxirrte stolitë e tij dhe kjo minierë ishte gjuha shqipe, pra prej gjuhës i merrte dhe po asaj ja kthente.

## **Bibliografia:**

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë., 1973. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë., 1973. *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*. Tiranë.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë., 2004. *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë., 1995. *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë., 1995 *Gramatika e gjuhës shqipe II*. Tiranë.

Asdreni., 1971. *Rreze djelli*. Prishtinë: Rilindja.

Asdreni., 1971. *Psallme murgu*. Prishtinë: Rilindja.

Çabej, E., 1977. *Studime gjuhësore III*, Prishtinë: Rilindja.

Kasneci, M., 2000. *Fjalëformimi në veprat e gjergj Fishtësh*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Qosja, R., 2002. *Asdreni, jeta dhe vepra*. Tiranë: Toena.

*Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, 1972, Tiranë : AShSh.

## **Miti si intertekst në poezitë e Naim Frashërit**

**Meral Shehabi-Veseli**

Universiteti i Evropës Juglindore,

Tetovë, Maqedoni

[m.shehabi@seeu.edu.mk](mailto:m.shehabi@seeu.edu.mk)

### **Hyrje**

Mitologjia ka pasur ndikim të madh në kulturën e letërsive të ndryshme. Nuk do të ishte e mundur që të krijohet definicioni i qartë për mitin. Ekzistimi i definicioneve të mundshme, nuk arrinë që ta definojë këtë nocion kaq të ndërlikuar. Autor të ndryshëm kanë dhënë definicione të ndryshme, që nuk është e mjaftueshme për ta përkufizuar në mënyrë të prerë këtë nocion. Shumica e tyre e kanë përkufizuar si “poezi e vjetër”, “figura të trilluara”, “prallë e rejtshme”(Uçi, 1982: 9) etj. Rjedhimisht të gjithë definicionet ndahen në dy kategori: Miti përcaktohet si “paraqitje” fantastike për botën, ose si ritregim, tregim për veprimet e zotrave dhe heronjve. Por me gjetjen e nocionit intertekstualitet, nga Julia Kristeva paraqitet edhe mundësia që ajo të paraqes tekstin në tekst. Po ky tekst i ri i krijuar nga unifikimi i tekstit të ri me të vjetrën jep mundësinë e rileximit tekstual. Teksti i vjetër mund të jetë nga të tjerat edhe miti, gojdhënë apo prallë, e cila është dhënë me referencë ose pa atë. Miti konsiderohet si hipoteks univerzal. Gjetja e intertekstualitetit nënkupton paraqitjen e lexuesit të gjithëdijshëm ose lexuesi që ka kulturë leximit.

### **I. Gjenezja e paraqitjes së mitologjisë si intertekst**

Mitologjia ka ekzistuar që në kohrat e vjetra, por akoma vazhdon së ekzistuari. Fjala mit rrjedh nga fjala *mythos*, që do të thotë, “refim”, “gojdhënë”, “ligjërim”. Miti vazhdon të jetë i lidhur me letërsinë. Shumë autor të njohur, nga të gjithë kohërat në veprat e tyre kanë përdorur figura mitologjike, pralla, rëfime, herë ashtu siç janë herë të risemantizuar, duke përdorur miti për arritje të qëllimeve, me veprat e tyre.

V. Hygo, që në shek. 18, e paraqiti mitin si krijim letrar, si poezi naïve, e lindur në fillimet e krijimit të njerëzimit ashtu si edhe letërsia. Sipas tij, mitologjia si poezi karakterizohet me elementet e njohura të madhërishtes dhe bukurisë, por me përdorim të figurave stilistike, si personifikimi, metafora, animizmi. Sipas tij krahasimet, metaforat, personifikimi, animizmi janë “mite të vogla” derisa mitologjia nëpërgjithësi unifikohet me poezinë dhe letërsinë.

Edhe përfaqësuesit e estetikës romantike, duke e mbivlersuar fillimet poetike të mitologjisë, e vlerësuan dhe e paraqitën si formë estetike e konceptimit të jetës dhe e unifikuan artin me letërsinë. Por përmes letërsisë dhe mitologjisë ka edhe shumë dallime dhe ngjashmëri. Ngjashmërit e vetme qëndron në atë se edhe në letërsi edhe në mitologji rol të rëndësishëm luan imagjinata dhe fantazia e krijimit.

Dallimet mes letërsisë dhe mitologjisë janë në disa nivele:

- Mitologjia e parashe si të patjetërsueshëm besimin në realitetin objektiv të figurave, të krijuara nga fantazia mitologjike, derisa figurat e poezisë, arti, letërsia, nuk duhet të merren si të vërteta që të funksionojnë, ata edhe pa të vërtetën mund të funksionojnë.
- Miti është krijim i fantazisë kolektive, derisa poezia dhe arti janë krijim i fantazisë individuale.
- Mitologjia nënkupton fantazinë, e cila pranohet si e vërtetë, tek miti elementi real dhe imagjinar janë të pandarë, derisa te letërsia ngjarjet fantastike, joreale nuk kanë kuptim direkt, por janë me kuptim metaforik dhe alegorik.

Duke u nisur nga këto dallime, do të shërbehemi me një citat nga Roman Jakobsoni:

“Poezia dhe miti janë dy fuqi afërsisht të lidhura, që njëkohësisht edhe kundërshtohen” (Jakobson,1988 : 150).

Mitologjia nuk është asgjë tjetër, por botë me veshje solemne, me pamjen absolute, univers i vërtete, paraqitje për jetën dhe kaosin, përplot me mrekulli me parashikime hyjnore, e cila paraqet vetvetiu poezinë, por njëkohësisht mund të paraqitet edhe si material dhe element i saj .

A.F. Losev, duke e krahasuar mitin me shkencën, artin, metafizikën, religjionin e definon duke u shprehur se :” *miti nuk është as ide as kuptim, por e vërtetë materijale, e cila nëpërmjet jetës shijohet dhe krijohet.*” (Meletinski, 2002 :156)

Sipas K. Levi-Stros, “*Secili mit nga natyre e vet nënkupton përthim, etimologjija e tij gjendet në ndonjë mit paraprak.*” ( Sheleva, 2000:6).

Miti është i definuar edhe nga Mirlinda Krifca e cila mendon se “ Miti është kuptuar si shembull i arkietipit, përkatësisht si struktur arkizhanrovike letrare, prandaj shpesh edhe letërsia është konsideruar si mitologji e transformuar, përkatësisht është besuar se miti, në të vërtetë, është hipotekst univerzal letrar.”( Krifca, 2005: 83.)

Te romantizmi ritet interesi për mitologjinë. Nëse parashtrohet pyetja se pse ndodh kështu, do të përgjigjemi se te periudha e romantizmit më shumë se në periudhat tjera, imagjinata dhe fantazia janë në nivel më të lartë. Autorët romantik duke u larguar nga realiteti i kohës, u kthyen nga miti. Atyre u pëlqente naiviteti i krijimtarisë mitologjike. Edhe pse autorët e romantizmit nuk e përdorën mitin në mënyrë të njëjtë. Disa prej tyre u thirrën në mënyrë të drejtë e disa thërthorazi.

Naim Frashëri, veprimtaria e të cilit është objekt i trajtimit të kumtesës, në veprimtarin e tij e përdori mitin, por me një dozë më të vogël në krahasim me autorët tjerë romantik. Në krijimtarinë e tij miti është përdorur në formë të figurave. Por, për dallim nga autorët tjerë romantik, Naimi në krijimtarinë e tij do të përdor mite nga kultura të ndryshme. Duke filluar nga mitologjia shqipe, për të vazhduar në mitologjinë perse, greke, biblike por nganjëherë edhe mitologjinë islame.

## II. Dialogu i Naimit me mitologjinë biblike

Dialogu me mitologjinë në veprimtarinë e Naimit është i dukshëm që në poezitë e para të përmbledhjes “Ëndërrime”, deri në poezitë dhe poemat e fundit. Dialog më të dukshëm me mitologjinë shohim në veprat “Qerbelaja”, “Abaz Aliu”, “Istorijsja e Skenderbeut” dhe përmbledhja “Këngë për mësonjtoret e para” Kur flitet për mitologjinë në veprimtarinë e Naimit, miti është i dukshëm kur paraqitet si figura, motive, por nuk është shumë i dukshëm, kur i njëjti paraqitet si pamje nga bota.

Figurat mitologjike në veprimtarinë e Naimit janë përdorur me kuptimin e tyre parësor, por hera herës fitojnë edhe kuptim të ri, kur kjo është paraqitur si nevojë e tekstit. Në raste më të shpeshta këto figura e luajnë rolin e vjetërsisë, që e përdëfton ecurinë historike të letërsisë.

Sipas N. Frajt, “Bibla është mit definitive, strukturë e veçantë ..e cila shkrihet nga krijimi i botës, nga Apokalisi që e përmban mitin qendror për jetën e Jezusit, nga ringjallja deri në apoteozë.” ( Bicaniq,1960 : 353)

Naim Frashëri nuk mbeti indiferent ndaj mitologjisë biblike. Nga kjo mitologji u referohet figurave markante si: Isa, Marija, Ademi, Mojsiu, Hava, por edhe figurave si engjuli, parajsja, feri etj. Në përmbledhjen “Parajsja dhe fjala Fluturake”, në poezinë “Mësim” ai duke u thirrur në këto figura si Marinë dhe Krishtin, mundohet që ta përgjithësoj mendimin moral nëpërmjet këtyre personave :

“Pse duam Krishtin` e gjallë,  
Edhe t` ëmën` e tij Marinë?  
Përse s` e duam djallë?  
Se na mëson ligësinë! ( Frashëri, 2007: 155.)

Përveç se me figurat që përdor mitin si formë intertekstuale, Një gjë të tillë e benë duke përdorur fabulën mitike në krijimtarinë e tij. Një shembull të tillë kemi në poezinë “Para Krishtit” në përmbledhjen “Lulet e Verës”, e cila mbështetet në fabulën e huazuar nga mitologjia biblike. Për Naimin, ashtu siç parashihet edhe në hipotekstin e tij në Biblën, Krishtu është i biri i Zotit i cili është i gjykuar me padrejtësi për njerzimin.

Poezia fillon me vargjet :

“ Djalëth njeriu i Perendisë  
Fytyra jote mua më tregon,  
Ah, të këqijat e njerzisë!  
Që ka punuar dhe punon! ( Frashëri, 2007: 105)

Vdekja e Krishtit ishte një padrejtësi për njerzimin. Ai përfundoi ashtu pasi nuk u gjykua në mënyrë të drejtë, por në hipotekstin e tij, ai përfundoi ashtu pasi dashurinë e bëri besim, shoqërinë ligj.

“Ti u përpoqe për njerzinë,  
Edhe dashurinë bëre besë,  
Njeriut vure nom miqësinë...  
...Se njerëzija  
Ë Perendija” ( *Ibid.*)

Femi Çakolli, në veprën e tij, “Kodi biblik”, për këtë poezi shprehet: *Derisa Pjetër Bogdani I duhej të studionte teologjinë dhe filozofinë që në fund të bëjë analogji mes Krishtit dhe krishterimit, Naim Frashëri si mendimtar, në një poezi prej 24 vargjeve do të jep një mendim poetic univerzal për Krishtin.* ( akoli, 2003: 124.)

Naim Frashëri me gjuhën e tij arriti formën më të lartësuar të stilit biblik, lutjen shpirtërore ndaj Perendisë. Ai kishte guximin që të shkruaj lutjen në gjuhën shqipe, për popullin e tij, por duke u mbështetur në bazën biblike:

“Zot i math e i vërtetë, falna udhën` e drejt` e të vërtetë, nxirna në drit` e mos na lërë n`errësirë, ona gjithë të miratë, mërgona nga të këqijat` e të paudhatë, falna miqësinë, vllazërinë, njerëzinë edhe bëna fatëbardhë në jetë? ...Falu Shqipërisë dhe shqiptarve...cdo te mire në jetë...Largoj nga të ligat...Amen. ( Frashëri, 2007: 224-251)

Kjo lutje është e lutje jashëfetare, Naimi i drejtohet Zotit të vërtetë. Deri tani asnjë autor nuk kishte guximin të shkruaj një lutje të tillë, për shqiptarët. Lutjen e përfundon me fjalën e shenjtë Amin. Kjo lutje na përkujton lutjen e Krishtit, mund të quhet edhe hipotekst, këtë lutje të paraqitur në Biblën, i cili ua mësoi apostujve, e njohur si “Zoti ynë” (Mn. 6:9-13)

### III. Dialogu i Naimit me mitologjinë islame

Naimi nuk thirrej vetëm në mitologjinë biblike por edhe në mitologjinë islame, në poemën “Qerbelaja”, respektivish në historinë e shenjtë islame. Në këtë poemë autori huazon motive nga historia islame. Qerbelaja gjindet 100 km në veriperendim të Bagdatit. Në këtë vend, në vitin 680, vdiq kushriri i profetit Muhamed, Imam Hyseni me 72 vetë. Kjo ngjarje do të mbetet e regjistruar në historinë njerzore. Në historinë njerzore ka milionë viktima, të cilët ishin të pambrojtur që genë dënuar të pafajshëm. E tillë ishte edhe vdekja e Imam Hysenit, të cilën vdekje e kishte parashikuar edhe i dërguari Muhamed.

Që në fillim të poemës kemi një thirrje për ndihmë nga Perendia, për realizimin e kësaj poeme. Ai shprehet, që do të këndojë për këtë ngjarje tragjike. Që në fillim lexuesit i bëhet e njohur referenca për lidhjen intertekstuale të kësaj poeme me historinë islame.

„Urdhëro, Zot i vërtetë!...  
...Do të këndoj urtësinë,  
E do ta rrëfenjë Alinë,...  
...Po ta them dhe Qerbelanë“ ( Frashëri, 2007:13)

Figura mitologjike e Imam Hysenit është simbol i të vertetës, për të cilën do të vdes bashkë me 72 shokë. Naimi shprehet:

Shtatëdhjet` e dy shpirtë qenë,  
Bashkë me Imam-Hysenë,  
Me shtatëdhjet` e dy vetë,  
Armikë mijë tridhjetë. “ ( *Ibid.*, f. 162.)

Fundi i tij përshkruhet si në vijim:

“ Mundi djalli Perendinë,  
Ligësija mirësinë,  
Jeziti Imam-Hysenë...  
...Po jo, s`mundet Perendija...  
...E vërteta është e vërtetë.( *Ibid.*, f. 184.)

Naimi vazhdon duke thënë se:

“ Imam-Hysejni `shtë vrarë  
U vra për nderë të njeriut.” ( *Ibid.*, f. 186-187.)

Kur Muhamedi e parashikoi vdekjen e tij, kjo i goditi të gjithë thellë në zemër, derisa një grua filloi të qajë, pasi atëherë nuk do të jetë gjallë asnjë nga të afermit e tij, që të vajtoj për Imam Hysenin. “ Një zë iu përgjigj”, “mos vuaj grua e mirë, për këtë vdekje do të vajtojtohet çdo vit derisa të shkatrohet bota!” Një histori e njohur ku thirret Naimi, që njerëzit ta përkujtojnë Qerbelanë, që të mundet Imam Hyseni të jetojë përgjithmonë:

“ Bini nër mend Qerbelanë,  
Ç`hoqën zotrinjtë tanë“( *Ibid.*, f. 187.)

Naimi shprehet:

“ Imam Hysen edhe sonte  
Rron si aherë kur rronte“( *Ibid.*, f.185.)

“Kryqëzimi dhe Qerbelaja u përjetuan si drama në metahistori. Jehona e kësaj drame metahistorike i kthehet historisë dhe kjo kushtimisht çdo vit ushton nga jehona e kthyer.”, thotë Eqrem Kryeziu, në Metafizikën e tijj (1998: 53). „

## Përfundim

Intertekstualiteti ka bërë një revolucion në kritikën letrare. Është mënyrë e re e analizë se veprave letrare, duke i parë në një kënvështrim të ndryshëm, veprat letrare. Duke filluar nga kjo, interteksti nënkupton prezencën e një teksti në një tekst tjetër. Teksti, i ri në këtë punim ishte miti. Me njohjen e mitit u mundësua një vështrim i ri, duke i dhënë njëkohësisht lexuesit kënaqësinë e zbulimit të këtyre pikave paralele. Miti si intertekst, në rastin konkret është pjesë e poezisë, qa sipas Jakobsonit ato sa janë të afërta aq edhe kundërshtohen. Poashtu, analiza

përfshinë autor të periudhës së romantizmit, ku miti paraqitet si pjesë e kësaj periudhe ku mbizotron fantazia. Mitet që përdor Naimi, në poezitë e tij janë nga mitologji të ndryshme, duke filluar nga mitologjia shqipe, për të vazhduar, në mitologjinë islame. Kjo mënyrë e rishkrimit të një teksti në një tekst të ri, mundësoi revolucion në kritikën letrare në përgjithësi.

## Bibliografia

- Aliu, A.** (1990) *Kërkime Studime, kritika, ese*, Tiranë, Naim Frashëri.
- Bisanić, S.** (1970) *N.Fraj kako mitski i ahetijski kritičar*, Zagreb, Umjetnost reči.
- Bibla**, (1997) Shoqata shqipëtare e Biblës, Tiranë.
- Bulo, J.** (1999) *Tipilogjia e lirikës së Naim Frasherit*, Tiranë, ASHRSH.
- Çakolli, F.** (2003) *Kodi Biblik në letërsinë shqiptare 1462-1947*, Prishtinë, Tenda.
- Fraj, N.** (1990), *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë.
- Frashëri, N.** (2007), *Vepra I-VI*. Përgatitur nga Rexhep Qosja dhe Jorgo Bulo. Tiranë, Toena.
- Frashëri, N.** (2000), *100 vjet pas*, Konferencë shkencore, Prishtinë.
- Gennete, G.** (1982) *Pamlimpsestes* (la littearture au secondiemedegree), Paris.
- Izet, M.** (2004), *Kllapia e tezaëufit*, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup.
- Kaller, Xh.** (2001), *Teori letrare*, Prishtinë, Era.
- Korça, A. H.** (2000), *Fyelli dhe disa kujtime*, Tiranë, Ribotuar në "Naimit".
- Korbin, H.** (1997), *Histori e filozofisë islame*, Shkup.
- Krifca-Beqiri, M.** (2003), *Intertekstualiteti në poezinë shqipe mes dy luftërave*, Shkup, Fakti.
- Kryeziu, E.** (1998), *Metafizika e Naimit*, Prizren Dardania, Prizren.
- Loshi, Xh.** (2000), *Vështrime stilistike*, Tiranë.
- Кулавова, К.** (2003), *Теорија на интертекстуалноста*, Скопје, Култура.
- Eliot, Th. S.** (2005) *Tradita dhe talenti individual*. Prishtinë, Cituar sipas Anton Nikë Berishës "Çështje teorike të letërsisë", shtëpia botuese "Faik Konica".
- Uçi, A.** (1982), *Mitologjia, folklori, letërsia*, Tiranë, Naim Frashëri.
- Shehabi- Veseli, M.** (2009), *Dialogu letrar i Naimit me letërsinë orjentale*, Tezë magjistrature, Fakulteti Blazhe Koneski, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, Shkup.
- Xheladin, R. M.** (2007), *Mesnevi I-VI*, shqipëruar nga persishtja Mitat Hoxha Shkup, Logos-A.
- Xhiku, A.** (2004), *Letërsia shqipe si polifoni*, Dituria.

## T.S.Eliot –Një shembull modernisti i konceptimit të poezisë

### Manjola Nasi

Universiteti i Tiranës,

Tiranë, Shqipëri

[manjola\\_nasi@yahoo.com](mailto:manjola_nasi@yahoo.com)

Tomas Sterns Elioti konsiderohet si një ndër poetët më të mëdhenj të shekullit të njëzetë, të modernizmit, por edhe të gjitha kohërave. Vepra e tij poetike eksperimentoi në mënyrë të suksesshme dhe mbresëlënëse në një sërë rrafshesh. Në këtë mënyrë, Elioti arriti të ndikonte shumë autorë të brezit të tij, por edhe artistë të ardhshëm, si në letërsi, ashtu edhe në fusha të tjera të artit, sidomos në muzikë dhe pikturë.

Përveç poezive të tij, ndikim të rëndësishëm mbi lëvizjen moderniste dhe shijen e publikut të gjerë patën edhe esetë dhe artikujt e tij për vepra e autorë të ndryshëm, dhe gjithkaj edhe për natyrën e poezisë, atë që ajo duhet të jetë, synimet, tematikën dhe formën e saj. Këto të fundit, duke shërbyer si bazë jo vetëm në trajtimin e koncepteve, por shpeshherë edhe në mënyrat si lexoheshin vetë poezitë e Eliotit, mbeten me interes edhe në këndvështrimin e shekullit të njëzetënjëtë.

Në këtë kumtesë, mendimet e parashtruara në esetë e Eliotit trajtohen të shkrira me veprën e tij poetike, duke vërejtur përputhjet mes tyre, për të paraqitur sa më qartë konceptin e Eliotit për poezinë dhe elementet përbërëse të saj, në mënyrë që të mund të ofrohet një panoramë sa më e qartë për arsyet pse ky konceptim arriti të kishte ndikim kaq të gjerë në teorinë dhe kritikën letrare.

Një ndër elementet kryesore që duhen trajtuar sa herë që flitet për idetë e Eliotit në lidhje me atë që përfaqëson poezia, ka të bëjë me marrëdhënien autor – vepër – lexues. Dihet që pesha që i caktohet secilës prej këtyre faktorëve përbërës të kësaj skeme, është jo rrallë parimi që ndan teoritë kritike dhe të teorisë së letërsisë në një larmi lëvizjesh e shkollash. Kështu, në parathënien e përmbledhjes me ese “Funksioni i poezisë dhe funksioni i kritikës”, Elioti shprehet:

Ekzistenca e poemës është diku mes shkrimtarit dhe lexuesit; ajo ka një realitet që nuk është thjesht realiteti i asaj që shkrimtari përpiqet të “shprehë”, ose i përjetimit të tij duke e shkruar atë, ose i përjetimit të lexuesit, të shkrimtarit si lexues. (Eliot, 1964: 30)

Ky pohim, përmbledh në vetvete dy pikëpamje të rëndësishme, të cilat zhvillohen më tej në të tjera shkrime: e para ka të bëjë me mëvetësinë e poezisë nga shkrimtari dhe lexuesi, dhe e dyta, me përfshirjen e emocioneve vetjake të shkrimtarit në krijimin artistik. Në thelb, ajo që del në pah në esetë e Eliotit, është këmbëngulja e tij për të shkëputur veprën nga autori i saj, autorin nga personazhet që ai krijon dhe jetët e këtyre të fundit nga faktet jetësore të shkrimtarit apo poetit.

Një gjë e tillë vlente në dy rrafshje: i pari, sipas të cilit “Kritika e ndershme dhe vlerësimi i drejtë nuk përqendrohet te poeti, por te poezia” (Eliot, 1932: 17), kishte të bënte me mënyrën si duhet të lexohet vepra, se si ajo që kërkohet dhe merret prej saj duhet të mos jetë e varur nga dija apo padija për jetën e autorit dhe për atë si individ, duke i parashtruar poezisë mundësinë, por

edhe sfidën, që ta ushtrojë efektin e saj pa këtë pengesë a mbështetje. Në trinomin autor – vepër – lexues, vepra ishte përbërësi më thelbësor.

E dyta, edhe më e rëndësishme, për faktin se Elioti këmbëngul më fort në të, lidhet me vullnetin e autorit për të shprehur emocionet e tij në vepër, gjë që ai e shihte si tejet të nevojshme për cilësinë e kësaj të fundit. Siç shprehet duke analizuar këtë çështje, mundësia që autori ta përfshijë atë që ndjen dhe mendon ose përjeton dhe që është subjektive, ekziston vetëm kur ky i fundit arrin ta shndërron përjetimin e vet në një simbol të përgjithshëm, i cili merr trajtë universale, pasi arrin të lexohet e të sjellë të lexuesi atë kapsulë ndjenjash e mendimesh që nevojitet për shijimin e poezisë. Parimi i impersonalitetit, termi që ai përdor, nuk e zhvesh çdo element të vetjakes nga vepra, por lejon në të vetëm ato elemente që kanë arritur të përkthehen në një gjuhë të lexueshme nga të gjithë, jo ato që e teprojnë përvetësimin e kufijve të veprës në favor të shfrimit të inflacionit të ndjenjave të autorit, siç ndodhte në poezitë me nota të theksuara sentimentale.

Zgjidhja që Elioti propozon për të vlerësuar mundësinë e përfshirjes apo mospërfshirjes në vepër të emocionit të autorit, ose të emocionit si njësi e përgjithshme, është bashkëlidhësi objektiv, i cili, sipas përkufizimit të tij, është:

“E vetmja mënyrë për të shprehur emocionin në art [...] një grup objektesh, një situatë, një sërë ngjarjesh që të jenë formula e atij emocioni të caktuar, në mënyrë që kur të paraqiten faktet e jashtme, që duhet të përfundojnë në përjetim shqisor, emocionin të ngjallet menjëherë”. (Eliot, 1932: 145)

Bashkëlidhësi objektiv, i mbiqajtur nga kritikët si “varianti [eliotian] i simbolit të simbolistëve” (Beasley, 2007: 33, Miller, 2006: 127 -131), është, sipas konceptit të Eliotit, një njësi e pandashme mendimi dhe ndjenje, e cila ngjallet jo falë përmendjes emërtuese të ndjenjave që duhet të ngjallë, por duke paraqitur elementet e nevojshme për ta krijuar atë ndjenjë të caktuar dhe për ta përgatitur mendjen e lexuesit për mendimin e synuar.

Konkretizimi që përmbush bashkëlidhësi objektiv nuk e përjashton përfundimisht subjektiven, as nuk e bën objektiven një standard që duhet marrë i mirëqenë në çdo çast, por krijon një lidhje funksionale mes të dyjave, në saje të së cilës ato mund të jenë të pranishme në vepër. Të tillë e përshkruan Elioti motivimin artistik “që qëndron te vendosja e plotë e së jashtmes në shërbim të emocionit”. (Eliot, 1932: 145)

Kjo e jashtme nuk ka të bëjë gjithmonë me objekte fizike (Matthiessen, 1958: 58). Detaji i përzgjedhur për të paraqitur gjendjen e caktuar shpirtërore dhe mendore mund të jetë i çfarëdollojshëm dhe lidhja objektive që ai vendos me përmbajtjen mund të jetë e drejtpërdrejtë ose tërësisht e varur nga kombinimet me detaje të tjera. Tejçimi i emocionit nga njëra kategori te tjetra është qëllimi që duhet realizuar me çdo kusht, jo duke folur vazhdimisht për të dhe duke deklaruar me gojën e personazheve se përjetohej aksh emocion a gjendje shpirtërore, po duke krijuar mbështjellën e përshtatshme për ta bërë atë të lexueshëm pa pasur nevojë të përmendet, ose në rast se përmendet, pesha shpjeguese të mos bjerë mbi të, po mbi të gjitha detajet e përdorura. Një teknikë e tillë krijon terren të përshtatshëm për impersonalitetin poetik dhe për tërheqjen e autorit nga pozicioni i të gjithë diturit. Nga ana tjetër, monologu dramatik që përdorte aq shpesh Elioti, do të dëmtohej nga nevoja e një shpjegimi të mbivendosur të autorit apo rrëfimitarit.

Le të marrim, për shembull, rastin kur ky mjet përdoret në vargjet 19 – 30, te pjesa “Varrimi i të vdekurit”, “Toka e Shkretë”:

Çfarë rrënjësh ngërthehen, ç’degë rriten  
Në këtë zall të shkretë? Bir njeriu,  
Ti s’e di, s’e gjen dot, ti njeh vetëm  
Një pirq copërash imazhesh, ku dielli djeg,  
Pema e tharë nuk bën hije, gjinkalla nuk të çlodh,  
Gur’ i zhuritur s’ka zhurma uji. Hijë  
Ka vetëm nën këtë shkëmb të kuq,  
(Eja nën hijen e shkëmbit të kuq),  
Të të dëftoj diçka që s’ngjan fare  
Me hijen tënde të mëngjesit që rend me mund pas teje  
Dhe hijen tënde në mbrëmje, që rend të të takojë;  
Të të tregoj frikën në një grusht me pluhur.

Këto janë vargjet e para te “Toka e Shkretë”, ku flitet për mungesën e ujit dhe shterpësinë. Përshkrimi me anë të imazheve plotësohet nga detaje ndjesore të shqisave të tjera: ndjesia e vapës, zhurma e gjinkallës dhe e ujit. Pyetjet që bëhen në vargjet e para të këtij fragmenti e forcojnë ndjesinë e pafuqisë që ndihet në mes të zhegut. Hija e shkëmbit të kuq nuk përpiqet të prekë askënd, ndryshe nga hija e njeriut ajo është e pajetë dhe mospërfillëse ndaj jetës dhe gjallesave. Natyra (ndryshe nga zoti, ndryshe nga shoqëria funksionale njerëzore) nuk e merr njeriun parasysht në verbërinë e saj dhe në mungesën e një ndërgjegjeje që ka një plan [hyjnor] për të zbatuar. Ciklet e saj mund të ndryshojnë e ta bëjnë të papërshtatshme vazhdimësinë e jetës, njësoj si në këtë gurishte të pa bimë. Frika dhe braktisja janë të pranishme qysh në fillim të pasazhit, po efekti i tyre i plotë bëhet i qartë vetëm në fund, kur pluhuri sjell jehonën e vdekjes. Shkretia dhe përvëlimi i vargjeve të para kalon nga natyra, te njeriu, nga gjëra të huaja e të parëndësishme, te thelbi i ekzistencës. Komunikimi në vetën e dytë e bën më të ndjeshëm emocionin e frikës dhe ndjesinë e një rreziku të mundshëm. Vëmendja vjen duke u përqendruar ngadalë te vetja, ndërkohë që në vargjet e para duket sikur pyetjet janë të parëndësishme e s’kanë asnjë lidhje me qeniet njerëzore.

Edhe përmendja e dijeve të kufizuara njerëzore është elementi tjetër që i tregon “birin të njeriut” se sado që ai qëndron në qendër të botës së tij vetjake, mbi universin nuk ka kurrfarë fuqie, është i vogël dhe i papërfillshëm. Për më tepër, vetë fakti që thërritet “bir njeriu” është faktor depersonalizues. Mungesa e emrit të përveçëm e shkrin atë me cilindo njeri tjetër dhe nuk e sheh si një individ me vullnet të lirë, po si një *produkt*.

Një parashtrim i tillë rrethanash, e bën njeriun të mendojë për vdekjen në mënyrë thaujse automatike. Me pak fjalë, ky fragment thotë: Ti, pjellë e çfarëdoshme njerëzish, nuk di asgjë. Ti shikon që natyra po vdes, përse mendon se ti vetë do të shpëtosh?

Materializimi i frikës në këtë rast është i përzier me pafuqinë për t’i shpëtuar rrezikut, me plogështinë fizike të një dite me diell të fortë dhe me vështirësinë e frymëmarrjes që të krijon vapa. Për këtë arsye, ky bashkëlidhës objektiv e përmban mendimin dhe ndjenjën njësoj siç do ta përmbante shprehja e drejtpërdrejtë, po ngarkesa emocionale nuk mbërrin te lexuesi e zberthyer nga shpjegimi i autorit. Lexuesi ka mundësinë të bëhet pjesë e mirëfilltë e përjetimit të emocionit që sjell vepra, duke ndier tërësinë e përbërësve me shqisat dhe mendjen e tij. Edhe nëse e veçojmë nga elementet e tjera poetike, forca emocionale e pasazhit të mësipërm nuk mund të jetë

kurrsesi e njëjtë nëse do të thuhej: “kam frikë, ndiej pafuqi, s’kam shpresë, po plogështohem, kam vapë, ndiej ankth”. Kjo tregon se bashkëlidhësi objektiv jo vetëm që gjen një mënyrë shprehjeje poetike që përputhet me parimet estetike të Eliotit, por se ai është mjet më i efektshëm për të arritur paraqitjen artistike të emocioneve seç do të ishte përmendja e drejtpërdrejtë e tyre.

Që poezia të jetë e arrirë dhe të mund të funksionojë si njësi e mëvetësishme, mes përbërësve të saj të ndryshëm duhet të ekzistojë një drejtpeshim sa më i harmonishëm. Roli i veçantë i secilit përbërës është padyshim i rëndësishëm, por ndërveprimi me elementet e tjera e vendos atë në një pozicion tërësisht të ndërruar. Mbi këtë parim mbështetet jo vetëm ndarja dhe njësimi i ndjeshmërisë. Në thelb, ky parim qeveris të gjitha konceptet e Eliotit në lidhje me rimën, formën, përmbajtjen, strukturën, tematikën dhe gjithçka tjetër specifike.

Vlen të vërehet se ai mishërohet te ideja e paralelizmave me muzikën, një nocion që Elioti e zhvillon në një sërë esesh, dhe që mbështetet qartësisht edhe në poezitë e tij. Ai shprehet se muzika e poezisë “nuk është çështje [që trajtohet] varg pas vargu, por e gjithë poemës”, (Eliot, 2009: 30) duke i dhënë asaj në këtë mënyrë funksion strukturë ndërtues. Nga muzika, poezia mund të mësojë ndjenjën e ritmit, e cila e kapërcen rimën dhe është dukshëm më e pashmangshme se ajo. Përtej organizimit thjesht tingullor të poezisë, ritmi ngacmon mendjen njerëzore përtej kuptimit të vetëdijshëm.

Poeti me “imagjinatë dëgjimore” të zhvilluar arrin ta gjejë mënyrën se si tërësia e organizimit formal dhe ritmik tingullor bashkëvepron me kuptimin për të dhënë një përbërje organike që do të arrinte efektin e dëshiruar. Për këtë arsye, dhe në emër të përlllogaritjes së kujdesshme të efektit, Elioti e kundërshton me forcë termin “varg i lirë”, i cili shihet prej tij si një lloj shkujesjeje dhe si moskëqyrje deri në fund i mundësive të forcës së këtij mjeti. (Eliot, Kermodë, 1975: 35)

Kundërshtimi i Eliotit ndaj vargut të lirë u drejtohet më me forcë atyre poetëve e mendimtarëve që këmbëngulin në përdorimin apriori të tij, për vetë mungesën e kufizimeve që ai pre supozon. Argumentet e Eliotit janë të thjeshta: ai mendon se ata që e predikojnë përdorimin e vargut të lirë, e bëjnë një gjë të tillë për arsyet e gabuara. Mungesa e skemës, rimës dhe masës që janë karakteristike për vargun e lirë, e kufizojnë fuqinë e tij shprehëse dhe strukturorë. Argumenti se vargu i lirë shihet si i parapëlqyer nga poetë të ndryshëm për shkak të lirisë që ofron, has në kundërshtimin e prerë të Eliotit: “Në art, nuk ka liri.” (Eliot, Kermodë, 1975: 32) Liria së cilës ai i kundërvihet me kaq forcë ka të bëjë me paaftësinë e poetëve për ta kuptuar se si duhet të luajnë me modelet e mundshme. (Eliot, Kermodë, 1975: 31 - 36)

Në këtë mes, qëndrimi radikal nuk është i Eliotit, por i atyre që këmbëngulin te vargu i lirë. Tendencat për të arritur të rene me çdo kusht, kufizon mundësinë e përfitimit nga forma të njohura e të pranuar. Shtysa të tilla janë fajtoare për perceptimin fillestar të modernizmit si një lëvizje ku rregulli dhe vetëpërmbajtja e artistit nuk ekzistonte. Poeti që nuk e njej metrikën nuk mund të këmbëngulë se po çlirohet prej saj. Paradoksi në këtë mes është se në vend që të përftohet më shumë liri, vetë fanatizmi për një lloj të caktuar vargu, sigurisht duke përfshirë këtu edhe vargun e lirë, e zvogëlon mundësinë e zgjedhjeve artistike që i shtrohen përpara poetit.

Poezitë e Eliotit ofrojnë shembuj të shumëllojshëm vargësh, për nga gjatësia, ritmi, rima ose mungesa e saj. Është tejet e zakonshme që të gjitha këto variacione të ndodhin edhe brenda së njëjtës poezi, gjithmonë në emër të ekzistencës së një skeme të përgjithshme, ku polifonia e krijuar me to, si dhe me elementet e dendura ndërtekstore, aluzionet dhe fragmentimin e theksuar

prodhon një muzikë të caktuar në çdo rast. E njëjta shumëllojshmëri dhe çlirim nga komplekset shfaqet edhe në konceptimin e tij të strukturës. Kështu, ai shprehet, duke pohuar idetë e Ezra Poundit:

“Kur poeti ka lëndën e duhur për një sonet, atëherë duhet të përdorë formën e sonetit; por poetit i ndodh shumë rrallë të ketë në duar pikërisht atë lëndë që mund të shndërrohet në mënyrë të përkryer në sonet.” (Eliot, 2004: 9)

Edhe ky pohim mbron parimin e rëndësishëm të përputhjes mes formës dhe përmbajtjes, duke i dhënë atij përparësi madje edhe ndaj dëshirës për risi dhe eksperimentim. Elioti nuk ishte i vetmi që e shihte strukturën si të së njëjtës rëndësi me pjesët e tjera. Barasvlefshmëria e formës dhe përmbajtjes është tipar i modernizmit në përgjithësi. Por nëse merita për këtë koncept nuk mund të shihet si (tërësisht) e tij, merita për strukturat e mrekullueshme e të ndërlikuara që krijoi dhe mënyra se si ato përputhen me përmbajtjen sipas këtij parimi, mbart vulën e padiskutueshme të origjinalitetit të Eliotit.

Përsiatjet metafizike për kohën dhe natyrën e ekzistencës të “Katër kuartete” parashtrohen me strukturën e ndërlikuar, thuajse plotësisht të rregullt dhe ciklike të poemës. Vuajtjet, humbja e shpresës, paaftësia për të hyrë në marrëdhënie të shëndetshme njerëzore të “Toka e Shkretë” mbështillen nga përshtjellimi dhe fragmentimi strukturor, kohor e burimor, duke shkaktuar copëzim të logjikës dhe perceptimit kohor e hapësinor, duke kontribuar kështu në krijimin e gjendjes së çoroditjes, pasigurisë dhe përhumbjes, e cila karakterizon poemën dhe që përputhet në mënyrë të përkryer me temën e saj.

Në të njëjtën mënyrë, kjo pohon një përputhje të një lloji tjetër, që u parashtrua në fillim të kësaj kumtese, atë mes ideve teorike dhe kritike të Eliotit dhe praktikës së tij krijuese teorike. Një ndër përfundimet e qarta në këtë pikë, është se mbi gjithçka, Elioti këmbëngulte te harmonia dhe te përlllogaritja e kujdesshme e efektit të çdo elementi. Poezitë e jashtëzakonshme që ai shkroi janë shembull i qartë i fuqisë mbresëlënëse që mund t'i jepet artit të fjalës falë këtij parimi; për këtë, ky shembull vlen të mbahet parasysh nga ata që synojnë të krijojnë poezi dhe të shijojnë leximin e tyre.

## **Bibliografia**

- Beasley, R. (2007) *Theorists of modernist poetry: T. S. Eliot, T.E. Hulme, Ezra Pound*, London: Routledge.
- Eliot, T. S. (2004) *Ezra Pound: his metric and poetry*, Whitefish, Montana: Kessinger Publishing.
- Eliot, T. S. (2009) *On poetry and poets*, New York: Farrar, Straus & Giroux.
- Eliot, T. S. (1932) *Selected essays*, London: Faber & Faber.
- Eliot, T. S. Kermodé, F. (ed.) (1975) *Selected prose of T. S. Eliot*, Orlando, Florida: Harcourt Incorporation.
- Eliot, T. S. (1964) *The use of poetry and the use of criticism*, London: Faber & Faber.
- Matthiessen, F. O. (1958) *The achievement of T. S. Eliot; an essay on the nature of poetry*, New York: Oxford University Press.
- Miller, M. A. (2006) *Masterpieces of British modernist*, Westport: Greenwood Press

## Pinoku shqiptar i Cuk Simonit

**Manjola Sulaj**

“Eqrem Çabej”,

Gjirokastër, Shqipëri

[sulaj\\_manjola@yahoo.it](mailto:sulaj_manjola@yahoo.it)

### Hyrje

Romani “*Pinoku*”, i shkruarit të shquar për fëmijë Carlo Collodi, një nga librat më të famshëm jo vetëm të letërsisë italiane por edhe asaj botërore, botuar për herë të parë në gjuhën shqipe më 1935, është përkthyer nga Cuk Simoni. Përkthimet dhe reflektimet teorike që shoqërojnë veprat letrare kanë një rol të rëndësishëm në historinë e kulturës së çdo vendi sepse ato favorizojnë zhvillimin e letërsive kombëtare, duke sjellë modele të reja në sistemin e kulturës në të cilën futen. Përkthimi konsiderohet si një akt, që jo vetëm lejon të tejkalohen barrierat gjuhësore, por edhe të njihet diçka ndryshe, duke lejuar komunikimin dhe qarkullimin e kulturave. Në këtë kontekst përkthimi në shqip i “*Pinokut*” ka rëndësi të madhe sepse vjen në Shqipëri, në periudhën midis dy luftërave botërore, kur përkthimi në shqip i librave për fëmijë zë një vend të rëndësishëm qoftë duke mbushur, në një farë mënyre, hendekun e krijuar nga mungesa e librave origjinalë për fëmijë, siç pranon Astrit Bishqemi, qoftë në shtypjen ose në modelin që i ofron letërsisë shqipe për fëmijë për t’u shkëputur nga tekstet shkollore dhe për të krijuar mëvetësinë. “*Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj*” regjistron një numër të konsiderueshëm librash për fëmijë të përkthyer midis dy luftërave botërore. Le të përmendim disa syresh: “*Përralla të zgjedhura nga të vjershëtorit të madh La Fonten*” (1921), të përshtatura nga Çajupi; “*Në hijen e hurmave*” (1924), përralla arabe përkthyer nga anglishtja nga Faik Konica; “*Robinson Kruzo*” i Daniel Defoe-s, që botohet me dy përkthime (1934 dhe 1936) nga Dhori Koti dhe Gjergj Pekmezi etj. Nga letërsia italiane për fëmijë përmendim: romani “*Zemra*” i E. De Amicis-it, që njih tre botime midis dy luftërave botërore përkatsisht në 1923, 1932 dhe 1938; novela “*Kikibio dhe Shapatorja me një këmbë*” (1933) e G. Boccaccio-s, botuar në revistën “*Vatra e Rinisë*”; novela “*Princi i çuditshëm i shkretinës*” (1933-1934) i A. Cipolla-s, e cila botohet me vazhdim në dhjetëra numra të revistës “*Vatrës së Rinisë*”; “*Pinoku*” 1935 i C. Collodi-t, përkthyer nga Cuk Simoni, Shkodër, Botim i përkthyesit rr. Gurakuqit 40.

Edhe pse “*Pinoku*” është i njëkohshëm me romanin “*Zemër*” të shkruarit De Amicis, për të mos thënë ca vite më i vjetër, ai vjen në shqip 12 vjet më vonë. Kjo na bën të mendojmë se tendenca deamiciçisiane, ashtu si në Itali, kishte pasur një ndikim më të madh edhe tek intelektualët shqiptarë në fillimin e shekullit të shkuar. Jo vetëm kaq, por edhe gjatë periudhës së Regjimit Komunist, duket qartë preferenca për romanin e De Amicis-it. Po t’i hedhim një sy kurbës së ribotimeve të dy romaneve në shqip, do të shohim se romani “*Zemër*” ribotohet tri herë të tjera deri në vitet ’90, (1957, 1964, 1977,) kurse “*Pinoku*” vjen vetëm një herë përgjatë të njëjtës periudhë (1959). Kjo i detyrohet faktit se në kohën e monizmit, në faqet e romanit “*Zemër*”, përpos të tjerash, shikohej një dëshirë e zjarrtë për të armatosur fëmijët me virtyte të larta kundër ndikimit helmatues dhe egoizmit shtazarak të shoqërisë borgjeze. Vetëm pas viteve ’90 “*Pinoku*” njih një numër të madh përkthimesh dhe përshtatjesh duke u ribotuar në vitet: 1994, 2000, 2004, 2006.

## Jehona e *Pinokut* në shtypin e kohës

Përkthimi në shqip i romanit "*Pinoku*" shoqërohet në shtypin e kohës nga recensione dhe nga artikuj kritikë që vlerësonin si veprën dhe autorin e saj ashtu edhe talentin e përkthyesit shqiptar. Libri u prit mirë nga lexuesi dhe kritika që me entuziazëm e vlerësoi pozitivisht duke mos lënë mënjanë edhe vlerat e përkthimit.

Karl Gurakuqi në faqet e "*Illyria-s*" (nr. 21, 7 shtator 1935) ka bërë një recension të përkthimit. Pasi vlerëson librin e "*Pinokut*" si një *shoq i pa-ndam i kalamanit italian* dhe autorin e tij Carlo Collodi-n si *njofjës të thellë të shpirtit të fmivet*, ai ndalet tek përkthyesi Cuk Simoni duke e vlerësuar si *nji shkrimtar qi punon pa bujë e pa tantame, nën dy gërmat C. S.* Nuk mungojnë padyshim në këtë shkrim edhe vlerësimi pozitiv për përkthimin : *C. S. në përkthimin e librit "Pinocchio" ka treguem cilsu të rralla të nji shkrimtari të mirë, njoftës i hollë i gjuhës shqipe. Për të përkthym si duhet, asht e domosdoshme të nji fjet mirë gjuha nga e cila përkthehet, por të dihet me rrajë edhe ajo në të cilën bahet përkthimi.*

Në revistën "*Leka*" (nr. 9, shtator 1935) gjejmë në rubrikën e përshtypjeve një shkrim të shkurtër nga Zalvi (Giuseppe Valentini) ku autori vlerëson si punimin letrar edhe veprën e *hieshme të përkthyesit* e cila sjell në shqip një *pasuni gjuhe e shprehjesh si n'original.*

Anton Logoreci me një shkrim të shkurtër, prej tre paragrafësh, paraprin botimin ("*Illyria*", nr. 23, 21 shtator 1935) e parathënies së librit "*Pinoku*" shkruar nga vetë Cuk Simonit. Ai tërheq vëmendjen e lexuesit drejt parathënies që shoqëron librin, që sipas tij nuk është një parathënie e kotë apo formale por *nji revelacion.... një prozë e zhdërvjellët, e qartë dhe e thjeshtë përmjheri*, ndërsa Cuk Simonin e quan një talent. Duke përfunduar, autori i këtij shkrimi, shton se *letrat arbnore presin kontributin t'uej të çmueshëm, z. C. S.*

Në nr. 24 të datës 28 shtator 1935 të gazetës "*Illyria*" gjejmë një artikull të titulluar "*Letër e hapun përkthyesit të "Pinokut"* shkruar nga Dom Lazër Shantoja. Në artikull, ku gjithashtu nuk mungon trilli artistik, përgëzohet autori që i mësoi Pinokut edhe gjuhën shqipe dhe vlerësohet përkthimi i Cuk Simonit.

Tek "*Hylli i dritës*" (nr. 9, 1935) botohet një tjetër shkrim nga Gjush Sheldia, i cili pasi përgëzon punën e mirë të "*Vatrës së Rinisë*", si e vetmja që i dedikohet fëmijëve, e cilëson veprën "*Pinoku*" të C. Collodi-t si edukatore dhe gaztore. Ai nënvizon suksesin e veprës që sipas tij kishte njohur deri në atë kohë më shumë se 700 botime. Autori i shkrimit nënvijëzon gjithashtu vështirësinë e përkthimit i cili karakterizohet nga një gjuhë e pastër, stil i lehtë e i rrjedhshëm dhe një besnikëri ndaj origjinalit.

## Vlerat dhe modalitetet e përkthimit

Libri "*Pinoku*" shoqërohet nga një parathënie e vetë përkthyesit. Në të tregohet se si rastësisht, kur autori i përkthimit gjendej në Itali, pasi kishte mbaruar punët e tij, duke u endur nëpër vitrinat e dyqaneve shikon *Pinokun*. Kjo parathënie ka formën e një tregimi artistik të pasur me figuracion dhe imagjinatë që i përshtaten botës fëmijënore e në të njëjtën kohë është në harmoni të plotë me rrefimtarinë që e ndjek. Përkthyesi e ka të qartë botën e ndryshme të të vegjëlvë dhe këtë e vë në dukje që në parathënie duke përdorur një gjuhë specifike dhe të thjeshtë, të rrjedhshme dhe lehtësisht të kuptueshme. Ky tregim-parathënie është i pasur me dialogje të autorit me Pinokun, përshtypje për librin, të cilin padyshim që përkthyesi e njihnte më parë, dhe sigurinë se ai do të mirëprejete edhe në Shqipëri si në shumë vende të tjera të botës ku ishte përkthyer deri në atë kohë.

Cuk Simoni ishte i ndërgjegjshëm dhe e pranon hapur faktin se t'i mësoje shqipen Pinokut do të ishte një ndërmarrje e vështirë sepse, siç thotë vetë ai, “*nuk ishte i degës*”, megjithatë meqë nuk gjeti “*ndonjë tjetër që merrej me këto punë*” dhe meqë e kishte shumë për zemër *Pinokun* nuk mund ta linte mënjandë, ndaj vendosi t'i mësonte gjuhën letrare, “*një gjuhë e punuar, e holluar*” siç e quan ai, por duke parë se fëmijët nuk e kuptonin në gjuhën letrare e solli Pinokun me “*gjuhën që flitej*” pra në gjuhën shkodrane.

Tashmë është i njohur fakti se përkthimi nuk është një akt i pastër kalimi nga një kod në tjetrin. Distanca kulturore dhe gjuhësore midis tekstit origjinal dhe tekstit të përkthyer sjell gjatë procesit të përkthimit vështirësi dhe e detyron përkthyesin të bëjë disa zgjedhje arbitare. Pinoku i Cuk Simonit është më shumë se një kalim nga një gjuhë në tjetrën, është më shumë se një strukturim i thjeshtë i fjalive dhe fjalëve bazuar besnikërisht në tekstin origjinal. Teksti i tij anon nga rishkrimi. Në vijim po sjellim disa arsye që na çojnë në këtë përfundim.

Në origjinal titulli i romanit është “*Aventurat e Pinokut*” (“*Le avventure di Pinocchio*”) ndërsa Cuk Simoni vendos ta titullojë librin e përkthyer në shqip “*Pinoku*”. Kjo zgjedhje e vë theksin më shumë tek fëmija-kukull sesa tek aventurat e tij. Emri *Pinocchio* është rishkruar sipas grafemave të alfabetit të shqipes *Pinoku*, në mënyrë që të ruhet shqiptimi ashtu siç është në italisht, duke zëvendësuar grupet e shkronjave –cch- me shkronjën k.

Për shkak të ndryshimeve midis alfabetit shqiptar dhe atij Italian, përkthyesi ka bërë disa ndërhyrje përshtatëse, të pranishme në gjithë shtrirjen e librit. Emrat e përveçëm i nënshtrohen jo vetëm ligjeve të fonetikës së gjuhës shqipe por edhe ndryshimeve morfologjike, sipas fleksionit të gjinisë dhe numrit por edhe të rasave.

Emrat e përveçëm, që i janë nënshtuar fleksionit morfologjik dhe fonetiko-grafik mund të ndahen në:

1. emra që respektojnë tingëllimin italian si: Pinoku (Pinocchio), Pulçinela (Pulcinella), Arlekini (Arlecchino) etj.;
2. emra që i përshtaten kuptimisht emrave të personazheve në variantin italian si: Cigliegja në shqip Qershia, Mangiafoco në shqip Zjarmngranësi etj.
3. Emra që përshtaten në shqip, sipas zonave ku përdoren, si master’Antonio i përkthyer sipas dialektit verior mjeshtëri Ndou.

Cuk simoni nuk bën një përkthim fjalë për fjalë. Ai është më shumë besnik i lexuesit të vogël shqiptar sesa tekstit origjinal. Prioriteti i tij nuk është ekuivalenca në planin formal por këmbëngulja në ekuivalencën kuptimore dhe stilistike, gjë që e bën tekstin e tij dinamik. Këto janë disa nga arësyet që na shtojnë të themi me bindje se lexuesi i tij shqiptar e ka shijuar “*Pinokun*” në të njëjtën mënyrë si ai italian. Për të arritur këtë, Cuk Simoni ka reduktuar në minimum shprehjet, strukturat apo fjalët të cilat transmetojnë kulturën e huaj. Edhe pse përkthyesi e njeh mirë gjuhën shqipe, përkthimi i tij nuk i ka shpëtuar aty-këtu depërtimit të elementëve të huaj.

Nga këndvështrimi sintaksor, vihen re disa modifikime në strukturën e fjalisë, edhe pse italishtja nuk është strukturalisht shumë e ndryshme nga shqipja. Kjo tregon qartë se Cuk Simoni ka tentuar të ruajë ekuilibrin e vështirë midis besnikërisë së përkthimit dhe përshtatjes. Herë-herë vëmë re përgjatë përkthimit një reduktim të disa fjalëve të tekstit origjinal, në funksion të ruajtjes së kuptimit, gjë që tregon edhe vështirësitë dhe pamundësinë e sjelljes së një kulture të huaj gjuhësore në shqip.

“...il medico le aveva ordinato una grandissima dieta, così dovè contentarsi di una semplice lepre dolce e forte con un leggerissimo contorno di pollame ingrassate e di galletti di primo canto.”

“...mjeku e kishte pasë porosinë me mbajtë perizë të madhe, i u desht me u kondëndue vetëm me një leper percjellë me pak pula të majme e gjela të rí.”

Vetëm në fragmentin e sjellë më sipër janë reduktuar 7 fjalë (una, così, dolce e forte, contorno di) dhe dy prapashtesa (issima/o). Una grandissima dieta mund të ishte përkthyer një perizë shumë të madhe (një dietë shumë të fortë), por meqë -issimo-shumë shërben si përforcuese e fjalës e madhe përkthyesi ka preferuar ta heqë për të evituar përsëritjen, të njëjtën gjë mund të themi edhe në rastin e leggerissimo-shumë pak. Ndërkohë përkthimi i fjalës contorno-gamiturë është evituar dhe galletto di primo canto-gjel i këngës së parë është preferuar të përkthehet gjela të ri sepse rezulton më e qartë në shqip.

Shembulli i mësipërm na tregon qartë se reduktimet e Cuk Simonit janë bërë për të evituar përsëritjet në shqip, të cilat në italisht tingëllojnë bukur, ose për t'i qëndruar besnik kuptimit.

Vështirësia e sjelljes së një tjetër kulture në tërësinë e saj, e ndryshme nga ajo e gjuhës së përkthimit, sjell papërkthyeshmërinë e disa shprehjeve, por kjo e ka orientuar përkthyesin Cuk simoni t'i zëvendësojë ato me të tjera të gjuhës së tij, në shumicën e herëve, me kuptim të përafërt. Shumë shpesh përkthyesi i lejon vetes të shtojë fjalë, por dhe shprehje, kur e ai e shikon të nevojshme në funksion të kuptimit por edhe të hijeshisë artistike. Nuk mungon zëvendësimi i shprehjeve të italishtes, të cilat mund të përktheheshin fjalë për fjalë, me të tjera që në shqip tingëllojnë më dinamike. Të tilla modalitete hasen dendur në tekstin e Cuk Simonit. Ja disa shembuj:

“... tutti lo chiamavano maestro Ciliegia, per via della punta del suo naso, che era sempre lustra e paonaza, come una cigliegia matura.”

“... të gjithë e thirrshin mjeshter Qershija, për shkak të mâjes së hundës, qi e kishte gjithmonë të shndriishme e të kuqe, si një kokerr qershí e pjekun.”

Cigliegia matura është përkthyer kokerr qershí e pjekun në vend të qershí e pjekur.

“Appena maestro Ciliegia ebbe visto quel pezzo di legno, si rallegrò tutto; e dandosi una fregatina di mani per la contentezza, borbotò a mezza voce: ...”

“Porsá mjeshtrë Qershija pau at cope dru, i u knaq fort zêmra; e tuj ferkue duert prej gzimi tha me vedi: ...”

Si rallegrò tutto është përkthyer i u knaq fort zêmra në vend të u gëzua shumë, borbotò a mezza voce është përkthyer tha me vedi në vend të mërmëriti me gjysëm zëri.

“Come potete immaginarvelo, la Fata lasciò che il burattino piangesse e urlasse una buona mezz'ora, a motivo di quel suo naso che non passava dalla porta di camera; e lo fece per dargli una severa lezione e perché si correggesse dal brutto vizio di dire bugie, ...”

*“Si mûnd të ju a mârrë mëndja, Zâna e la njiherë Pinokun të kjajë e të vajtojë per nja’ i gjysë ore të mirë, për punë t’asajë hûndë qi s’mûnd të kalote per derës s’odës: pse desht me e ndeshkue e me e bâ me zânë mënd, qi mos të rrëjë mâ kurr...”*

*Come potete immaginarvelo është përkthyer si mûnd të ju a mârrë mëndja në vend të si mund ta imagjiloni; fjala njiherë është futur nga përkthyesi sepse nuk ndodhet në origjinal; che non passava është përkthyer qi s’mûnd të kalote në vend të që nuk kalonte; e lo fece per dargli una severa lezione e perché si correggesse dal brutto vizio di dire bugie është përkthyer pse desht me e ndeshkue e me e bâ me zânë mënd, qi mos të rrëjë mâ kurr në vend të dhe e bëri për t’i dhënë një mësim të mirë dhe të korigjohet nga vesi i keq i të thënit gënjeshtro.*

Në tekstin e Cuk Simonit nuk mungojnë edhe rastet kur për një shprehje në italisht jepen dy të tilla në shqip.

*“- Questo legno è capitato a tempo...”*

*“- Shi në kohë të mirë më rá në dorë kjo dru...”*

Për shprehjen *è capitato a tempo*- ndodhi në kohën e duhur, përkthyesi jep dy të tilla: *Shi në kohë të mirë dhe më rá në dorë kjo dru*

### **Përfundime:**

1. Leximi i kujdesshëm i “Pinokut” të Cuk Simonit tregon qartë se kriteret që kanë shërbyer si udhërrëfyese gjatë përkthimit të romanit kanë qënë ato estetike, besnikëria e shpirtit por edhe e fjalës së origjinalit. Përkthimi i tij është art sepse nuk është një kopje e thjeshtë por një veprë ku duket qartë delli krijues i përkthyesit, i cili e ka konvertuar tekstin në shqip në një rikrijim në të njëjtin nivel me origjinalin.
2. Gjatë përkthimit Cuk Simonin e ka shoqëruar kalimi krijues nga njëra gjuhë në tjetrën dhe duket qartë se ai e ka rindjerë këtë akt krijues duke lënë mënjane rregullat me rëndësi gjuhësore dhe duke iu dedikuar çastit të rikrijimit. Edhe pse përkthyesi ka arritur t’i japë veprës një autonomi estetike në shqip, përkthimi i tij letrar mund të konsiderohet si një proces që i konsideron dy tekstet në një marrëdhënie dinamike midis tyre.
3. *Pinoku shqiptar* i Cuk Simonit është një nga veprat më të mira të përkthyer në shqip, e cila ka pasuruar fondin e lexuesit të vogël shqiptar, jo vetëm në kohën kur është përkthyer por edhe në vitet në vijim.

## Shënime

<sup>1</sup> Për shkak të origjinalitet të stilit të tij Collodi është cilësuar si një nga shkrimtarët më të mëdhenj të shekullit XIX. Këtë e provojnë shkrimet e shumta kritike që i kanë dedikuar “*Aventurave të Pinokut*” kritikët letrarë dhe studiues të tjerë të disiplinave të ndryshme.

<sup>1</sup> Bishqemi, A., 2008, “*Histori e Letërsisë Shqiptare për Fëmijë dhe të Rinj*”, botues Pëllumb Zekthi, fq. 101-102

<sup>1</sup> Të tria botimet e këtij romani të bëra midis dy lufrave botërore vijnë me titullin “*Zemra*”, ndërkohë që titulli i librit në original është në trajtë të pashquar “*Zemër*” (*Cuore*). Në ribotimet pas Luftës së Dytë Botërore është përdorur herë titulli “*Zemër*” e herë “*Zemra*”.

<sup>1</sup> Collodi, C., 1981, “*Le Avventure di Pinocchio*”, Giunti Marzocco, Firenze, fq.54

<sup>1</sup> Simoni, C., 1935, “*Pinoku*”, botim i përkthyesit, rr. Gurakuqit 40, Shkodër, fq. 62-63

<sup>1</sup> Collodi, C., 1981, “*Le Avventure di Pinocchio*”, Giunti Marzocco, Firenze, fq. 5

<sup>1</sup> Simoni, C. 1935, “*Pinoku*”, botim i përkthyesit, rr. Gurakuqit 40, Shkodër, fq. 9

<sup>1</sup> Collodi, C. 1981, “*Le Avventure di Pinocchio*”, Giunti Marzocco, Firenze, fq. 5

<sup>1</sup> Simoni, C., 1935, “*Pinoku*”, botim i përkthyesit, rr. Gurakuqit 40, Shkodër, fq. 9

<sup>1</sup> Collodi, C., 1981, “*Le Avventure di Pinocchio*”, Giunti Marzocco, Firenze, fq. 78

<sup>1</sup> Simoni, C. 1935, “*Pinoku*”, botim i përkthyesit, rr. Gurakuqit 40, Shkodër, fq. 89

<sup>1</sup> Collodi, C., 1981, “*Le Avventure di Pinocchio*”, Giunti Marzocco, Firenze, fq. 5

<sup>1</sup> Simoni, C., 1935, “*Pinoku*”, botim i përkthyesit, rr. Gurakuqit 40, Shkodër, fq. 9

## Bibliografia

Bishqemi, Astrit, (2008) “*Histori e Letërsisë Shqiptare për Fëmijë dhe të Rinj*”, botues Pëllumb Zekthi

Collodi, Carlo, (1935) “*Pinoku*”, përkthyer nga Cuk Simoni, Shkodër, Botim i përkthyesit rr. Gurakuqit 40

Collodi, Carlo, (2000) “*Pinoku*”, përshtatur në shqipen letrare nga Zef Simoni, “Naim Frashëri”, Tiranë

Collodi, Carlo (1981) “*Le Avventure di Pinocchio*”, Giunti Marzocco, Firenze,

Dedja, Bedri, (1971) “*Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë*”, Tiranë, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”

*Hylli i dritës*, nr. 9, 1935

*Illyria*, nr.21, 7 shtator 1935

*Illyria*, nr 23, 21 shtator 1935

*Illyria*, nr. 24, 28 shtator 1935

*Leka*,nr. 9, shtator 1935

## Polisemia e simboleve në funksion të intertekstit në poezitë e Naim Frashërit

**Meral Shehabi-Veseli**

Universiteti i Evropës Juglindore,

Tetovë, Maqedoni

[m.shehabi@seeu.edu.mk](mailto:m.shehabi@seeu.edu.mk)

### Hyrja

Polisemia e simboleve është prezente në poezitë e N.F. Shumësia e këtyre simboleve flet për aftësinë e autorit që të përdor shenja që flasin për gjëra të fshehura. Frashëri në poezitë e tij ka përdorur shumësi të simboleve që kanë mbështetje në letërsi dhe kultura të ndryshme. Këto simbole që janë të ngjashme, kryesisht me simbolet orientale, flasin për lidhjen intertekstuale që kanë poezitë e tij. Simbole më të shpeshta që përdoren në poezitë e Frashërit janë: qiri, bilbili, fyelli, vera etj. Këto simbole, në disa raste përdoren, si simbole që kanë kuptim të njëjtë, si në tekstin parësor.

Simbolet referojnë në funksionin e fshehur të gjërave. Fjala *symbol*, rrjedh nga fjala greke që do të thotë “*shenjë*” që referon në një shënim. Në kuptimin literal, simboli bashkon fotografinë me idenë, ose konceptin në të cilën referohet ajo fotografi. Është shumë e thjeshtë të thuhet që do simbol është fotografi, pasi simboli referon në dicka që është jashtë fotografisë, në disa raste e lidhur me fotografinë, por asnjëherë nuk është identike me atë. Në fjalorin e K. Qullavkovës, simboli është definuar nga Kapushevskaja “*simboli paraqet karakter të jashtzakonshëm, amblem, shenjë për dicka që është e fshehur, e pakdukshme, apstrakte ... me një fjalë, shenjë e dukshme për dicka të padukshme*”. (Qullavkova, 2003:498)

### 1. Simboli si intertekst

Qenësia e intertekstualitetit nënkupton praninë e një teksti në një tekst tjetër. Por, me zbulimin e lidhjeve intertekstuale nuk zbulohet asgjë e re, kjo nënkupton mënyrën ndryshe e të menduarit, duke gjetur piktakime të hapura ose të fshehura. Këto piktakime të fshehura në rastin konkret janë simbolet që përdor, Naimi në poezitë e tij. *Pra, simboli nënkupton kuptimin literar. Sipas N.Fraj, këtë kuptim literar ia mvesh letërsisë, si një nga aspektet intertekstuale të kuptimit, zakonisht kuptimin që e ndajnë veprat letrare me të gjitha strukturat e fjalës.*”. (Fraj, 1990:117)

Atë që don të shpreh autori është poezia, por atë që shpreh në çdo varg, është kuptimi literar, që është pjesë e poezisë. Kuptimi literar, si shihet është i ndryshueshëm dhe polisemik. Poezia është imitim i natyrës, ky parim na flet që çdo poezi mund të rishikohet jo vetëm si imitim i natyrës, por edhe si imitim i poezive të tjera. Sipas Eliotit një poet i mirë, ka më tepër mundësi të huazojë sesa të emitojë. Aftësia e Frashërit është, në përpunimin e materialit që e huazon dhe shkathtësinë po të njëjtën ta shpreh në mënyrën e vet. Ai nuk emiton por huazon simbole nga

letërsia e lindjes. Pra, edhe simboli mund të jetë një aspekt, që bën lidhjen intertekstuale të një poezie me një tjetër.

Metaforat në vargjet e Naimit mund të përgjithësohen si simbole. Nëse metaforat janë të pranishme në poezitë filozofike, në poemat “Istoria e Skenderbeut” dhe “Qerbelaja”, simbolet janë të pranishme në poezitë filozofike të përmbledhjes “Lulet e verës” “Ëndërimet” si dhe në poemat e lartpërmendura. Në veprimtarinë letrare, Naimi përdor *simbole të përgjithshme* dhe njëkohësisht krijon *simbole të reja*. Simbole të përgjithshme i quan ata simbole që i merr nga historia, kultura, mitologjia, natyra dhe kosmosi. Kurse *simbole të reja* i quan ata simbole që vet i krijon me gjenialitetin e tij poetik.

Ai merr figura edhe nga letërsia arabe. Figurat që flasin për karakteret e tyre janë: Imam Hasani, Imam Hyseni, që janë simbole nëpërmjet të cilëve reflektohet mirësia e përgjithshme, por edhe vuajtja për të vërtetën dhe drejtësinë. Dy djemtë e Imam Hysenit, janë simbole të viktimit të pafajshme. Mavija dhe Mervani janë simbole të së keqes dhe mosbesimit etj.

Një rafsh tjetër prej ku Naimi merr simole me vlerë shumë të madhe është natyra dhe kosmosi. Për Naimin, natyra është një *libër universal* që i ofron njeriut kuptime të ndryshme. Në poezinë “Vetëdija” nga përmbledhja “Fletoret e Bektashinjve”, Naimi na vetëdijëson se vendi i diturisë është kosmosi, i cili mund të unifikohet me Zotin. Ai shprehet:

*Fletore e Perëndisë,  
Për të Zon` e diturisë,  
Është e tërë gjithësija,  
Q’është vetë Perëndija....”* (Frashëri, 2007: 210.)

Metafora për librin e natyrës, e cila vjen në shprehje në kulturën e lindjes, edhe në letërsinë mesjetare nëpërgjithësi, është e shpeshtë edhe në letërsinë evropiane. Ky libër universal, ka kontekstin në letërsitë e ndryshme duke filluar nga letërsia orientale.

Në botën poetike të Naimit, gjërat, sendet, dukuritë, fenomenet, stinët e vitit, trupat qiellor, gjallesat, kafshët, të gjithë kanë gjuhën e vet, të bukur, të përbashkët, kuptimplotë, të cilën e quan *Gjuha e zemrës*:

“Flet natyra në çdo ças në këtë botë  
Dhe të fshehtën që ka Brenda shkoqur thotë... (Frashëri, 2007: 167.)

Kjo gjuhë magjike mund të na refejë shumë gjëra. Flitet për një gjuhë shumë dimensionale, gjuhën e simboleve. Nuk është e tepruar nëse thuhet që bilbili në botën poetike të Frashërit, është simbol i autorit, bukurisë; lulja simbol i stinës së pranverës, rinisë, pafajsisë; hëna simbol i dashurisë, dielli simbol i dritës, Zotit; fyelli simbol i dashurisë etj. Në veprimtarinë letrare të Naimit, emri dhe folja që metaforizojnë, krijojnë kontekstin simbolik. Ky kontekst me kuptimin e tij i paralajmron tekstin parësor. Përgjithësisht, simbolet, metaforat janë përbërje letrare, me të cilat shprehja retorike për të përgjithshmen bëhet figurative, shprehje e përgjithësuar për të veçantën.

## 2. Qiriri dhe flutura si simbole

Metafizika e Naimit, më saktësisht e poezisë së tij, gjen mbështetje në mistikën islame (tasafuf). Pra, në këtë rast veprat e të shkuarës veprojnë në veprat e së tashmes, nga një kendvështrim ku të vjetrat veprojnë mbi të rejat. Simboli në aspektin metafizik nënkupton lidhjen e të dukshmes me të padukshmen. Shpesh thuhet poezia mistike është e shumë kuptimshme. Nuk ka lexues që në të njëjtën kohë nuk e percepton si të tillë. Qiriri dhe simbolet tjera që do t'i trajtojmë në këtë punim janë në të shumtën e rasteve në titujt e poezive.

Idenë për misionin e poetit, Naimi e shpreh me metaforën e qiririt. Qiriri është simbol i letërsisë perse. Shpesh ky simbol nuk trajtohet në poezinë shqipe ashtu si në letërsinë perse. Në disa raste ky simbol është pasuruar me ngjyra të reja, kuptime të ndryshme nga konteksti i tij. Një gjë të tillë, mbase e qëllimshme nga Naimi për t'ju larguar në disa pika metafizikës.

Këto motive, mjeshtërisht janë përshkruar në poezitë e tij. Nga vet fakti për dykuptimshinë e simboleve, kjo poezi, është botuar dy herë me tituj të ndryshëm. Së pari, mbante titullin “Qiriri” dhe u botua në revistën “Drita” (1884), së dyti, pas dy vitesh në përmbledhjen “Vjersha për mësojtoret e para”, si “Fjalët e qiririt”. Këto dy variante na lejojnë të kemi një vështrim të dyanshëm për këtë poezi.

Në variantin e parë, poezinë “*Fjalët e qiririt*”, do të trajtohet si simbol i letërsisë tradicionale perse, por me motiv të ri. Qiriri është paramenduar si pishtar. Nëpërmjet kësaj figure hapet ideja për pavdekshmërinë e njeriut, i cili shkon drejt vdekjes, por i djegur nga flaka për idealen.:

“Kur më shihni që jam tretur,  
Mos pandehni se kam vdekur,  
Jam i gjallë e jam ndë jetë,  
Jam në dritë të vërtetë.” (Frashëri, 2007: 13)

Zëri i ri që e krijoi poeti në figurën e qiririt, rezultojnë në faktin që ky simbol i Orientit është përpunuar në thellësi, por kjo nuk flet që në poezinë e Naimit nuk mbeti asgjë nga ky motiv. Qiriri bën dritë të tjerëve, duke u shkrirë pandërprerë. Bën dritë duke u shkrirë, ose shkrihet duke bërë dritë. Kur ndriçon qiriri, simbolizon ekzistencën e Zotit gjithkund. Lidhja intertekstuale na referohet jo vetëm me marrjen e simbolit nga një letërsi tjetër, por edhe me përdorimin e atributeve të Zotit në vargjet e poezisë “Fjalët e qiririt” në vijim:

“...jam në dritë të vërtetë”....

(Frashëri, 2007:14)

Kur shkrihet qiriri, paraqitet si luftëtar për dashurinë e Zotit. Parashtrohet pyetja, a vdes me të vërtetë ky qiri?

„...Kur më shihni që jam tretur  
Mos pandehni që kam vdekur... (Frashëri, 2007:14)

Në këtë mënyrë qiriri duke u shkrirë, është dëshmi për ekzistencën e Zotit të vërtetë. A mund që dikush të jetë i ngjashëm me këtë qiri? Me qiririn, që është në gjendje të shkrihet, të digjet, venitet, padashur të shuhet por përsëri të tretet. I ngjashëm me këtë qiri, mund të jetë vetëm njeriu ideal, ai që ka përjetuar shkallën më të lartë të ngritjes mistike.

Në vargjet në vazhdim të kësaj poezi, zbulohet edhe një simbol tjetër, i cili nuk haste në titullin e poezisë, por në subjektin lirik të saj:

“O zëmëra fluturake!  
Qasju pak kësaj flake,  
Mbase krahë t’i përvëlon,  
Po edhe shpirtin ta shenjtëron.”(*Ibid.*,f. 14.)

Siç shihet edhe nga vargjet e kësaj poezie, Naimi vetëm e ngjall simbolin e fluturës, e cila ka përjetuar metamorfozë, është shëndruar në shpirt fluturak, e cila tretet për të mirën e njerzimit. Kjo flutur, përballat me rrezikun, që t’i digjen krahët, nga ajo kërkohet që të pranojë këtë lëndim trupor, që ta arrijë vlerën shpirtërore.

Fotografia e “shpirtit fluturak” i paraqet njerëzit që janë të orientuar nga drita, që e duanë diturinë, ata për të cilët flutura flijohet. Ajo, u bën thirrje, që t’i bashkangjiten, mos frikohen nga drita që pasqyron vet Zotin. E vetëdijshme që kjo është rrugë e vështirë, kërkon që të angazhohen për këtë flijim. Mbase, e vlen që të flijohesh për këtë dritë.

Kjo është thirrje që të shkohet drejt dritës, pa pasur ndrojtje zjarrin që paraqitet me vonesë, duke qenë të vetëdijshëm për rrezikun nuk duhet të ndalojnë. Nëse qiriri tregon si digjet dhe tretet deri në pikën e fundit, kërkon nga ata që të jenë pjesë e flijimit, e jo të sodisin nga larg. Jorgo Bulo, konsideron që:” figura e qiririt në letërsinë e sufizmit...është e lidhur ngushtë me figurën e fluturës, e cila përbën bazën e motivit të njohur të vetëasgjësimit fizik (fana) të qenies njerzore për t’u shkrië me Zotin” (Bulo, 1999: 32)

Ky zjarr mistik bazën e ka në letërsinë orientale. Si Hipotekst mund të merren ca vargje të Rumiut, i cili shprehet poashtu për këto simbole, siç janë qiri/flutura:

*Çdo grup, ashtu si fluturat e natës rreth qiririt, vjen vërdallë pa pushim në këtë botë!*

*E hedhin veten në një zjarr, por, në të vërtetë, vazhdojnë të rrotullohen përreth qiririt të vet...”* ( Rumi, 2007:vargu 336/337)

...Dhe qiriri mendon se vetë u dogj, të paktën ato t’i shpëtojë pa u djegur, pa hequr mundim.”

(*Ibid.*, varg. 340-344)

Qiriri i Rumiut dëshiron vetë që të digjet, që t’i shpëtoj të tjerët, mbase motive i njëjtë si te poezia e Naimit, motivi i vetflijimit i njërit për të tjerë. Nuk është vështirë pas kësaj të konstatohet që këto vargje të Rumiut, Naimi i përdor si tekst parësor, për ta krijuar tekstin e tij. Këtu do të shërbehemi me terminologjinë e Rifaterit i cili vë përball njëri-tjetrit intertekstualitetin e rastësishëm dhe të detyruar. Në këtë rast kemi gjurmë të tekstit, në konteksti e tij. Ai shprehet: “lexuesi nuk mund të mos e shquaj, sepse interteksti lë në tekst një gjurmë të pashlyeshme...e cila ndihmon deshifrimin e mesazhit. (Gjurma e Intertekstit, 1980: 15). Kjo poezi ka dy anë, ca e komentojnë njëren e disa tjetren anë. Mund të konstatohet se të dy anët janë të vërteta, pasi Zoti vet, në aspektin metafizik, ka dëshiruar që të përdoren këto të vërteta.

### 3. Bilbili si simbol

Në letërsinë klasike perse, bilbili është simbol, me një polisemantikë të gjërë, e ndryshme nga letërsia shqipe. Parashtrohet pyetja çfarë paraqet ky simbol?

Po paraqesim disa nivele të rëndësishme:

1. Bilbili është simbol i mirësisë,
2. Simbol i poetit
3. Simbol i shpirtit të lirë që në shpie drejt Krijuesit

Simboli i bilbilit në poezinë e Naimit, mbase ka funksion të ndryshëm nga simboli që parasheh disa nivele në letërsinë perse. Bilbili nuk mund të jetë Naimi, i cili këndon, nuk paraqet simbolin e mirësisë, as shpirtin e lirë që shpie drejt krijuesit. Bilbili i Naimit, këndon, mund të jetë metaforë e këngës. Kjo harmoni muzikore, ka rëndësi të madhe për sufijtë. Këtu shohim piktakime me mistikën sufiste. Pasi, kjo harmoni e këngës, mund të reprodukoj kënaqësinë, që ka përjetur shpirti para-embriional, me pranimin e jetës, që na ka dhuruar Krijuesi. Kënga, (sama, muzika shpirtërore), mund të jetë edhe Zëri i Krijuesit që i bën thirrje njeriut, të kthehet tek Ai. Ruzbihan Baliq Shirijazi për muzikën shpirtërore shprehet: “Eksistojnë tri lloje të muzikës shpirtërore: njëra për njerëzit e zakonshëm, tjetra për elitën, e treat për elitën e elitës. Njerëzit e rëndomtë dëgjojnë nëpërmjet natyrës së tyre të përsosur, kjo është varfëri. Elita dëgjon nëpërmjet zemrës, ajo do të thotë të jesh në kërkim. Elita e elitës dëgjon me shpirt, ajo do të thotë të jesh i dashuruar....., Muzikanti im është Zoti dhe për atë unë flas... (H.Korobin f: 15.)

Bilbili i Naimit bën thirrje për heshtjen që të dëgjohet melodia e cila arrinë deri në shpirtin që digjet për dashurinë:

“Një zë tjetër tani dëgjonj,  
Që zëmërnë ma përvëlton,  
U doqë, më s`mund të duronj,  
Bilbili ka zën` e këndon. (Frashëri, 2007:123)

Heshtja kërkohet në mënyrë permanent. Duke shprehur që askush nuk do ju dëgjojë edhe po ta prishni këtë heshtje, pasi:

Vini veshn` dhe dëgjoni,  
Bilbili, bilbili këndon. ( *Ibid.*,)

### 4. Vera si simbol

Derisa simbolet që trajtuam ishin në titujt e poezive të Naimit, simbolin e verës nuk e hasim në titull, po në poezinë “Kënga e fyellit”. Vera në aspektin metafizik është simbol i dashurisë hyjnore. Nëse përdorim argumentin e Svedenborgut, do të themi që vera korenspondon në verën hyjnore. Në anën tjetër vera dhe Vera nuk janë identike, por janë homonime që përmbajnë antagonizma më shumë se çdo antonim. Edhe ne Kuran flitet për dy lloje të verës: Vera është e ndaluar nga Zoti, po nga ana tjetër, ajo u premtohet besimtarëve në botën tjetër.

Vera në kuptimin mistik paraqet Verën, verën e dashurisë hyjnore, që ka si rezultat dehjen për Zotin. Për këtë verë na këndojnë Kajami, Saki, Taverna, që kanë dimenzion metafizik. *Edhe*

*Rumi u flet për raportin mes Verës dhe verës...Njëra është lëngu i jetës e tjetra është vetëm aroma e keqe.*

Kostatohet se edhe te Naimi flitet për verën hyjnore për mos u shkupertur teksti i tij parësor, nga referenca. Në vargjet e poezisë “Fyelli” shprehet:

“ Ky `shtë zjar` i dashurisë...

...I ra zëmërës, e nxehu,

I ra verës e bu iti,

I ra shpirtit dhe e dehu”.(Frashëri, 2007:112)

Zemra e njeriut të dashuruar është e dehur, në këtë rast kjo dashuri është dashuri në përmasa më të lartë, dashuri për Krijuesin. Si rezultat i dehjes Hyjnore është fenomeni i ekstazës, për të cilën flet edhe Inb-Al-Arebi. Kjo verë është Dashuria Hyjnore e cila paraqitet në rrjedhat e krijimit.

## 5. Lulja si simbol

Në simbolet e njohura orientale bën pjesë: trëndafili, zybyli, lulja të cilët kanë vend të rëndësishëm në letërsinë shqipe, posaçërisht në lirikën e Naim Frashërit. Konstatohet që këto simbole nuk janë futur në poezinë shqipe me shumësinë e burimit, por janë futur para së gjithash me kuptimin e tyre të shprehur. Fillimisht, këto simbole që kanë funksionin e interteksti janë huazuar si fjalë me kuptimin e tyre të drejtëpërdrejtë, por pastaj fitojnë konotacion simbolik.

Trëndafili në poezinë klasike perse, apo në përgjithësi në poezinë orientale, nuk paraqet tregues të dashurisë, si në letërsinë shqipe, por është tregues për ngritjen shpirtërore, në një shkallë që parashe ngritje në shkallën më të lartë të përsosjes. Në poezinë e Naimit ky simbol ka ndryshuar karakterin e vet, është bërë simbol kronik, është lëshuar nga qielli dalëngadal në tokë dukë shprehur dashurinë për vajzën e tij. Në poezinë “Një lule e vyshkur apo një vajzë e vdekur” kjo lule është sibol i vajzës që u nda nga jeta në vitet e rinisë. Naimi para varit të së bijës, me dhimbje të madhe shpirtërore kërkon disa mundësi për jetën pas vdekjes, që të zbut këtë dhimbje:

1. Jeta e vërtetë fillon pas vdekjes, me të mbyllur sytë, thotë i dërguari
2. Vdesim dhe përsëri ringjallemi, vazhdon Naimi.

Ai flet për metamorfozën e shpirtit, i cili asnjëherë nuk vdes po kalon në forma tjera.

“ Prap në duar të motit?

Të linç për të vdekur prapë,

E të vdeç që prapë të linç...” (Frashëri, 2007: 126)

3. Mundësia e tretë është absurdi që bie në sy në vargjet në vijim:

Apo përjetë do të shkosh,

Mosqënja të të mbulonjë...” (Ibid.,: 127.)

Të gjithë mundësitë flasin për radhitjen e njëjtë në poezinë e Naimit. Por ky simbol që largohet nga simboli parësor, ai oriental, apo nga teksti i parë, është dhimbja, por kjo jetë

vazhdon që të lind në një lule tjetër. Lulja jo gjithmonë ka kuptimin e njëjtë në veprimtarinë e Frashërit, në poezinë “Një lule e vyshkur apo një vajzë e vdekur” ai në figurën e lules e fsheh shokun e tij Hoxh Tasinin duke ju drejtuar me vargun: O Hasan Tahsin! O trëndafil qiellor”. (Frashëri, 2007). Ky trëndafil qiellor, nuk është i zakonshëm po me përmasa hynore, i pavdekshëm...dhe vendi i tij është parajsë. Ali Akbar Ziai konstaton që trëndafili që trajtohet në shumë poezi të përmbledhjes “Ëndërrime”, e përmbush traditën perse, ku autori me këtë simbol, nënkupton ngritjen shpirtërore.

Ky simbol, që në rastin konkret nënkuptonte vajzën, Zotin dhe ngritjen shpirtërore të një individi, nuk është si lulet tjera, po mban aromën e parajsës. Më përkushtimin e tij ndaj shokut na përkujton, përkushtimin e Rumiut për Shemsedin Tabrizin. Kjo flet për mundësinë e paraqitjes së histories si intertekst univerzal.

## **Përfundim**

Si përfundim mund të themi që simolet që i kemi analizuar në poezitë e Naimit, qofshin ata në titujt apo në subjektin lirik të poezisë, e arsyetojnë tezen tonë, që intertekstualiteti është prezent në çdo vepër letrare por ai është i shprehur në disa mënyra të ndryshme. Kjo nënkupton relacionin intertekstual, që kanë këto poezi, në raport me tekstin parësor, letërsinë orjentalë. Këto mardhënie intertekstuale që na paraqiten herë të dukshme herë të fshehura, i japin teksti vlerë akoma më të madhe. Por njëkohësisht mundëson, që teksti të ndjek tonin e vet, edhe pse i krijuar nga thurja e shumësisë së teksteve.

## Bibliografia

- Aliu, A.**(1990) *Kërkime Studime, kritika, ese*, Tiranë, Naim Frashëri.
- Bisanič, S. (1970)** *N.Fraj kako mitski i ahetijski kritičar*, Zagreb, Umjetnost reči.
- Bibla**, (1997) Shoqata shqipëtare e Biblës, Tiranë.
- Bulo, J.** ( 1999) *Tipologjia e lirikës së Naim Frasherit*, Tiranë, ASHRSH.
- Çakolli, F.** (2003) *Kodi Biblik në letërsinë shqiptare 1462-1947*, Prishtinë, Tenda.
- Fraj, N.(1990)**, *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë.
- Frashëri. N. (2007)**, *Vepra I-VI*. Përgatitur nga. Rexhep Qosja dhe Jorgo Bulo. Tiranë, Toena.
- Frashëri, N. (2000)**, *100 vjet pas*, Konferecencë shkencore , Prishtinë.
- Gennete, G.**( 1982) *Pamlimpsestes* ( la littearture au secondiemedegree), Paris.
- Izet, M. (2004)** , *Kllapia e tezawufit*, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup.
- Kaller, Xh. (2001)**, *Teori letrare*, Prishtinë, Era.
- Korça, A. H. ( 2000)**, *Fyelli dhe disa kujtime*, Tiranë,Ribotuar në “Naimit”.
- Korbin, H. ( 1997)**, *Histori e filozofisë islame*, Shkup.
- Krifca-Beqiri, M.( 2003)**, *Intertekstualiteti në poezinë shqipe mes dy luftërave*, Shkup, Fakti.
- Kryeziu, E. (1998)**, *Metafizika e Naimit*,Prizren Dardania, Prizren.
- Loshi, Xh. ( 2000)**, *Vështrime stilistike*, Tiranë.
- Кулавкова, К. (2003)**, *Теорија на интертекстуалноста*, Скопје, Култура.
- Shehabi- Veseli, M. (2009)**, *Dialogu letrar i Naimit me letërsinë orientale*, Tezë magjistrature, Fakulteti Blazhe Koneski, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi , Shkup.
- Xheladin. R. M. (2007)**, *Mesnevi I-VI*, shqipërues nga persishtja Mitat HoxhaShkup, Logos-A.
- Xhiku, A. ( 2004)**, *Letërsia shqipe si polifoni*, Dituria.

## Poezia në gazetën “Llaiko vilma” (1945-2012)

**Olieta Polo**

“Eqrem Çabej”,

Gjirokastrë, Shqipëri

[poliouolga@yahoo.gr](mailto:poliouolga@yahoo.gr)

Poezi shkruajnë dhe botojnë një pjesë e mirë e krijesve të Minoritetit Etnik Grek. Duke qenë se është gjinia letrare që shkruhet dhe botohet më shpejt, të gjitha moshat gjejnë strehë në këtë fushë të krijimitarisë, gjithmonë në një lidhje objektive me deklaratimet ideore e programatike të gazetës. Domethënë autori i ri përmes një cikli poetik, apo akoma edhe me shumë me anë të një libri, bëhet i njohur e përfaqëson në një kohë të shpejtë gjithë kapacitetin shpirtëror të Minoritetit Etnik Grek. Një grup i madh poetësh dhe bashkëpunëtorësh janë ata, që provojnë forcat e tyre për herë të parë, duke skicuar fillimet e para poetike dhe ndjeshmërinë krijuese në sajë të inkurajimit dhe ndihmës së redaksisë së gazetës. Paraqitja e tyre permanente në botimet e kohës në faqet e kësaj gazete, bën të mundur, që në harkun e disa viteve, ata të dalin me përmbledhjet vetjake poetike të pakta për një publik më të gjerë.

Në brendësi të gazetës gjejmë kompozime të shkurtra dhe me pak vargje, gjë që u shkon për shtat si nivelit kulturor të asaj epoke ashtu dhe kushteve teknike të përgatitjes së gazetës. Kjo i përshtatet edhe papjekurisë letrare të poetëve, të cilët më mirë mund t'i karakterizojmë si vjershëtarë ose thurës vargjesh, përdërisa nuk rrezikojnë të bëjnë krijime të mëdha e të pjekura poetike. Bile, disa, pas paraqitjeve të tyre të para poetike, humbasin nëpër aktivitete të tjera dhe nuk vazhdojnë rrugën e tyre në poezi. Nga ana tjetër gjejmë edhe poetë apo krijues të aftë dhe të njohur në fushën poetike pavarësisht se kanë pak veprimtari botuese. Poezia përzgjidhet nga shpirti rinor si mënyra më e shpejtë për të shprehur shqetësimet e brendshme, meqënëse kjo si gjini tashmë e dobishme, kultivohej lehtë. Nga larmia e vargjeve disa shquhen dhe dalin në dritë në fushën e poezisë dhe të tjerë mbeten tek shkrimet e tyre të çastit. Për më tepër edhe “Llaiko Vima”, gjithmonë në bazë të parimeve të saj themeluese, ia beson faqet e saj dhe i hap rrugën brezit të ri. Për më tepër, bollëku i materialit poetik nënkupton regjistrimin e shumë poetëve, që tërhiqen, dhe që së paku një pjesë e mirë e tyre, nëse përfundojnë poetë, mbeten bashkëpunëtorë të zellshëm të gazetës. Duhet shënuar me këtë rast se nga pikëpamja gjinore numri i poetëve është i madh, ndërsa numri i poeteshave është i kufizuar.

Nga vjershat e shkrimtarëve më të njohur e më të rëndësishëm të Minoritetit Etnik Grek paraqiten ato të poetit Pano Çuka, i cili është një nga penat më prodhimtare në MEG. Në faqet dhe numrat e gazetës, ai ka botuar shumë tituj, disa prej të cilëve janë: “Poshtë lufta” (“Llaiko Vima”: 29.09.1949), “Gëzuar për shumë vjet” (“Llaiko Vima”: 01.01.1955) (në këtë vepër përmenden ngjarje nga vitet e tij të vegjëlisë për Vitin e Ri), “Në ushtrinë e fitorës” (“Llaiko Vima”: 24.02.1955), “Muaji Maj në natyrë, muaji Maj në zemra tona” (“Llaiko Vima”: 01.05.1955), “Forca jonë” (“Llaiko Vima”: 19.05.1955), “Rojet e pafjetura” (“Llaiko Vima”: 10.07.1955), “Në festivalin e V” (“Llaiko Vima”: 07.08.1955) i frymëzuar nga festa e rinisë botërore, “Letër një ushtari Sovjetik” (“Llaiko Vima”: 23.02.1956), “Për Partinë” (“Llaiko Vima”: 15.04.1956), “Në fshatin tim” (“Llaiko Vima”: 11.10.1956), “Historia e Partisë” (“Llaiko Vima”: 27.02.1958), “Zemra e partizanëve” (“Llaiko Vima”: 10.07.1958), “Vazhdimi i një dialogu” (“Llaiko Vima”: 03.04.1958) kjo vjershë mori çmim në revistën “Miqësia”, “Dasma” (“Llaiko Vima”: 27.05.1958), “Nëna” (“Llaiko Vima”: 29.10.1959), “Tirana” (“Llaiko Vima”:

15.11.1959), "Partia" ("Llaiko Vima": 07.11.1963), "Migjeni" ("Llaiko Vima": 07.06.1964), "Duart punëtore" ("Llaiko Vima": 04.02.1971), "Athina e lirë" ("Llaiko Vima": 08.10.1992), "Me miqtë e mi të vegjëlisë" ("Llaiko Vima": 24.12.1992) etj.

Një poet tjetër, tepër i talentuar është edhe Andrea Zarballas, i cili ka qenë gjithmonë i pranishëm në faqet e gazetës "Llaiko Vima" me: "Vajzat e fshatit" ("Llaiko Vima": 12.05.1963), "Ora e qytetit" ("Llaiko Vima": 23.07.1972), "Mos u çudit" ("Llaiko Vima": 31.08.1978), "Trëndafili i erërave" ("Llaiko Vima": 15.09.1994), "Korfuzi" ("Llaiko Vima": 15.09.1994), etj.; Vasili Koça me: "Fshati im" ("Llaiko Vima": 10.05.1956), "Dallandyshtet e para" ("Llaiko Vima": 29.09.1957), "Bistrica" ("Llaiko Vima": 27.02.1958), "Fshatari dhe kali" ("Llaiko Vima": 10.03.1991), "Një kabanë bie" ("Llaiko Vima": 27.05.1993), "Në dashurinë time" ("Llaiko Vima": 26.01.1995), "Biri im" ("Llaiko Vima": 06.04.1995), etj.; Pavlo Shutit me: "Bebe" ("Llaiko Vima": 29.05.1955), "Pambuku" ("Llaiko Vima": 08.09.1955), "Topat e Aurorës" ("Llaiko Vima": 06.11.1955), "Shokët" ("Llaiko Vima": 17.11.1955), "Roja" ("Llaiko Vima": 12.07.1956), "Pesëmbëdhjetëvjetori i Partisë" ("Llaiko Vima": 08.11.1956) etj.; Mina Leka me: "Vjelja" ("Llaiko Vima": 29.09.1957), "Fshati im" ("Llaiko Vima": 05.12.1957), "Natë Prilli" ("Llaiko Vima": 06.07.1958), "Merak pranveror" ("Llaiko Vima": 12.05.1963), "Dropullitët" ("Llaiko Vima": 07.07.1994), "Çfarë dashuroj?" ("Llaiko Vima": 07.07.1994), "Unë prapë do të dashuroj" ("Llaiko Vima": 07.07.1994), "Ushtarë grek të vrarë" ("Llaiko Vima": 27.10.1994), "Zemra ime" ("Llaiko Vima": 16.02.1997) etj.

Poeti më i talentuar i Minoritetit Etnik Grek Niko Kacalidha përfaqësohet edhe ai me një numër të konsiderueshëm poezish si: "Jemi treqind" ("Llaiko Vima": 04.05.1995), "Trëndafilli i zi" ("Llaiko Vima": 04.05.1995), "Hëna e të burgosurve" ("Llaiko Vima": 04.05.1995), "Ktheu në shtëpi Odhise" ("Llaiko Vima": 04.05.1995), "Loti i ciklaminit" ("Llaiko Vima": 03.09.1998) që i është kushtuar "vendlindjes se tij të veçantë, në hënën e yjeve dhe të çobenjëve", vendlindjen e veçantë të tij, Leshnicës. Edhe poeti tjetër Foto Qiriazatit vjen me një tufë vjershash si "Tokë, dashuria ime" ("Llaiko Vima": 05.10.1980) apo Vangjel Zafirati me "Tryeza e Vitit të Ri" ("Llaiko Vima": 11.01.1987) dhe "Ditë korzesh" ("Llaiko Vima": 31.07.1988) etj.

Bie në sy se në këtë periudhë e vetmja poeteshë në MEG, që përfaqësonte letërsinë femërore (e shkruar nga femrat) ishte vetëm Persefoni Gjini e cila merr pjesë me shumë krijime të saj p.sh. "Ngrehu Argjiro nga gremina" ("Llaiko Vima": 06.10.1983), "Legjenda e nuses" ("Llaiko Vima": 31.07.1988), "Mundimet e mërgimit" ("Llaiko Vima": 25.01.1996), "Figura e gjallë" ("Llaiko Vima": 07.11.1996) etj.

Në gazetën "Llaiko Vima" paraqiten shumë vjersha të përkthyer kryesisht nga poetët dhe shkrimtarët që luanin edhe rolin e përkthyesit siç ishin Pano Çuka, A.A., Pavlo Shutit, P. Kastriiti, A. Z., A.Thalasio, Mina Leka etj.

Disa poetë përdorin fjalë tingëluese me kuptime të shumëllojshme ose me koncepte të ndryshme, ose e kënaqin lexuesin me përcjelljen e analogjive dhe iluzioneve, por janë sërish ata që me fjalë të pastër e drejtojnë kuptimin lehtësisht tek lexuesi dhe përjetuesi i poezive. Ka edhe poetë që janë fanatik të traditës, që ndjekin ligjet klasike të vargëzimit, aplikojnë metrin, rimën dhe ritmin, ndërkohë që ka të tjerë, që pas hapave të para avancojnë në kërkesa të reja të shkrimit poetik, kurse disa të tjerë që përbëjnë një grup të vogël, shkruajnë poezi sipas kërkesave moderne.

Në faqet e gazetës botohej gjithashtu edhe poezi e frymëzuar nga doket, ritet dhe zakonet e MEG, e cila inkuadrohet në poezinë lirike shoqërore. Ka dhe disa poetë që depërtojnë në psikologjinë e njerëzve, fshatarëve e punëtorëve në gëzimet dhe hidhërimet personale e familjare duke përshkruar kështu thjeshtësinë dhe madhësitinë e tyre. Këtë grup poetësh e dallon dashuria

e veçantë për njerëzit që rrojnë e punojnë në vende malore, për fshatarësinë dhe jetën baritore prandaj në brendësi të vargjeve gjejmë bukurinë natyrore e shpirtërore të Minoritetit Etnik Grek. Shumica e poetëve të MEG gjejnë forma e modele të ndryshme përmes aktiviteteve shoqërore të ndryshme si panaiuret, mbrëmjet apo dasmat për të afirmuar personalitetin e tyre artistik.

Një nga temat më të shpeshta në gazetën “Llaiko Vima” është dashuria për vendlindjen e cila është e kudogjendur në poezi. Dashuria për vendlindjen vjen e bëhet një konstante tematike apo një nga motivet me të qëndrueshme që e frymëzojnë poetin e MEG. Malli, nostalgjia dhe evokimi shirtëror i fëmijërisë dhe i fshatit janë shenjat kryesore të disponimeve poetike në vjersha si “Fshati im” (“Llaiko Vima”: 10.05.1956) e Vasil Koçës, “Fshati im” (“Llaiko Vima”: 05.12.1957) e Mina Lekës, “Vargje nga vendi që u linda” (“Llaiko Vima”: 31.12.1959) e Pano Çukës, “Fshati im” (“Llaiko Vima”: 24.02.1980) e Vangjel Miçit, “Në vendlindjen time” (“Llaiko Vima”: 03.03.1983) e Niko Litit, “Fshati im” (“Llaiko Vima”: 28.06.1986) e Kristo Janit etj.

Një grup tjetër vjershash përfaqësojnë unitetin tematik e motivor të “poezisë për luftën”. Në këtë formacion poetik përshkruhet zakonisht dëshira e rinisë për luftë, përpjekja e përbashkët për bashkëpunim, për të arritur paqen dhe lirinë, vlera e vëllazërimit dhe bashkekzistenca mes popujve të botës.

Një grupim i tretë i vjershave na orienton në disa konstatime të përgjithëshme, që na lejojnë t i kategorizojmë si vjersha me përmbajtje ekzistenciale dhe filozofike.

